RAPORT AUDITIMI PËRPUTHSHMËRIE NË

"DREJTORINË E PËRGJITHSHME NR.1 TË PUNËTORËVE TË QYTETIT, TIRANË"

DHJETOR 2017

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETQEVERISJES VENDORE
Raport Përfundimtarë Auditimi për subjektin, "Drejtoria E Punëtorëve Të Qytetit Nr. 1", Bashkia Tiranë.

Nr.Përmbatja ***Faqe***

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE..... 3 -12
II. HYRJA..... 13-17
a. Titulli
b. Marrësi
c. Objektivat dhe qëllimi
d. Identifikimi i çështjes
e. Përgjegjësitë e audituesve
f. Kriteret e vlerësimit
g. Standardet e auditimit
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT..... 17-115
a. Mbi vlersimin e funksionimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.... **17 -24**
b. Vlerësimi i procesit të programimit dhe zbatimit të buxhetit të njësisë..... **24 - 30**
c. Auditim i mbylljes së llogarive vjetore në 31 dhjetor 2016..... **30 - 36**
d. Vlerësimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë në lidhje me
-Llogaritë e të ardhurave, të krijuara apo përfituar gjatë periudhës..... **47 - 48**
-Mbi ndarjen dhe riorganizimin e mjediseve të punës ndërmjet DPN 1 dhe APR...**36-40**
-Regjistri i aktiveve dhe administrimi i pronës shtetërore..... **40 - 45**
- Mbi Gjendjen e mallrave stok dhe me qarkullim të ngadalshëm…….....**45 - 46**
- Mbi organizimin, dokumentimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore që realizohen nga aktivitetet/ Saktësia e pasqyrimit të të ardhurave sipas llojit të tyre…… **46-48**
-Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore etj) **48- 54**
e. Mbi zbatimin e kërkesave të Prokurimit Publik.....**54- 101**
-mallra dhe shërbime
-aktivet e trupezuara dhe të patrupezuara (230, 231)
-Banka **55-59**
-Blerjet e vogla **59-76**
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET 101-112

V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT..... 113-114

VI. ANEKSE..... 115
Pergjigje observacionesh.....

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Tiranë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe në bazë të përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, ka marrë Vendimin nr.41, datë 23.09.2015 për "Riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit" ku në pikën 1 është vendosur miratimi i Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit në varësi të Bashkisë Tiranë, me numër të përgjithshëm prej 360 punonjësish dhe me detyra funksionale si më poshtë:

a) Administrimi mirëmbajtjes, zhvillimit pastrimit të gjelbërimit rrugor dhe të gjelbërimit të zonave të banimit brënda territorit të Bashkisë së Tiranës.
b) Administrimi i zonave të pambuluara nga operatorët e kontraktuar nga Bashkia e Tiranës.
c) Krijimi, mirëmbajtja dhe pastrimi i lulishteve dhe shatërvanëve brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.
d) Prodhimi dhe furnizimi me lule dhe bimësi për çerdhet, kopshtet dhe shkollat nën administrimin e Bashkisë së Tiranës.
e) Administrimi i landfill-it të Tiranës dhe evadimi i mbetjeve sipas nevojave dhe urdhëresave të Bashkisë së Tiranës.

Deri në tetor të vitit 2015 Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit ka funksionuar në bazë të organigramës të miratuar nga Këshilli Bashkiak me Nr.56 datë 24.12.2012 për "Organizimin e strukturës organizative të disa Institucioneve në varësi të Bashkisë Tiranë" me numër total prej 560 punonjësish të shpërndarë nëpër drejtori e sektorë.

-Me anë të Vendimit Nr.41 datë 23.09.2015 Për "Riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit" u vendos që numri i përgjithshëm i punonjësve të DPN1 të jetë 360 punonjës gjithsej. Për këtë arsye në organigramën e DPN1 pati disa ndryshime në strukturën si në numër punonjësisht ashtu edhe me organizim të sektorëve dhe drejtorive. Pas vendimit Nr.41, mes DPN1 dhe APR u nënshkrua Akt- marrëveshja Nr.1720 Prot dt 06.10.2015 të DPN1, dhe Nr.5 Prot. datë 06.10.2015 të APR në bazë të së cilës u transferuan një pjesë të punonjësve nga DPN1 tek APR. Po në këtë datë është bërë edhe njoftimi të gjithë punonjësve të tjerë të DPN1, me shkresën Nr.1731 Prot. datë 06.10.2015, ku njoftohen për riorganizimin e drejtorisë sipas strukturës së miratuar me Urdhërin Nr.14430 datë 05.10.2015 për " Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit" me numër të përgjithshëm punonjësish 360 veta.Të gjithë punonjësit që morën njoftimin për riorganizimin e drejtorisë kanë nënshkruar në listën emërore bashkëlidhur njoftimit. Sipas rastit, për punonjësit është ndjekur procedura ligjore për njoftimin dhe për të rënë dakord për pozicionin e ri të punës sipas strukturës së re të miratuar. Sipas Kodit të Punës, punonjësve që u suprimohej vendi i punës i është bërë njoftimi për zgjidhjen e kontratës së punës. Pas këtij njoftimi u është bërë urdhër lirimi për shkak të ristrukturimit dhe mos pranimit të kalimit në pozicionet e lira të punës 109 punonjësve. Nga të cilët:

- 42 punonjës kanë hedhur në gjyq drejtorinë.

- 5 prej punonjësve të cilët kanë hapur proces gjyqësor në momentin kur ka patur vende vakante u është ofruar të rikthehen në punë, por vetëm një punonjëse ka pranuar pozicionin e punës Znj. Lumturi Lilani, të tjerët e kanë refuzuar konkretisht Znj.Naxhije Abazi, Znj.Aferdita Metaliaj, Z.Agron Kaimi, Znj.Dëshire Buçi.
- Në momentin që DPN1 i janë miratuar punonjës shtesë nga Bashkia Tiranë u është ofruar rishtazi pozicioni i punës këtyre punonjësve, por vetëm 33 prej tyre deri në momentin e auditimit e kanë pranuar pozicionin e punës dhe janë emëruar sipas legjislacionit përkatës dhe sipas VKB-së në fuqi.

Në mbështetje të Urdhërit Nr.14430 datë 05.10.2015 për " Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit" me numër të përgjithshëm punonjësish 360 veta, struktura e DPN1 është e shpërndarë si më poshtë vijon:

Drejtor i Përgjithshëm
Asistent
Njësia e Monitorimit të Terrenit 1 Drejtor + 12 specialistë
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse 1 Drejtor + 11 punonjës
Sektori Juridik 1 përgjegjës + 3 specialistë
Sektori i Personel, Vlerësimit 1 përgjegjës + 3 specialistë dhe 1 punëtore
Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Raportimin Online 1 përgjegjës dhe 2 specialistë
Drejtoria e Planifikimeve, Menaxhimit dhe Shërbimeve 1 Drejtor + 57 punonjës
Sektori i Financë, Programimit 1 përgjegjës + 6 specialistë
Sektori i Flota, transportit 1 përgjegjës + 1 Specialist + 40 shoferë
Sektori i prokurimeve 1 përgjegjës dhe 2 specialistë
Sektori i Oficina, Mirëmbajtje 1 përgjegjës dhe 4 teknikë
Drejtoria e Zhvillimit dhe e Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit 1 Drejtor dhe 45 punonjës
Sektori i Zhvillimit 1 përgjegjës + 4 specialistë
Sektori i Projekteve 1 përgjegjës +4 specialistë
Sektori i Mirëmbajtjes 1 përgjegjës + 1 specialist + 6 teknikë =14 punëtor
Sektori i Prodhim, Bimësisë 1 përgjegjës + 17 punëtor
Drejtoria e Pastrimit të Qytetit 1 Drejtor dhe 197 punonjës
Sektori teknik 1 përgjegjës dhe 3 specialistë
Sektori i Pastrimit të rrugëve dytësore dhe blloqeve të banimit të sipërfaqeve të gjelbërta të qytetit 12 përgjegjësa + 160 punëtor
Sektori i Taskë Forcë, emergjenca 1 përgjegjës + 20 punëtor
Drejtoria e Trajtim, Mbetje, Landfill dhe Riciklim 1 Drejtor + 24 punonjës
Sektori i Teknik, Koordinimit 1 përgjegjës +5 specialistë
Sektori i Landfillit 1 përgjegjës +14 punëtor
Sektori i Riciklim, Trajtim Mbetjesh 1 përgjegjës +2 specialistë

Në mbështetje të këtij Urdhëri, duke qënë se u ndryshua organigrama dhe mjaft emërtesa të drejtorive dhe sektorëve, të gjithë punonjësve iu është bërë emërim i ri dhe kontratë e re sipas këtij urdhri dhe legjislacionit në fuqi në këtë periudhë.

Në lidhje me përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë mbi të ardhurat e krijuara apo të përfituara rezulton që burimi kryesor i të ardhurave është buxheti i bashkisë, grante, donacione si

dhe të ardhurat nga shërbimet për periudhën objekt auditimi nuk ka.Për shkak të numrit të transaksioneve dhe peshës së tyre grupi i auditimit ka përdorë teknikën e auditimit të njëpasnjëshëm.
Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore etj) janë audituar, regjistri i personelit dhe dosjet e personelit (vetëm për administratën) dhe me përzgjedhje për punëtorët. Nga auditimi rezulton se marrëdhëniet e punës mbështeten 100% në kodin e punës. Evidencat e grumbulluar për listëpagesat janë audituar me zgjedhje periudhash dhe me metodë krahasimi.
Nga auditimi rezultoi që DPN 1 ka zhvilluar gjatë vitit 2016, gjithësej 30 procedura prokurimi me fondin limit rreth 201.659 mijë lekë dhe janë lidhur 30 kontrata në vlerën 195,055 mijë lekë.
Gjatë vitit 2017 (6-mujori I-rë) DPN 1 ka zhvilluar gjithësej 17 procedura prokurimi me fond limit 267.611 mijë lekë, janë lidhur 17 kontrata me vlerë 263,511 mijë lekë pa tvsh, janë zhvilluar gjashtë procedura blerje të vogla në shumën 797 mijë lekë si dhe janë lidhur po aq kontrata në shumë 937 mijë lekë me tvsh.
Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.
-Bilanci kontabël është nxjerrë pas kryerjes së inventarëve të njësisë, mbylljes së situacionit përfundimtarë të rakorduar me degën e thesarit.
Në auditimin e kryer për plotësimin e pasqyrave financiare për vitin 2016 nga DPN NR.1 rezultoi se: janë përpiluar sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës, bilanci është përfunduar dhe dërguar në degën e thesarit në afat. Por nga auditimi i gjendjes së debi-kredive rezultoi se ky institucion ka debitorë pa shpresa arkëtimi të krijuar para 10 vjetësh, të cilët kërkojnë një ndjekje dhe një analizë të mëtejshme për të qartësuar pozicionet e këtyre llogarive.
-Drejtoria e menaxhimit dhe planifikimit /Sektori i Financës nuk ka azhornuar dhe nuk ka regjistruar dokumentacionin e veprimeve kontabël në ditarët analitik, nuk është mbajtur libri i madh apo centralizatori, nuk ka ditar banke dhe ditare magazine nëpermes të cilit kryhen kontabilizimet e veprimeve. *Veprime te cilat bien në kundërshtim me ligjin nr.9228 datë 29.04.2004"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*
-Për këtë periudhë për gjendja e debitorëve rezulton se institucioni nuk ka politika të qarta për arkëtimin e detyrimeve dhe menaxhimin e debitorëve dhe nuk ka mundur të arkëtojë debitin e krijuar ndër vite në vlerën *20,496,402 lekë*. Institucioni nuk ka kryer hartuar shkresa (njoftime) personave debitorë për arkëtim nëpërmjet postës,si dhe njoftime deri ne ndjekjen tw procedurave ligjore, për arkëtimin e debitorëve. Mos kryerja e kwtyre veprimeve , për të bërë të mundur arkëtimin e debitorwve tw krijuar wshtw në mospërputhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit".
-Ndërmarrjen e Punëtorëve Nr. 1 Qyteti Tiranë, ka në inventarin e **vitit 2016,** 4 automjete traktore me zinxhire (viti i prodhimit 1998) me *vlerë 62,082,698 lekë***,** nga ku konstatua se këto mjete nuk janë në përdorim dhe janë tejsisht të konsumuara.Vlerë kjo e trashëguar ndër vite e cila ka sjellë impakt negativ në pasqyrat financiare, pasi në aktivet e qëndrueshme mbahen të regjistruara vlerat e këtyre mjeteve të cilat nuk janë në përdorim.
Mbi inventarizimin e pronës shtetërore për vitin 2016.
-Në auditimin e pasqyrave finaciare u konstaua se në Llogarinë 231 shpenzime në proçes, për rritje të AQT,është e përberë nga *9,823,259 lekë* dhe vlera e trashëguar ndër vite dhe përshkruar si

shpenzime, e bëra për rritjen e AQT (Universiteti i Tiranës para vitit 2006).Nga ana e subjektit nuk është kryer asnjë veprim, për të plotësuar me dokumentacion, në mënyrë që të mos mbartej në pasqyrat finaciare.
-në pasqyrat e inventarit për magazinat rikupero konstatohet gjendja fizike dhe kontabile, në fund të përiudhës në vlerë *5,964,669 lekë***,** me zëra të ndryshem.
-Në auditimin e kryer për kontabilizimin e veprimeve të bankes si dhe ditarit të magazinave, u konstatua se këto veprime nuk janë kryer nga kjo njësi, por janë të mbajtura në exel, veprime të cilat bien në kundërshtim, me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
-Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, për periudhën objekt auditimi (vitet 2016-6/mujori 2017) u konstatua se, sektori i financës, gjatë periudhës së auditimit nuk kishte të përfunduar zyrtarizmin e regjistrit analitik të aktiveve sipas formatit zyrtar, në formë analitike, në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011"Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar.
-Në gjendjen e inventarëve të Institucionit për vitet 2016, konstatohet se pjesë e këtyre inventarëve ishin materiale shumë të konsumuara apo dëmtuara, për të cilat kosto e mbajtjes rezultonin më e lartë se përfitimi nga përdorimi, të cilat janë vlerësuar mallra për nxjerrje jashtë përdorimit. Mbajtja e aktiveve të konsumuara dhe të papërdorshme nga ana e subjektit bën që Pasqyrat Financiare të mos paraqesin gjendjen reale e cila bie ndesh me parimet e hartimit të Pasqyrave Financiare.

Nga auditimi i veprimeve të bankës konstatohet se likuidimet janë kryesisht për paga, ujë, drita, internet si dhe likujdimi i vlerës së kontratave të nënshkruara për blerje dhe shërbime të ndryshme. Nëpërmjet bankës është likujduar vlera prej 3,224,800 lekë për punonjësit e larguar padrejtësisht nga puna për vitet e mëparshme, dhe vlera prej 2,486,447 lekë likujduar në vitin 2015. Nga likujdimet e kryera nëpërmjet bankës janë konstatuar disa mangesi në plotësimin me dokumentacion justifikues, për mallrat e blera dhe shërbimet e ofruara. *Përmbledhja vetëm për gjetjet më të rëndësishme me rekomandimet përkatëse paraqitet si vijon:*

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME R/P	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Në objektin *"Sistem ujitës me impiante (pusi)"* Tiranë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **102,000 lekë pa tvsh** si pasojë e likuidimit tvsh – së pajisjeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 8.5.2003 *"Për Klasifikimin dhe*	FAQE 87	E LARTË	Nga Drejtoria e Përgjithshme nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **102,000 lekë pa t.v.sh** nga operatori ekonomik *"--------"* sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr.2013/8 prot datë 28.07.2016 me objekt *"Sistem ujitës me impiante*

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME R/P	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", Kreu I/I dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2013/8 prot datë 28.07.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor të Drejtorisë së Përgjithshme nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit Tiranë dhe OE *"---------"* sh.p.k,			*(pusi)"* Tiranë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të t.v.sh – së pajisjeve.
2.	Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje Vaj dhe Filtra", u konstatua se kontrata ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe ---------sh.a në cilësinë e operatorit ekonomik të shpallur fitues, është lidhur në datën 23.09.2016 me nr. 2507/8 prot, ndërsa në datën 06.10.2016 janë marrë në dorëzim pajisjet e prokuruara sipas faturës 97/99 datë 06.10.2016. Pra, mallrat janë dorëzuar 13 ditë pas lidhjes së kontratës, veprim në kundërshtim me nenin 5 pika 2 të kontratës së furnizimit ku citohet "Afati i realizimit të kontratës do të jetë nga data e lidhjes me afat lëvrimi 10 ditë", dhe me pikën 2.3 të njoftimit të kontratës në DST. Për pasojë Autoriteti Kontraktor në këtë rast duhet të kishte zbatuar nenin 24 të shtojcës 15 të DST dhe nenin 27 të kontratës së lidhur "Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar", ku citohet: "Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore: a)Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por, kjo shumë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës". Për pasojë (0.4% e 7,675,188 lekë) x 3 ditë konsiston me vlerën **92,102 lekë**, e cila përbën penalitet të pambajtur nga autoriteti kontraktor kundrejt	*Faqe 107-112*	E LARTË	Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **92,102 lekë** nga --------- sh.a në cilësinë e operatorit ekonomik të shpallur fitues. Kjo vlerë ka të bëjë me penalitetin i cili duhet të ishte mbajtur në përputhje me kushtet e kontratës për dorëzimin me vonesë të mallrave të prokuruar.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME R/P	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	operatorit ekonomik dhë përbën dëm ekonomik për buxhetin e DPN1			
3.	Janë kryer pagesa për punonjësit e larguar nga puna që kanë paraqitur vendime gjyqësore si pasojë e largimeve të padrejta, në shumën 6,276,971 lekë, e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit. Largimet nga puna i përkasin viteve 2011-2013.	*Faqe 66*	E LARTË	Nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve Nr. 1, të merren masa për të ndjekur me përgjegjësi procedurat gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme.
4.	Hartimi i pasqyrave finaciare është hartuar në bazë të inventareve fizike i krahasuar me atë kontabile nga ku nuk kanë rezultuar diferenca, por Drejtoria e Menaxhimit dhe Planifikimit /Sektori i Financës nuk ka azhornuar, nuk ka regjistruar dokumentacionin e veprimeve kontabël në ditarët analitik, librin e madh, ditar banke dhe ditar magazine, nëpërmjet të cilit kryhen kontabilizimet e veprimeve, në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" dhe me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël"	FAQE 41-47	E LARTË	Drejtoria e menaxhimit dhe planifikimit/Sektori i Financës të marrë masa për hapjen në ditarë dhe në llogari të veprimeve dhe fakteve ekonomike që i përkasin njësisë ekonomike mbi dokumente bazë, dokumente plotësues dhe regjistrat (libra) kontabël.
5.	Në auditimin e kryer për plotësimin e pasqyrave financiare për vitin 2016 nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit rezulton se janë përpiluar sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës, bilanci është përfunduar dhe dërguar në degën e thesarit në afat. Por, nga auditimi i gjendjes së debi-kredive rezultoi se ky institucion ka debitorë pa shpresa arkëtimi të krijuar para 10 vjetësh, të cilët kërkojnë një ndjekje dhe një analizë të mëtejshme për të qartësuar pozicionet e këtyre llogarive. Duke mos patur politika të qarta për arkëtimin e detyrimeve dhe menaxhimin e tyre (debitorëve), DPN 1 nuk ka mundur	FAQE 55-59	E MESME	Drejtoria e Planifikim Menaxhimit dhe Shërbimeve, të ngrejë grupin e punës për monitorimin e ambienteve të dhëna me qira, me qëllim ruajtjen e tyre dhe respektimin e kushteve kontraktuale si edhe në rastet e përfundimit të kontratave, apo tjetërsimit të ambienteve të kryejë procedurat sipas legjislacionit në fuqi.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME R/P	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	të arkëtojë debitin e krijuar ndër vite nga 16 subjekte në vlerën 20,496,402 lekë, të cilat vinë kryesisht nga dëmtime. Institucioni nuk ka kryer asnjë veprim, për të bërë të mundur të arkëtojë debitin e krijuar në mospërputhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit"			
6.	Nga auditimi i kryer mbi konsumin e karburantit për dy gjeneratorët për përpunimin e plehrave në landfillin e sharrës, mungojnë të dhënat për vitin e prodhimit dhe patenta shoqëruese si dhe u konstatua se nuk ka një procesverbal të llogaritjes së normës së harxhimit në 1/ore pune te veçantë, por kjo normë llogaritet me urdhër të përgjithshëm.Mungon regjistri i matjes së kohës së punës dhe sasisë së karburantit që është harxhuar për kohën që është vënë në punë. Këto veprime janë në kundërshtim me Kreun III, pika 30 e Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. - Nga auditimi i dokumentacionit të mjeteve të transportit si dhe mjeteve të tjera që kryejnë shërbime në këtë ndërmarrje si motogjeneratorë, autofshirëse etj. nuk ka regjistër (kartela) për të saktësuar hyrjen në magazinë për çdo rast. Gjithashtu, nuk ka asnjë dokument justifikues për të saktësuar lëvizjet që kryen çdo mjet mbi bazën e të cilëve të kryhen dhe shërbimet, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011"Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar.	FAQE 51-59	E LARTË	**1** Nëpunësi Autorizues, të marrë masa për ngritjen e komisioneve për matjen dhe përcaktimin e konsumit të karburantit, për përpunimin e plehrave, duke nxjerrë dhe dokumentuar saktë shpenzimet për këto gjeneratorë. **2** Të merren masa dhe të hapen kartela nga Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve, për çdo automjet si dhe për çdo mjet pune të cituara më lartë, në mënyrë që të saktësohen kur janë berë hyrje në institucion që në bazë të këtyre të dhënave të kryhen shërbimet gjithashtu bëhet dhe amortizimi vit pas viti. Të ngrihet urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm i Institucionit për të përcaktuar konsumin e sasisë së karburantit në 1/ore pune me urdhër të veçantë, për gjeneratorët që kanë në përdorim, duke nxjerrë saktë shpenzimet dhe duke i dokumentuar sipas formulareve tip.
7.	Veprimet ekonomike, janë regjistruar në bazë të dokumenteve autorizuese dhe vërtetuese, veprimet janë regjistruar në	FAQE 51-59, 66-86	E LARTË	Drejtoria e menaxhimit dhe planifikimit, Dega e financës të marrin masa për hapjen e ditarëve të bankës

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME R/P	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	kompjuter, por nuk është mbajtur ditari i bankës sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2012, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", "Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve" dhe "Dokumentimi i vlerave monetare"			dhe të magazinave, për kryerjen e kontabilizimit te veprimeve sipas udhëzimeve të sipërcituara.
8.	Nga auditimi i procedurave të prokurimit, saktësisht për: "Blerje vaj dhe filtra", "Blerje plehra kimik, farëra etj", "Blerje karburant Diesel D1 dhe benzinë", "Blerje stola dekorativ dhe kosha", "Blerje kosha për diferencim" dhe "Blerje drurë dhe shkurre dekorativ", me vlerë totale të fondit limit 105,825,822 lekë (pa TVSH), u konstatua se disa nga kriteret për kualifikim të vendosura në dokumentet standarde të tenderit, janë të panevojshme për përmbushjen e kontratave, duke ndikuar negativisht në qëllimin dhe frymën kryesore të prokurimit publik, atë të nxitjes së pjesëmarrjes së gjerë të operatorëve ekonomikë, veprim në kundërshtim me nenin 23, pika 1 dhe nenin 46, pika 3, të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar	FAQE 67-112	E LARTË	Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit në të ardhmen të merren masa për vendosjen e kritereve të cilat realisht i shërbejnë realizimit të objektit të prokuruar, duke krijuar kushte të përshtatshme për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve.
9.	Nga auditimi i procedurave të kryera për blerjet me vlera të vogla, u konstatuan mjaft mangësi të letrave të punës apo parregullsi të procedurave, të cilat sipas grupit të auditimit janë si pasojë e mosnjohjes së mirë të ligjit dhe rregullave të prokurimeve publike nga ana e stafit të Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit - Për nevojën e kryerjes së prokurimit/shërbimit, mungojnë	FAQE 65-87	E LARTË	**1.** Njësia e Prokurimit, të marrë të gjitha masat, që specifikimet teknike, të hartohen në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, të përcaktohen kritere të sakta dhe të kuptueshme, pa lënë shteg për interpretime, si dhe të detajohen sipas rregullave të prokurimit publik, me qëllim arritjen e mallrave dhe shërbimeve me cilësinë

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME R/P	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	kërkesat nga degët, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57, datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël. Procedurat për blerjet me vlera të vogla, në shumicën e rasteve janë kryer në formë shkresore, nëpërmjet formularit të emergjencës ose si pasojë e anulimit të procedurës në sistemin elektronik. - Mungojnë specifikimet teknike në të gjitha procedurat e kryera për blerjet me vlera të vogla, për materialet e listuara nuk ka asnjë specifikim teknik në lidhje me llojin, përmasat, ngjyrën, materialin etj, të dhëna të nevojshme për artikujt që do të prokurohen, sepse bazuar në specifikimet teknike përcaktohet/diferencohet cilësia dhe çmimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 23 "Specifikimet teknike" dhe VKM nr. 914, datë 20.12.2014, neni 27			e kërkuar. **2.** Autoriteti kontraktor, të marrë masa për njohjen e vazhdueshme të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit me bazën ligjore dhe rregullat e prokurimeve publike, nëpërmjet trajnimeve në Agjencinë e Prokurimit Publik, në përmbushje të kërkesës së VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me qëllim përmirësimin e punës së Njësisë së Prokurimit për hartimin e nevojave, kërkesave, hartimin e specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit të nevojshëm për kryerjen e blerjeve me vlera të vogla, etj.
10.				

II. HYRJA-Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Programit të Auditimit Nr.878/2, datë 24.08.2017, ndryshuar me shkresën nr.878/3 datë07.09.2017, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 28.08.2017 deri në datë 20.10.2017, auditoi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë nr.1 të Punëtorëve të Qytetit Tiranë (DPN 1) për periudhën nga15.07.2015 deri në30.06.2017.Auditimi u krye nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A. B., Përgjegjës Grupi
2. M. B., Audituese
3. J. H., Auditues
4. V. B., Audituese
5. B. D., Auditues

a) Titullin."Auditim i përputhshmërisë", për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord.
b) Marrësi. Subjekti i audituar Drejtoria Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë. Krijuar në bazë të vendimit nr. 41 datë 23.09.2015 të Këshillit Bashkiak, Pas vendimit Nr.41, mes DPN1 dhe Agjencia e Parqe Rekreacionit (APR) është nënshkruar akt-marrëveshja Nr.1720 Prot dt 06.10.2015 të DPN1, dhe Nr.5 Prot. datë 06.10.2015 të APR në bazë të së cilës u transferuan një pjesë të punonjësve nga DPN1 tek APR.
c) ***Objektivat dhe qëllimi***. Dhënia e një opinioni profesional, të pavarur mbi ndjekjen nga subjekti të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, si dhe përputhshmëria me ligjet dhe rregullat e raportimit financiar në sektorin publik.
d) ***Identifikimi i çështjes.***Auditimi u krye sipas drejtimeve të mëposhtme, të miratuara në Programin e Auditimit Nr. 878/2, datë 24.08.2017.
Auditimi u fokusua në vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të dhënë një opinion mbi nvelin e sigurisë që japin sistemet e kontrollit të brendshëm, duke parë por pa u limituar në elementët që garantojnë këto sisteme:

- Mjedisi i kontrollit.
- Menaxhimi i riskut.
- Aktivitetet e kontrollit.
- Informim komunikimi.
- Monitorimi

II. Vlerësimi i procesit të programimit dhe zbatimit të buxhetit të njësisë.

a. Vlerësimi i nevojave dhe përputhja e tyre me objektivat si element kyc për të garantuar një programim të kujdesshëm për një buxhet sa më kredibël. Zbatimi i kritereve dhe procedurave të hartimit të buxhetit. Nivelet e realizimit të planit përfundimtar.
b. Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në raportimin e saktë të zërave të buxhetuar, analiza e deviancave të konstatuara.

c. Vlerësimi i saktësisë së raportimit të të dhënave të buxhetit në zërat e pasqyrave financiare, për të dhënë një opinion të drejtë mbi saktësinë e pasqyrës së realizimit të buxhetit referuar bazës së dhënies së këtij opinioni.

III. Auditimi i mbylljes së llogarive vjetore në 31 dhjetor 2016.

a. Nxjerrja e bilancit kontabël me afat, plotësimi i pasqyrave financiare në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.14 datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive qe varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar.
b. Auditim mbi mënyrën e ndarjes së aktivitetit tëish Drejtorisë Përgjithshme nr.1, të Punëtorëve të Qytetit Tiranë dhe zbatimi i procedurave të caktuara për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar, të prekur nga riorganizimi i Ndërmarjes";
c. Dhënia e opinionit për saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare. Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Vlerësimi i gjëndjes financiare të ndërmarrjes, detyrimet e konstatuara për fatura të palikujduara, vendime gjyqësore apo kredi të përfituara.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë në lidhje me:

a. Saktësia e pasqyrimit të të ardhurave sipas llojit të tyre (të krijuara vetë, grande, transferime nga buxheti, kredi apo finacime të llojeve të ndryshme), paraqitja e drejtë e transaksioneve në kontabilitet.
b. Auditim me zgjedhje mbi organizimin, dokumentimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore që realizohen nga aktivitetet
c. Niveli granteve apo financimeve të huaja të përfituara dhe evidenca kontabël e tyre. Saktësia e paraqitjes në pasqyra financiare.

<u>Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore etj),</u>

- Hartimi, miratimi dhe respektimi i strukturave organike të miratuar nga Këshilli Bashkiak.
- Përcaktimi i pagave sipas klasifikimit të funksioneve dhe vendeve të punës në shërbimin civil dhe atyre me kod pune;
- Lidhja e kontratave të punës me punonjësit.
- Respektimi i dispozitave ligjore për dhënien e shpërblimeve nga fondi i vecantë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore, etj.
- Respektimi i dispozitave ligjore për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, konfirmimi i pagesës së sigurimeve si për stafin me status të nëpunësit civil dhe ata me kontratë.

<u>V. Mbi zbatimin e kërkesave të Prokurimit Publik</u>

1. Hartimi i një tabele për Ndërmarjen në lidhje me procedurat e prokurimit publik, objekti i prokuruar, lloji i procedurës, fondi limit, data dhe vlera e kontratës lidhur, shtesat e

kontratës, diferenca nga fondi limit, operatori ekonomik fitues dhe cila procedure prokurimi dhe audituar nga grupi/audituesi i KLSH në vlerë dhe në përqindje

2. Përcaktimi i nivelit të shpenzimeve të prokuruara në referencë të totalit të shpenzimeve si dhe vlerësimi i zonave me risk për auditim. Dhënia e opinionit për rregullshmërinë e realizimit të procesit të prokurimit në sigurimin e mallrave dhe shërbimeve.

a. Mallra dhe shërbime.

1. Mënyra e evidentimit dhe ndjekjes së nevojave për mallra dhe shërbime brenda ndërmarrjes. Niveli i deviacioneve nga programimi i buxhetit për këto zëra.
2. Gjendja e mallrave stok dhe me qarkullim të ngadalshëm. Kryerja i inventarit të aktiveve qarkulluese. Saktësia e vlerës së inventarëve ekonomik pasqyruar në pasqyrat financiare dhe konfirmimi i vlerës së inventarizimit fizik.
3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.
4. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës lidhur me sigurimin e mallrave dhe shërbimeve për aktivitetin e ndërmarrjes.
5. Analiza dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik, kontroll i zbatimit të kontratës dhe marrja në dorëzim të mallrave/shërbimeve në referencë të kërkesave ligjore. Kontrolli fizik për marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe verifikimi i zbatimit të kushteve të kontratës nga komisioni i ngritur për zbatimin dhe marrjen në dorëzim
6. Saktësia e vlerës së pasqyruar në shpenzimet e periudhës kontabël
7. Përcaktimi i vlerës së detyrimeve të papaguara nga blerjet e periudhave të mëparshme (lista e detyrimeve e saktësuar përmes testimeve të dokumentacionit të disponueshëm)

b. Aktiveve e Trupëzuara dhe të Patrupëzuara (230, 231)

1. Rregjistri i aktiveve dhe administrimi i pronës shtetërore
2. Saktësia e vlerës së pasqyruar në aktive sipas klasifikimit bazë kontabël dhe llogaritja e amortizimit të tyre
3. Shtesat e aktiveve gjatë vitit, dhe krahasimi me nevojat për investime të programuara. Argumentimi dhe përllogaritja e vlerës limit të kontratës sipas nevojave konkrete për investime.
4. Kontrolli fizik për marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit. Zbatimi i kushteve të kontratës nga komisioni i ngritur për zbatimin dhe marrjen në dorëzim (Paraqitja në formë tabelare të objekteve ndërtimore të përfunduara sipas vlerës, operatori, fitues, data e kontratës, afatet e përfundimit të punimeve sipas kontratës, dhe përzgjedhjae tyre për verifikim në teren, etj).
5. Pakësimet e aktiveve dhe arësyet e këtyre transaksioneve. Ndjekja e procedurave të nxjerrejs jashtë përdorimit sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 30 të Ministrisë së Financave
6. Saktësimi i vlerave që prekin bilancin dhe konfirmimi i shifrës me inventarizimin fizik të realizuar në fund të periudhës. Verifikimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm lidhur me administrimin e aktiveve të qëndrueshme.
7. Përcaktimi i vlerës së detyrimeve të papaguara nga investimet e periudhave të mëparshme (lista e detyrimeve e saktësuar përmes testimeve të dokumentacionit të disponueshëm)

8. Inventarizimi dhe krijimi i regjistrit/data base të aseteve tëpër periudhën e auditimit, auditimi i ndryshimeve të aseteve të kryera (dhënie me qira, shitje troje etj.), ligjshmëria dhe rregullariteti i veprimeve të kryera me asetet e qëndrueshme; Auditim mbi statusin juridik të tyre, regjistrimi në ZVRPP.

VI. Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit.

e) Përgjegjësitë e audituesve. Në Raportin e Auditimit përgjegjësia e audituesëve është shprehja e konkluzioneve dhe një opinioni mbi çështjen e auditimit të përputhshmërisë. Raporti i auditimit shprehet për auditimin e kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar, të cilat janë kryer.

f) Kriteret e vlerësimit.Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; "Rregullorja e Brendshme mbi Organizimin dhe Funksionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit", miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. 85, datë 30.06.2015; Rregullorja e Brendshme" Për procedurat e auditimit të KLSH" Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; Udhëzimi i Ministrisë së Financavë nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".Ligji nr.9936, datë 26.6.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit i MF nr.2, datë 02.06.2012"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr.2, datë 09.01.2015 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015"; VKM nr.1497, datë 19.11.2008 "Për shtypjen e letrave me vlerë, i ndryshuar me VKM nr. 277, datë 6.4.2011 dhe VKM nr.393, datë 18.6.2014 Ligji nr.9228, datë 24.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare i ndryshuarligjin nr. 9477,datë9.2.2006; VKM nr.783,datë 22.11.2006"Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël"; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr.14, date 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore te huaj;VKM nr.7, datë 09.01.1976 "Për dorëzimin e detyrës midis punonjësve"; VKM nr.117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjes se personelit" Aneksi 1 dhe II. VKM nr.1619, datë 02.07.2008 "Për klasifikimin e funksioneve e grupimin e njësive të qeverisjes vendore dhe caktimin e kufijve të pagave të organeve të qeverisjes vendore", i ndryshuar me VKM nr. 598, datë 27.04.2009 "Për një ndryshim të VKM nr. 1619, datë 02.07.2008";Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik"; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 "Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe ta lartë"Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 "Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë"Ligji nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme"; Ligji nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar"; VKM nr.54, date 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë të pasurive shtetërore";VKM nr.500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes

vendore"Ligji nr.9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në zbatim Ligji nr.9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në zbatimRregulloret e Brendshme të funksionimit të administratës së ndërmarjes. Vendimet apo urdhrat e nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak.

g) Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës**.***Auditimi u krye sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit*

- **ISSAI 100 –** (***Parimet themelore të auditimit të sektorit publik)***
- **ISSAI 400** - (***Parimet themelore të auditimit të përputhshmerisë).*** KLSH, ka adoptuar Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë si standard pune për dhënien e një opinioni lidhur me përputhshmërinë bazuar në ***ISSAI 4100 –*** *Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.****ISSAI 4200 -*** *Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare.Për sa më lartë, auditimi është kryer sipas standardeve ndërkombëtare të SAI mbi auditimin e përputhshmërisë.*

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Auditimi do të fokusohet në vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të dhënë një opinion mbi nvelin e sigurisë që japin sistemet e kontrollit të brendshëm, duke parë por pa u limituar në elementët që garantojnë këto sisteme:

- Mjedisi i kontrollit.
- Menaxhimi i riskut.
- Aktivitetet e kontrollit.
- Informim komunikimi.
- Monitorimi

Nga auditimi rezultoi se:

Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, deri në tetor të vitit 2015 ka funksionuar në bazë të organigramës të miratuar nga Këshilli Bashkiak me Vendimin Nr. 56 datë 24.12.2012 për "Organizimin e strukturës organizative të disa Institucioneve në varësi të Bashkisë Tiranë".

Me anë të Vendimit Nr. 41 datë 23.09.2015 "Për riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit" u vendos që numri i përgjithshëm i punonjësve të DPN1 të jetë 360 punonjës gjithsej. Për këtë arsye në organigramën e DPN1 pati disa ndryshime në strukturë si në numër ashtu edhe në organizmin e sektorëve dhe drejtorive të njësisë.

Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë është institucion buxhetor në varësi të Bashkisë së Tiranës.

Kjo Drejtori është krijuar në funksion të një menaxhimi sa më të mirë të punëve publike për mirëmbajtjen e hapësirave dhe objekteve publike të Qytetit të Tiranës.

Struktura organike, numëri i punonjësve, shtesat apo shkurtimet si dhe niveli i pagave, miratohen nga Këshilli Bashkiak i Tiranës, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë është Drejtori që zhvillon aktivitetin e saj në territorin e Qytetit të Tiranës.

Qëllimi i kësaj Drejtorie është funksionimi i veprimtarisë së Drejtorive në varësi të saj dhe zbatimi i ligjit.

Detyrat kryesore të saj konsistojnë në:

Administrimin i mirëmbajtjes, zhvillimit, pastrimit të gjelbërimit rrugor dhe të gjelbërimit të zonave të banimit brenda territorit të Bashkisë së Tiranës;

Administrimin e pastrimit të zonave të pambuluara nga operatrët e kontraktuar nga Bashkia Tiranë.

Krijimin, mirëmbajtjen dhe pastrimin e lulishteve dhe shatërvaneve brenda territorit të Bashkisë së Tiranës;

Prodhimin dhe furnizimin me lule dhe bimësi për çerdhet, kopshtet dhe shkollat nën administrimin e Bashkisë së Tiranës;

Administrimin e Landfill-it të Tiranës dhe evadimin e mbetjeve sipas nevojave dhe urdhëresave të Bashkisë së Tiranës;

Për realizimin e shpejtë, të saktë dhe me kompetencë të funksioneve të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, Tiranë, të gjitha strukturat e administratës së DPN.1 bashkëveprojnë dhe bashkëpunojnë me njëra - tjetrën.
Ky bashkëpunim realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të dy a më shumë strukturave të veçanta në zgjidhjen e problemeve, në varësi nga natyra e tyre si më poshtë:
-Në rastin e delegimit të njëanshëm, strukturat marrin informacionin e nevojshëm në rrugë verbale dhe/ose shkresore;
-Në rastin e delegimit të dyanshëm/shumanshëm, strukturat i ofrojnë informacionin njëra - tjetrës dhe dalin me një produkt të përbashkët;
Konfliktet e krijuara për kompetencat dhe detyrat e çdo drejtorie, sektori, zyre apo nëpunësi trajtohen dhe zgjidhen sipas linjës së hierarkisë përkatëse;
Në zbatim të detyrave funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit të cilat janë :
-administrimi i mirëmbajtjes, zhvillimit, pastrimit të gjelbërimit rrugor dhe të gjelbërimit të zonave të banimit brenda territorit të Bashkisë Tiranë;
-administrimi i pastrimit të zonave të pambuluara nga operatorët e kontraktuar nga Bashkia Tiranë
-krijimi, mirëmbajtja e pastrimit të lulishteve dhe shatrivanëve brenda territorit të Bashkisë Tiranë;
-prodhimi dhe furnizimi me lule dhe bimësi për çerdhet, kopshtet dhe shkollat nën administrimin e Bashkisë Tiranë;
-administrimi i Landfill-it dhe evadimi i mbetjeve sipas nevojave dhe urdhëresave të Bashkisë Tiranë.
Për vitin 2016, në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 9 "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", pika 4, germa a, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli IV "Zbatimi i MFK", pika, 4.2.10 "Roli i nëpunësit të njësisë", gërma a, ky institucion ka respektuar objektivat si me poshte:
-administrimi i mirëmbajtjes, zhvillimit, pastrimit të gjelbërimit rrugor dhe të gjelbërimit të zonave të banimit në territorit të Bashkisë Tiranë në 24 Njesite administrative duke përmirësuar këtë shërbim dhe duke ju ardhur në ndihmë banorëve me zgjidhjen e çdo problematike të kësaj natyre të hasur.
-administrimi i pastrimit të zonave të pambuluara nga operatorët e kontraktuar nga Bashkia Tiranë, mbajtja pastër në 24 ore ne 24 të territorit të bashkisë tiranë dhe zgjidhjes së çdo rasti problematik të paraqitur dhe të mbetur i pa zgjidhur nga operatorët e pastrimit të kontraktuar nga njësia Qendrore.
-krijimi, mirëmbajtja e pastrimit të lulishteve dhe shatrivanëve brenda territorit të Bashkisë Tiranë;
-prodhimi dhe furnizimi me lule dhe bimësi për lulishtet çerdhet, kopshtet dhe shkollat nën administrimin e Bashkisë Tiranë, duke siguruar ambiente të këndshme dhe tërheqëse për banorët e Tiranës;

-administrimi i Landfill-it dhe evadimi i mbetjeve sipas nevojave dhe urdhëresave të Bashkisë Tiranë, mbajta sa më në kontroll e fushës së landfillit, i cili aktualisht punon i sforcuar për shkak se jeta e tij ka përfunduar dhe punon jashtë kapaciteteve normale;
-Përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve publike të cilat ju akordohen nga Njesia Qëndrore, Bashkia Tiranë dhe rritja e efiçencës së përdorimit të fondeve buxhetore, përbëjnë objektivin parësor të PBA-së, në funksion të të cilit, angazhimi dhe mbështetja serioze e me përgjegjësi të lartë e njësisë së DPN1 si pjesëmarrëse në PBA, mbetet thelbësore për ecurinë e suksesshme të këtij procesi.
-Sigurimi i një shpërndarjeje dhe përdorimi efektiv dhe efiçent i burimeve është objektivi nëpërmjet të cilit synohet të arrihet ky kuadër i qëndrueshëm planifikimi afatmesëm të Drejtorisë.
-Krijimi i një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet prioriteteve, të shprehura në programin e punës të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit dhe prioriteteve në shpenzime me qëllim shpërndarjen efektive të burimeve që do të vihen në dispozicion;
-Zgjerimi i vizionit të procesit të punës në kudër të buxhetimit duke synuar përmirësimin e shërbimit të pastrimit dhe gjelbërimit në qytetin e Tiranës;
-Një parashikim më i mirë buxhetor, mbështetur në objektiva dhe prioritete të vendosura për një periudhë tre vjeçare, për të gjitha programet e shpenzimeve;
-Inkurajimi i efektivitetit, efiçencës dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike dhe alokimin e burimeve për DPN 1.
DPN 1 si drejtori e përgjithshme nën varësi të Bashkisë Tiranë, ka respektuar prioritetet dhe politikat e përcaktuara dhe kërkuara nga institucuioni qëndror. DPN1 nuk ka një plan të vecantë strategjik, por rrespekton sipas kuadrit ligjor, planin strategjik dhe politikat e Bashkisë Tiranë , të hartuara nga nëpunësi i parë autorizues i njësisë publike BT, i cili përmban objektivat strategjikë, prioritetitet e Bashkisë Tiranë dhe planet e veprimit, të saj.
Punonjësit e institucionit i rregullojnë marrëdhëniet e tyre me punëdhënësin me kodin e punës. Bazat ligjore të kodit të punës dhe dispozitave të tjera si, ligji për buxhetin e shtetit, ligji për prokurimin publik, kontabilitetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin, etj., lejon menaxherin e institucionit që në rast të shkeljes së normave ligjore, apo të rregullave të ndërmarrë hapat e duhura.
Nënpunësi autorizues në Drejtorinë e Përgjithshme të Punëtorëve Nr. 1, është Drejtori i kësaj njësie z. ----------. Sipas nenit 12 pika 1 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Nëpunësi zbatues i njësisë publike është punonjës i nivelit të lartë të menaxhimit të njësisë publike, me diplomë universitare në shkencat ekonomike ose juridike, me përvojë menaxheriale dhe i specializuar në fushën e menaxhimit financiar ose të financave publike". Aktualisht në DPN1 funksionin e Nënpunësit Zbatues e ka ---------, i cili është konfirmuar si i tillë pas konfirmimit nga ana Ministrisë së Financave më shkresën me Nr. 1708 Prot. datë 16.02.2017.
Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, të cilat vendosen, ruhen dhe përditësohen rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihen në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet veprimtarive efektive, efiçente dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e

kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.
Sipas nenit 8 pika b të ligjit nr.10296 për Menaxhimi Financiar dhe Kontrollin: "Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji". Me anë të Urdhrit të Brendshëm Nr. 1539 Prot. datë 12.05.2016 të Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Punëtorëve Nr. 1 është ngritur grupi i menaxhimit strategjik, i përbërë nga nivele të larta drejtuese në DPN1, saktësisht: Drejtori i Përgjithshëm, zv/Drejtori i Përgjithshëm, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, Drejtori i Drejtorisë së Planifikimeve Menaxhimit dhe Shërbimeve, Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit, Drejtori i Drejtorisë së Pastrimit së Qytetit dhe Drejtori i Drejtorisë së Trajtim, Mbetje Landfill dhe Riciklim. Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të sigurojë marrjen në kohën dhe formën e duhur të informacioneve cilësore, të cilat i mundësojnë atij kryerjen e detyrave, në raport me të gjitha aktivtetet e njësisë. Lloji i informacionit lidhet me natyrën e aktiviteteve dhe objektivat e njësisë, por ai duhet gjithsesi të përmbajë të dhëna për: Raportimin mujor mbi kontabilitetin dhe menaxhimin, i cili i referohet përdorimit mujor të burimeve njerëzore dhe financiare si dhe raporte periodike të përpiluara gjatë vitit që përmbajnë parashikime mbi të ardhurat dhe shpenzimet përkundrejt buxhetit financiar të të ardhurave, burimeve dhe shpenzimeve kapitale; Progresin lidhur me realizimin e synimeve dhe objektivave; Identifikimin dhe menaxhimin e risqeve. Nga auditimi u konstatua se krahas këtij urdhri, nuk ka asnjë procesverbal ose minuta takimi për mbledhjet, diskutimet apo problematikat e ngritura nga ky grup. Për pasojë grupi i auditimit e vlerëson si jo efektiv ngritjen e grupit për menaxhimin strategjik. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 27 pika 1 të ligjit nr.10296 për "Menaxhimi Financiar dhe Kontrollin" ku citohet: "Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë e sektorit publik. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrohen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave".
Gjithashtu me Urdhërin e Brendshëm Nr. 1539/2 Prot. datë 12.09.2016 "Për vijimin e punës së grupit të menaxhimit strategjik", krahas të tjerave është caktuar edhe Koordinatori i Riskut, i cili do të jetë punonjësi që do të mbajë pozicionin e zv/Drejtorit të Përgjithshëm. Koordinatori i Riskut, kryen aktivitetet e mëposhtme: -Bashkërendimin e veprimtarive që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësive dhe ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut, në përpjesëtim me përmasat e tij; Këshillimin dhe dhënien e instruksioneve menaxherëve të tjerë të njësisë publike, në bashkëpunim me njësinë qëndrore të harmonizimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; Paraqitjen e raportit të përgjithshëm të risqeve të njësisë publike tek titullari i njësisë publike dhe grupi i menaxhimit strategjik të njësisë publike.
DPN1 ka një rregullore për funksionimin e saj e cila ka hyrë fuqi me Vendimin Nr. 16880/1, datë 15.06.2016 "Për një ndryshim të rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgegjësitë e administratës së drejtorisë së përgjithshme Nr.1 të punëtorëve të qytetit". Me shkresën nr. 1539/1 prot. datë 20.06.2016 është miratuar "Procedura e analizimit, vlerësmit dhe

trajtimit të riskut në DPN1". Gjithashtu është hartuar rregjistri i riskut dhe strategjia e menaxhimit të riskut detyrim sipas nenit 8/a, 10, 11 dhe 21, të këtij ligji, i cili në mënyrë të detajuar, përcakton përgjegjshmërinë e hallkave të ndryshme në këtë njësi publike, si të titullarit të institucionit, i cili ka këto kompetenca për hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave. Për vitin 2016 DPN1 ka zbatuar buxhetin e miratuar nga Bashkia Tiranë dhe ka hartuar projekt buxhetin afatmesëm të vitit 2017-2019, por duke marrë në konsideratë edhe risqet e mundshme që mund të pengojnë arritjen e objektivave.
Me shkresën nr. 3984 datë 30.12.2016 është detajuar pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2016.
- Mjedisi i kontrollit
Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban: integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës;Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.
Lidhur me mjedisin e kontrollit, DPN1 ka hartuar dhe miratuar: "Kodi i sjelljes dhe Etikës" me Nr. 3983 Prot. datë 30.12.2016, "Procedurat antikorrupsion" me Nr. 1046 Prot. datë 21.03.2016, "Rregullore e menaxhimit të aseteve" me Nr. 1047 Prot. datë 21.03.2016. Këto dokumente i janë përcjellë punonjësve të DPN 1, u gjithësecili është njohur me to. Në zbatim të ligjit Nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 15 "Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave", si dhe kapitulli III "Delegimi i detyrave", të manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, njësia ka të përshkruar në rregullore, rregulla të brëndshme të miratuara nga Bashkia Tiranë të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.
- Vlerësimi i riskut
Gjatë vitit 2016 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me shkresën nr.1539 Prot. Datë 12.05.2016
DPN 1 në raportin e vet për këtë qëllim ka cituar se ka bërë vlerësimin e riskut dhe i ka kategorizuar në risqe të brendshme dhe të jashtme:
Të brendshme: nevoja e ndjekjes se zbatimit të detyrave, në funksion të mirëmbajtes, pastrimit dhe gjelbërimit të qytetit, forcimi i vijueshëm i kapaciteteve të DPN 1; rritja e volumit të punës dhe shërbimeve të ofruara përmes mjeteve dhe burimeve njerëzore në dispozicion; koordinimi i punës ndërsektoriale etj.
Të jashtme: Koordinimi i proceseve te punes dhe ofrimit te sherbimit te mirembajtjes se qytetit ne bashkepunim me insitucionet e tjera te administrates vendore (BT); Mungesë fondesh për të mundesuar kushtet e punes si dhe plotesimin e nevojave ne drejtori.Plotesimi jo ne kohe dhe jo ne sasi i kerkesave nga Bashkia Tirane, mos realizim i shtimit te numrit te Burimeve njeresore, nga BT për të mundësuar realizimin e detyrave të drejtorisë etj.

Për minimizimin e risqeve janë marrë këto masa: Forcimi i kontrollit të brendshëm mbi aktivitetin e çdo dite të punës. Ndarja e qartë e detyrave dhe përcaktimi i rolit të çdo nëpunësi të veçantë. Hartimi i procedurave standarde për realizimin e aktiviteteve të ndryshme.

- Aktivitetet e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në strukturën organike dhe në strukturën organike dhe në rregulloren e brendshme. Për të realizuar sistemin dhe procesin e kontrollit të vijimit të punës. Në strukturën e DPN1 është një drejtori e veçantë, Njësia e Monitorimit të Terrenit.

Në zbatim të ligjit Nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 16, Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, kap III "Procesi i implementimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit", pika 3.2 "Cikli i MFK", hapi 5 "Gjurmët e auditimit", në institucion gjenden gjurmë e auditimit që ka si qëllim, të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet etj.

Nga auditimi u konstatua se nuk është hartuar Deklarata Vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe nuk janë dorëzuar sipas afateve ligjore të caktuara në nenin 18, të ligjit Nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe pikat nr. 4 e 6 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011, që përcaktojnë se "deklarata së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti tek Nëpunësit të Parë Autorizues në Ministrinë e Financave".

- Informacioni dhe komunikimi

Në zbatim të Vendmit Nr. 16880/1, datë 15.06.2016 "Për një ndryshim të rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit", të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, nenit 7 dhe nenit 8 janë të përcaktuara qartë linjat e komunikimit ndërmjet strukturave të administratës së Drejtorisë si dhe linjat e komunikimit në marrëdhënie me Bashkinë Tiranë.

Veprimtaria e këtij institucioni rezulton se Informacioni dhe Komunikimi në këtë institucion bëhet edhe verbalisht edhe në mënyë shkresore, apo në formë elektronik.

- Monitorimi

Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e punëtorëve të qytetit në raportin e vet për këtë qëllim ka cituar se në Rregulloren e DPN1 janë përcaktuar edhe rregullat dhe përgjegjësitë për strukturat e ndryshme. Raportimi periodik shërben për monitorimin e vazhdueshëm të aktivitetit për çdo proces e pozicion pune.

Gjithashtu hartohen raportet periodike të planifikimit dhe të zbatimit të punëve dhe detyrave, të cilat në mënyrë periodike dërgohen pranë Bashkisë Tiranë, si dhe aktrakordimet dhe situacionet financiare të buxhetit, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", në nenin 65 "Monitorimi", në të cilin citohet: "Nënpunësit autorizues të njësive të qeverisjes, i paraqesin sa herë që kërkohet, por jo më pak se katër herë në vit, nënpunësit të parë autorizues, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiar, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo projekt të përcaktuar në vitin e parë të dokumentimit përfundimtar të projektit buxhetor afatmesëm".

Vlerësimi i funksionimit të auditit të brendshëm.
Auditimi i brendshëm është veprimtari e pavarur që siguron menaxhimin dhe këshillon për veprimtarinë drejtuese, për përdorimin efektiv të fondeve dhe përmirësimin e veprimtarisë së subjekteve të audituara, duke i ndihmuar ato në mënyrë sistematike dhe të programuara dhe për përmirësimin e performancës.
Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit nuk ka në strukturën e vet auditues të brendshëm. Auditimi i veprimtarisë së shoqërisë kryhet nga auditi i Bashkisë Tiranë, organ nga i cili varet DPN1.
Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
Nuk ka asnjë dokumentim të mbledhjeve të grupit të menaxhimit strategjik, diskutimet e kryera apo zgjidhjet e dhëna për problemet e dala.
Nga ana e DPN1 nuk është hartuar Deklarata Vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe nuk janë dorëzuar sipas afateve ligjore të caktuara në nenin 18, të ligjit Nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"dhe pikat nr.4 e 6 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.28, datë 15.12.2011.

II. Vlerësimi i procesit të programimit dhe zbatimit të buxhetit të njësisë.

1. Vlerësimi i nevojave dhe përputhja e tyre me objektivat si element kyc për të garantuar një programim të kujdesshëm për një buxhet sa më kredibël. Zbatimi i kritereve dhe procedurave të hartimit të buxhetit. Nivelet e realizimit të planit përfundimtar.
2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në raportimin e saktë të zërave të buxhetuar, analiza e deviancave të konstatuara.
3. Vlerësimi i saktësisë së raportimit të të dhënave të buxhetit në zërat e pasqyrave financiare, për të dhënë një opinion të drejtë mbi saktësinë e pasqyrës së realizimit të buxhetit referuar bazës së dhënies së këtij opinioni.

-Mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të hartimit të buxhetit të vitit 2016, çelja dhe detajimi i planit fillestar, ndryshimet e tij gjatë vitit dhe zbatimi i tij.

Auditimi i programimit dhe realizimit të fondeve buxhetore u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:
-Ligjet:
-Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë";
-Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin";
-Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"
-Udhëzimete Ministrisë së Financave:
-Nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde në zbatimin e buxhetit"
-Nr.1, datë 04.06.2014, për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit";
Vendimin e Këshillit Bashkiak:
-Nr.58, datë 30.12.2015 për "Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2016",
Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë:

-Nr.80, datë 28.01.2013 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit të Bashkisë Tiranë".
Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit afatmesëm (PBA) 2016-2018 dhe hartimi i projekt buxhetit të vitit 2016.
Programimi i PBA 2016-2018, shoqëruar me shkresën e DPN1, ku kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2016-2018 si, misionin deklaratat shpenzimet sipas projekteve, artikujve, produkteve dhe artikujve buxhetorë.
Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm ka filluar me Urdhrin nr.1868, datë 07.10.2015 "Për krijimin e komisionit për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2016-2018", komisoni ka administruar në dosjen e buxhetit kërkesat e ardhura nga drejtoritë përkatëse si Drejtoria e Parqeve dhe Rekreacionit me nr 1657/1, datë 08.10.2015, Drejtoria e Trajtimit të Mbetjeve Urbane me nr. 1657/2, datë 09.10.2015, Drejtoria e Pastrimit Kuartallave me nr. 1868/1, datë 09.10.2015 si dhe Sektori i Transportit me nr. 1657/3, datë 09.10.2015.
Planifikimi i Projekt Buxhetit Afatmesëm 2016-2018 është propozuar me shkresën nr.1958, datë 12.10.2015 "Mbi përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018" dërguar Bashkisë Tiranë.
Gjithashtu, është bërë një rishikim i këtij Projekt Buxheti i propozuar me shkresën nr. 2152, datë 23.10.2015 "Projekt Buxheti Afatmesëm 2016-2018 i rishikuar" drejtuar Kryetarit të Bashkisë.
Programimi i PBA 2016-2018, është shoqëruar me shkresën e DPN1, ku kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2016-2018 si, misionin deklaratat, shpenzimet sipas projekteve, artikujve, produkteve dhe artikujve buxhetorë. Ky propozim është dërguar për miratim pranë Bashkisë Tiranë me shkresën përcjellëse nr.2152, datë 23.10.2015.
Planifikimi në këtë fazë është bërë sipas kërkesave të Bashkisë Tiranë me shkresën nr.14007, datë 30.09.2015 me lëndë "Mbi procedurat e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" me fond total të planifikuar sipas nevojave të DPN1 prej 847,717,000 lekë.
Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm është detajuar sipas kërkesave të drejtorive dhe është e detajuar brenda një programi buxhetor, të PBA 2016 - 2018.
Në planifikimin e treguesve ekonomiko-financiarë, qëllimi dhe objektivat e ndërmarrjes janë për:
- Mirëmbajtjen e parqeve dhe lulishteve, gjelbërim rrugor, impianteve ujitëse, serave dhe fidanishtes, elementeve dekorativ, shatërvaneve, shkolla, kopshte, çerdhe, etj.
- Pastrimin e rrugëve dytësore dhe tretësore, heqjen e mbeturinave skeletore dhe inerte, mirëmbajtjen e varrezave publike Sharrë dhe Tufinë
- Menaxhimin dhe depozitimin e mbetjeve urbane dhe të ngurta të Qytetit të Tiranës, etj.

Për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta, në pastrimin e mbeturinave, menaxhimin e mbetjeve urbane, kërkohet të sigurohet bazë materiale sipas zërave të përshkruar në projekt buxhetin afatmesëm për vitin 2016-2018. Nevojat e shpenzimeve që parashikohen për punimet dhe shërbimet në mbarëvajtjen e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Punëtorëve nr.1 të Qytetit, janë hartuar në bazë të kërkesave të drejtorive të varësisë, si dhe shtrirjes së aktivitetit që parashikohet me organizimin e ri territorial të Bashkisë Tiranë. Në këtë kuadër janë hartuar tabelat respektive për shpenzime operative dhe për investime, sipas drejtorive përkatëse.

Në përcaktimin e shpenzimeve dhe investimeve të nevojshme për 3 vitet e programit buxhetor afatmesëm 2016 - 2018, është pasur në qendër të vëmendjes rritja e cilësisë së shërbimit në mirëmbajtje, shtimi i sipërfaqeve të gjelbërimit dhe elementeve dekorative në to, duke garantuar një ambjent shplodhës dhe argëtues për qytetarët, si dhe rritjen e cilësisë në pastërtinë e ambjentit dhe ajrit.

Duke marrë në konsiderate organizimin e ri dhe shtrirjen e territorit të Bashkisë Tiranë, është e nevojshme rritja e shpenzimeve dhe investimeve e për rrjedhojë rritja e numrit të punonjësve, kjo për të patur një mbulim në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, si dhe për mbarëvajtjen normale të punës.

Zbatimi i kritereve në çeljen, detajimin e planit fillestar dhe ndryshimet konform dispozitave ligjore.

Çelja buxhetit të vitit 2016 dhe detajimi i tij.

Në zbatim të VKB nr. 58, datë 30.12.2015 "Miratimi i PBA 2016-2018 dhe detajimi i buxhetit të vitit 2016" është dërguar pranë DPN 1 me Shkresën nr.2641/1, datë 27.01.2016 "Njoftimi i Planit të Buxhetit 2016" si dhe me shkresën nr.3083, datë 24.01.2016 "Njoftimi i Planit të Buxhetit 2016" si dhe detajimi i limiteve mujore. Me shkresën nr.4227, datë 09.02.2016 është përcjellë Njoftimi i Planit të Shpenzimeve operative art. 602 për vitin 2016.

Shpenzimet buxhetore janë aprovuar për vitin 2016, në vlerë 510,298 mijë lekë, pra më pak për 337,419 mijë lekë, ose 40% më pak se projekt-buxheti i planifikuar.

Gjithsej çelja e shpenzimeve buxhetore për këtë vit, është në vlerë 510,298 mijë lekë, nga të cilat shpenzimet korrente 413,500 mijë lekë ose 81% të totalit dhe shpenzimet kapitale 96, 798 mijë lekë ose 19 % të totalit të shpenzimeve gjithsej.

Pasi janë miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Bashkia Tiranë, kjo e fundit ka njoftuar me shkresa të veçanta DPN 1 si dhe Degën e Thesarit Tiranë, me "Kërkesë për rritje dhe përdorim fondesh nga të ardhurat dhe transfertat e pakushtëzuara"brenda limitit të miratuar në zbatim të pikës 78 të Urdhrit nr. 80, datë 28.01.2013 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë.

Rishpërndarja e fondeve për çdo rast gjatë vitit është bërë me kërkesë të DPN 1 drejtuar për miratim

DPMF, Bashkisë Tiranë.të shoqëruar me formatin standard ku janë reflektuar shtesat dhe pakësime në vlerë shoqëruar me argumente në zbatim të paragrafit 2.3 dhe miratimi i ndryshimit brenda zërave buxhetorë për art.602 dhe art. 231 është bërë nga Kryetari i Bashkisë Tiranë.

Ndryshimet e buxhetit gjatë vitit 2016.

Miratuar dhe përcjellë me shkresat e Bashkisë Tiranë nr. 2641/1, datë 01.27.2016, nr. 4217, datë 09.02.2016 dhe nr.18365, datë 16.06.2016.

Me rishikimin e buxhetit nga BT me VKB nr.58, datë 30.12.2015 (Miratimi i PBA 2016-2018 dhe detajimi i buxhetit 2016 (i ndryshuar), janë njoftuar me shkresën nr. 18365, datë 16.06.2016 "Njoftim për ndryshim buxheti" sipas VKB nr.26,dt.23.05.2016 "Për një shtesë dhe disa ndryshime në VKB nr. 58 datë 30.12.2015". Art. 602 me shumën 3, 457 mijë lekë, drejtoria ka bërë detajimin për shërbime nga të tretët në zërin shërbime të tjera (Riparim Bomag) makineri e rëndë transporti në Sharrë, e cila ka marrë miratimin e Bashkisë Tiranë dhe është njoftuar me shkresën nr. 18365, datë 16.06.2016.

DPMSh ka kërkuar në Bashkinë e Tiranës me shkresën nr. 1021, datë 18.03.2016 shtesë fondesh të sasisë së karburantit si pasojë e rritjes së volumit të punës pranë landfillit të Sharrës të argumentuar për orët e punës që duhet të bëjnë mjetet, si pasojë e situatës në terren pranë Landfillit të Sharrës për 135 000 litra për 9 muaj, dërguar në BT me shkresën nr. 2407, datë 29.07 2016 është miratuar dhe njoftuar me shkresën nr. 24080/1, datë 04.08.2016 ku shtesa është me destinacion të përcaktuar, karburant me15, 000 mijë lekë.
DPN1 ka kërkuar kryetarit të Bashkisë Tiranë (BT) me shkresën nr.1538 prot. Datë 12.05.2016 ndryshim të planit të shpenzimeve operative për shtimin e zërit "Shpenzime Udhëtimi" për shumën 1, 660 mijë dhe pakësimin të zërit "Shpenzime për detyrime legale" e cila është miratuar nga Këshilli i BT me shkresën nr. 14693, datë 13.05.2016.
Plani përfundimtar për vitin 2016, pas ndryshimeve është 571,055 mijë lekë, nga 510,298 mijë lekë të planit fillestar, apo nga vlera e shpenzimeve buxhetore në çelje të tij, ose 11 % më shumë.
Të përmbledhura në grupet kryesore të shpenzimeve, plani fillestar, ndryshimet e tij gjatë vitit dhe realizimi i tyre, paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

000/lekë

Art	Emërtimi	Plani Fillestar	Ndrysh. (+ & -)	Plani Përfundimtar	Realizimi	%
600	Paga e shtesa	228,000	4,330	232,330	203,647	87.65%
601	Sigurime shoqërore	35,500	800	36,300	33,081	91.13%
602	Shp. operative	150,000	18,457	168,457	167,892	99.66%
606	Ndihmë ekonomike		670	670	623	92.96%
	Shumakorenteve	413,500	24,257	437,757	405,243	92.57%
231	Investime kapitale	96,798	36,500	133,298	111,747	83.83%
	Totali	510,298	60,757	571,055	516,990	90.53%

Referuar tabelës, rezulton se buxheti është realizuar në total në masën 90.53%, shpenzimet korente janë realizuar në masën 93% dhe investimeve të parashikuara në masën 84%. Mosrealizimi i investimeve prej 16% lidhet me mosrealizimin e kontratës për "Rehabilitimin e bimësisë dhe elementeve dekorative në Kombinat" në shumën 5,000 mijë lekë, si pasojë e mosmarrjes në dorëzim të punimeve dhe hapjes së procesit gjyqësor, si edhe të 2 likuidimeve të kryera në janar të vitit 2017 për blerje motorçikleta në shumën 8,300 mijë lekë dhe Rikonstruksion i magazinës, në shumën 4,500 mijë lekë.
Në fund të vitit 2016, ky institucion ka kryer rakordimet me Degën e Thesarit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës.

Mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të hartimit të buxhetit të vitit 2017, çelja e detajimi i planit fillestar, ndryshimet e tij gjatë vitit dhe zbatimi i tij.
Auditimi i programimit dhe realizimit të fondeve buxhetore u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:
-Ligjet: Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" Nr.139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen Vendore"-Vendimet e Këshillit të Ministrave:

Nr.433, datë 02.07.2014 "Për miratimin e projekt dokumentit të programin buxhetor afat mesëm 2015-2017"; -Udhëzimet e Ministrisë së Financave:Nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte në zbatimin e buxhetit" Nr.1, datë 04.06.2014, për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit "Vendimin e Këshillit Bashkiak:Nr.84, datë 29.12.2016 për "Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2016" Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë:Nr.80, dt.28.01.2013"Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit të Bashkisë Tiranë".

Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit afatmesëm (PBA) 2017-2019 dhe hartimi i projekt buxhetit të vitit 2017.

Programimi i PBA 2017-2019, shoqëruar me shkresën DPN 1, ku kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2017-2019 si, misionin deklaratat shpenzimet sipas projekteve, artikujve, produkteve dhe artikujve buxhetorë.

Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm ka filluar me Urdhrin "Për krijimin e komisionit për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2017-2019" nr.2522/1, datë 10.08.2016, referuar kërkesave e ardhura nga drejtoritë përkatëse si Drejtoria e Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit nr.2522/2, datë 25.08.2016, Drejtoria e Trajtimit të Mbetjeve Urbane me nr.2522/4, datë 26.08.2016, Drejtoria e Pastrimit të Qytetit me nr. 2522/5, datë 26.08.2016, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse me nr.2522/3, datë 25.08.2016 si dhe Njësia e Monitorimit të Terrenit me nr. 2522/6, datë 26.08.2016.

Planifikimi i Projekt Buxhetit Afatmesëm 2017-2019 është propozuar me shkresën nr. 2722, datë 02.09.2016 "Dërgim informacioni mbi kërkesat buxhetore për periudhën afatmesme 2017-2019" dërguar Bashkisë Tiranë.Gjithashtu është bërë rishikim i Projekt Buxhetit të propozuar me shkresën nr.2891, datë 22.09.2016 "Propozim i Projekt Buxhetit Afatmesëm 2017-2019" drejtuar Kryetarit të Bashkisë.Programimi i PBA 2017-2019, është shoqëruar me shkresën e DPN 1, ku kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2017-2019 si, misionin deklaratat shpenzimet sipas projekteve, artikujve, produkteve dhe artikujve buxhetorë. Ky propozim është dërguar për miratim pranë Bashkisë Tiranë me shkresën përcjellëse Nr.2722, datë 02.09.2016.

Planifikimi në këtë fazë është bërë sipas kërkesave të Bashkisë Tiranë të përcjellë me shkresën nr. 24220, datë 09.08.2016 "Mbi përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019" dhe ka një fond total të planifikuar sipas nevojave të DPN 1 prej 1,240,098 mijë lekë.

Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm paraqitet e detajuar sipas kërkesave të drejtorive dhe është e detajuar brenda një programi buxhetor sipas strukturës buxhetore.

Nevojat e shpenzimeve që parashikohen për punimet dhe shërbimet në mbarëvajtjen e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, janë hartuar bazuar në kërkesat e drejtorive të varësisë, si dhe shtrirjes së aktivitetit që parashikohet me organizimin e ri territorial të Bashkisë Tiranë. Në dosjen e projekt buxhetit janë dokumentuar kërkesat e drejtorive dhe shkresat përcjellëse për këtë planifikim buxhetor.

-Zbatimi i kritereve në çeljen, detajimin e planit fillestar dhe ndryshimet konform dispozitave ligjore.

Në zbatim të VKB nr 84, datë 29.12.2016 "Miratimi i PBA 2017-2019 dhe detajimi i buxhetit 2017" është dërguar pranë DPN 1 me shkresën nr.3083, datë 24.01.2017 "Njoftimi i Planit të Buxhetit 2017" si dhe detajimi i limiteve mujore. Me shkresën nr. 3690/1, datë15.02.2017 është përcjellë njoftimi i planit të shpenzimeve operative art. 602 për vitin 2017.
Shpenzimet buxhetore për vitin 2017, janë aprovuar në vlerë 760,116 mijë lekë, pra 479,982 mijë lekë më pak, ose 40% më pak se projekt-buxheti i planifikuar.
Çelja e shpenzimeve buxhetore gjithsej për këtë vit është në vlerën 384,735 mijë lekë, nga të cilat shpenzimet korrente 261,404 mijë lekë dhe shpenzimet kapitale 123,331 mijë lekë, të totalit të shpenzimeve.
Pas miratimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Bashkia Tiranë, kjo e fundit ka njoftuar me shkresa të veçanta DPN 1 si dhe Degën e Thesarit Tiranë, me shkresën "Kërkesë për rritje dhe përdorim fondesh nga të ardhurat dhe transfertat e pakushtëzuara"brenda limitit të miratuar në zbatim të pikës 78 të Urdhrit Nr .80, datë 28.01.2013 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë.
rishpërndarja e fondeve për çdo rast gjatë vitit është bërë me kërkesë të DPN 1 drejtuar për miratim DPMF, Bashkisë Tiranë, të shoqëruar me formatin standard ku janë reflektuar shtesat dhe pakësimet në vlerë duke i shoqëruar me argumenta në zbatim të paragrafit 2.3 dhe miratimi i ndryshimit brenda zërave buxhetorë për art. 602 dhe art. 231 është bërë nga Kryetari i Bashkisë, Tiranë.
Ndryshimet e buxhetit gjatë vitit 2017.
Me rishikimin e buxhetit nga Bashkia Tiranë me VKB nr.29, datë 05.04.2017 (Miratimi i PBA 2017-2019 dhe detajimi i buxhetit 2017, janë njoftuar me shkresën nr. 16026, datë 02.05.2017 me lëndën: "Njoftim për ndryshim buxheti" sipas VKB nr.29 dt.05.04.2017 "Për një shtesë dhe disa ndryshime në VKB nr.29, dt 02.05.2017". Art. 600 me shumën 5,000 në 000/lekë dhe Art.601 me shumën 2,000 në 000/lekë.
Me rishikimin e buxhetit nga Bashkia Tiranë me VKB nr.49, datë 31.05.2017 (Miratimi i PBA 2017-2019 dhe detajimi i buxhetit 2017 (i ndryshuar), janë njoftuar me shkresën nr. 24377, datë 21.06.2017 "Njoftim për ndryshim buxheti" sipas VKB nr.49, dt.31.05.2017 "Për një shtesë dhe disa ndryshime në VKB nr. 49, datë 31.05.2015" Art. 600 me shumën 9,000 mijë lekë dhe Art.601 me shumën 1,503 mijë lekë.
DPN 1, ka kërkuar kryetarit të Bashkisë Tiranë me shkresën nr.1688, datë 23.06.2017, ndryshim të planit të shpenzimeve operative për shtimin e zërit "Shpenzime për miëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore", Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, paisjeve teknike si dhe "Karburant dhe vaj" për shumën 1,600 mijë lekë, dhe pakësimin e zërit "Furnizime dhe materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme", "Të tjera materiale dhe shërbime speciale", "Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes", "Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit", "Shpenzime për qirramarrje të mjeteve të transportit", "Shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largim nga puna" me shumën 1600 mijë lekë, e cila është miratuar nga Këshilli i BT me shkresën nr .25381/1, datë 14.07.2017.

000/lekë

Art	Emërtimi	Plani Fillestar	Ndrysh (+ & -)	Plani Përfundimtar	Realizimi	%
600	Paga e shtesa	262,788	13,677	276,465	129,594	46.88

601	Sigurime shoqërore	41,727	3,503	45,230	21,340	47.18
602	Shpenzime operative	185,000	-	185,000	50,238	27.16
606	Ndihmë ekonomike	-	323	232	273	84.52
	Shuma korenteve	483,515	49,503	507,018	201,445	39.73
231	Investime kapitale	270,600		270,600	41,979	15.51
	Totali	760,115		777,618	243,424	31.30

Pra, plani përfundimtar për vitin 2017 deri në muajin qershor, ka rezultuar pas ndryshimeve për 777,618 mijë lekë, nga 760,115 mijë lekë të planit fillestar.
Nga ndërmarrja e Punëtorëve nr.1, të qytetit, Tiranë, për periudhën objekt auditimi nuk janë hartuar çdo 4-mujor raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit.
-Në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", nenin 65 "Monitorimi", në të cilin citohet: "Nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes qëndrore, i paraqesin sa herë që kërkohet, por jo më pak se katër herë në vit, nëpunësit të parë autorizues, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo projekt dhe produkt", për të dy vitet, ky institucioni nuk ka hartuar raporte monitorimi për shpenzimet buxhetore, e për rrjedhojë ky institucion nuk ka bërë analizën e kostove për produktet e programuara dhe të realizuara në vitet 2016 dhe 2017.
-Nga analiza e realizimit të shpenzimeve operative (602), u konstatua se, në disa zëra ka ndryshime të konsiderueshme nga viti në vit, duke evidentuar kështu që planifikimi dhe programimi i tyre nuk është bërë i detajuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve, në mënyrë që ndryshimet e shpenzimeve buxhetore gjatë viteve, të jenë sa më të vogla e për ndryshime të domosdoshme.

III. Auditimi i mbylljes së llogarive vjetore në 31 dhjetor 2016.
1. Nxjerrja e bilancit kontabël me afat, plotësimi i pasqyrave financiare në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.14 datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive qe varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar.
2. Auditim mbi mënyrën e ndarjes së aktivitetit të ish Drejtorisë Përgjithshme nr.1, të Punëtorëve të Qytetit Tiranë dhe zbatimi i procedurave të caktuara për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit,aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar, të prekur nga riorganizimi i Ndërmarjes";
3. Dhënia e opinionit për saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare. Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Vlerësimi i gjëndjes financiare të ndërmarrjes, detyrimet e konstatuara për fatura të palikujduara, vendime gjyqësore apo kredi të përfituara.

Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.
Nxjerrja e bilancit kontabël me afat, plotësimi i pasqyrave financiare në zbatim të udhëzimit nr.14 datë 28.04.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për instirtucionet qëndrore, organete pushtetit vendordhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit /zbatimit të projekteve marrveshjeve me donatorët e huaj " i ndryshuar .

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Punëtorëve Nr.1 Tiranë, nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se kontabiliteti në këtë institucion nuk mbahej sipas ligjit, por mbahej në Excel në të cilën kishte shumë pa saktësi në përshkrimin e veprimeve.

Drejtoria e financës nuk ka azhurnuar dhe nuk ka regjistruar dokumentacionin e veprimeve kontabël me ditarët analitik, nuk është mbajtur libri i madh apo centralizatori, nuk ka ditar banke dhe ditare magazine. *Bilanci kontabël është nxjerrë pas kryerjes së inventarëve të njësisë mbylljes së situacionit përfundimtar të rakorduar me degën e thesarit në ditarin e veprimeve të ndryshme, në librin e madh, centralizatori, në ditarët analitik dhe nxjerrjen e llogarive e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor në fund të vitit.*

Veprime te cilat bien në kundërshtim me ligjin nr.9228 datë 29.04.2004"Për kontabilitetin dhe pasqyrta financiare".

Neni 3 pika 1 "Mbajtja e kontabilitetit" është rregjistrimi në ditarë dhe në llogari i gjithë veprimeve dhe fakteve ekonomike "që i përkasin njësisë ekonomike".

pika 8 ''Evidencat mbështeste'' është dokumente baze, dokumente plotësues dhe regjistrat (libra) kontabël.
Nënpika c"Regjistrat (librat) kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve ekonomike të kryera të marra nga dokumentat bazë ose dokumenta plotësuese" .
-Dokumentacioni që regjistrohej në ditarët e veprimeve kontabël, dokumentacionit dhe kontabilizimit në ditarin e hyrjeve dhe daljeve nga magazina, ku u konstatuan mangësi e shkelje të trajtuara në mos kryerjen e kontabilizimit nga punonjësi i finances të fletëhyrjeve dhe fletë daljeve në ditarin mbajtjen e llogarive analitike të aseteve të qëndrueshme dhe qarkulluese, sipas ligjit.Veprimet e fund vitit dhe mbyllja e llogarisë vjetore të vitit 2016 nuk pasqyrohej në ditarin e veprimeve të ndryshme dhe në përmbledhësin e llogarive, sepse nuk kishte të tillë, por veprimet e mbylljes ishin bërë nga jashtë ditarëve, duke u bazuar në inventaret e kryera në fund të periudhës.
Për vitin 2016 bilancet e konsoliduar janë përpiluar dhe janë dërguar në Degën e Thesarit Tiranë, me shkresat nr.497 datë 24.02.2017, me shkresën nr. 609, datë 07.03.2017, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiare Bashkia Tiranë.
Nga grupi i auditimit u kërkua kopje e Pasqyrave Financiare të institucionit për vitin 2015-2016, si:
a- Pasqyrat financiare të vitit 2016,
b- Relacioni shpjegues të plotësimit të tyre;
c- Plotësimin e pyetësorëve;
d- Urdhrin e titullarit për kryerjen e inventarizimit dhe ngritjen e komisionit përkatës, relacionin mbi kryerjen e inventarizimit si dhe inventarin e llogarive inventariale të kryer realisht nga komisioni si dhe akordimin e tij me gjendjen kontabile,
e- Gjendjen e debi kredive.
Referuar kërkesës së grupit të auditimit dokumentacioni na u vu në dispozicion.

Nga zyra e Financës na u vunë në dispozicion dokumentacioni inventarëve fizik dhe kontabël të institucionit, i cili nga krahasimi që u bë me bilancin kontabël të viteve 2015 dhe 2016 rezultuan pa diferenca.

Shifrat kryesore të paraqitura në pasqyrat financiare të vitit 2016 janë si më poshtë vijon.

Aktivi i bilancit në fund të vitit ushtrimor u paraqit.

Në /lekë

Nr	AKTIVI	Viti 2016	Viti 2015
1	Aktivet e Qëndrueshme	736,694,019	605,869,365
2	Aktive Qarkulluese	109,076,611	226,878,281
	Totali Aktivit	**845,770,630**	**832,747,646**

Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara:

Në/ lekë

Llog.	EMËRTIMI I LLOGARIVE TË AKTIVIT	Viti 2016	Viti 2015	Dif. 2015 -2016
A	**AKTIVE TE QENDRUESHME**	**736,694,019**	**605,869,365**	**130,824,654**
20,230	**Të pa trupzuara**	**0**	**0**	**0**
21,23,24,28	**Akltive të qëndrueshme të Trupëzuara**	**736,694,019**	**605,869,365**	**130,824,654**
211	Pyje Kullota Plantacionet	393,924,048	362,609,955	31,314,093
212	Ndërtime e konstruksione	25,626,533	22,428,003	3,198,530
213	Rruge, rrjete ,vepra uji	82,276,662	61,824,106	20,452,556
214	Instalime teknike,makineri pajisje e vegla pune	306,540,292	255,769,425	50,770,867
215	Mjete transporti	338,269,710	365,492,812	-27,223,102
218	Inventari ekonomik	6,848,392	5,998,624	849,768
219	Amortizimi i akt qend (-)	(499,376,138)	(484,167,892)	-15,208,246
231	Shpenzime ne procesAQT	14,410,749	9,823,259	4,587,490
24	Aktive të qëndrueshme të dëmtuara	68,173,771	6,091,073	62,082,698
B	***AKTIVE QARKULLUESE***	**109,076,611**	**226,878,281**	**-117,801,670**
Klasa 3	I. Gjendja e Inventarit (llog.31)	43,553,385	23,147,894	20,405,491
31	Materiale	29,928,210	12,908,055	17,020,155
32	Objekt Inventari	3,715,722	206,642	3,509,080
33	Prodhime pune dhe shërbime në proces	9,909,453	10,030,147	**-120,694**
39	Shuma te paparashikuara për zhv inventari		3,050	3050
Klasa 4	**II. Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët**	**65,523,226**	**203,730,387**	**-138,207,161**
4342	Te tjera operacionale me shtetin (debitorët)	45,026,824	24,322,850	20,703,974
45	Mardheniet me ins brenda dhe jashte sistemit	0	158,911,135	-158,911,135
468	Debitor të ndryshem	20,496,402	20,496,402	**0**
	III. Llogarite financiare	0	0	0
	TOTALIIAKTIVIT (A + B)	**845,770,630**	**832,747,646**	**13,022,984**

Duke analizuar aktivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë aktive janë më shumëse një vit më parë ne shumën **13,022,984** lekë, më shumë se viti 2015, ndërsa me klasa dhe llogari, rezultojnë si më poshtë:

***Llogaritë e aktiveve të qëndrueshme <u>të trupëzuara</u>* (21, 23, 24, 28),** në vlerë **736,694,019 nga 605,869,365 lekë** të një viti më parë janë shtuar më shumë se një vit më parë për **130,824,654** lekë, shtesë e cila përbëhet nga:

Llogaria 211"Pyje Kullota Plantacionet" është shtuar në vlerën **31,314,093** lekë, që përfaqëson blerje peme për gjelbërimin e qytetit .
Llogaria 212 "Ndërtime e konstruksione" shtuar nga një vit më parë për 3,198,530 lekë.
Llogaria 213 "Rruge, rrjete ,vepra uji"shtuar nga një vit më parë për20,452,556 lekë,
Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri", shtuar nga një vit më parë 50,770,867 lekë,
Llogaria 215 " Mjete transporti" pakësuarnga një vit më parë 27,223,102 lekë ,
Llogaria 218 "Inventar ekonomik", është shtuar këtë vitnë vlerë 849,769 lekë.
Llogaria 219 "Amortizimi aktivive të qëndrueshme të trupëzuara (-)", është llogaritur për këtë vit shumë në vlerë -15,208,246 lekë, sipas tabeles së llogaritjes së tij që shoqëronbilancin e këtij viti.

Llogaria 231 shpenzime në proçes, për rritje të AQT ka vlerë 14,410,749 lekë, e cila është e përberë nga ***9,823,259 lekë*** dhe ***4,587,490 lekë***, vlera e parë është e trashëguar ndër vite dhe përshkruan shpenzimet,e bëra për rritjen e AQT (Universiteti i Tiranës para vitit 2006) dhe vlera prej 4,587,490 lekë, përben vlerën e investimit në proces për rikonstruksionin e Lulishtes Llazi Miho "Kombinat".

Llogaritë e aktiveve të qarkulluese (klasa 3&4),

Llogaria 311 "Materiale", është shtuar këtë vit, në vlerë 17,020,155 lekë. Nuk ka detajim analitik për këtë llogari.
Llogaria 327"Objekte inveventari", është shtuar këtë vit në vlerë 3,508,080 lekë. Nuk ka detajim analitik për këtë llogari.
Llogaria 331"Prodhime punime ne proces ", është pakësuar këtë vit në vlerë - 120,694 lekë.
Llogaria 45 "Mardheniet me ins. brenda dhe jashtë sistemit" në vlerën 158,911,135 lekë ka kaluar pranë APR mbas ndarjes së dy Drejtorive në muajin Shtator 2015.
Llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin ", është shtuar këtë vit në vlerë 20,703,974 lekë.
Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm", nuk janë shlyer dhe vazhdojnë të jenë detyrime të mbartura ndër vite pasi institucioni nuk ka asnjë dokumentacion për të filluar likuidimin dhe heqjen e tyre nga llogaria e bilancit në vlëren prej 20,496,402 lekë.

Gjendja e llogarive pasive në fund të vitit 2016, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2015-2016), rezultuan si në tabelën e mëposhtme*:*

Pasivi i bilancit në fund të vitit ushtrimor.

Në /lekë

Llog.	Emërtimi i llogarive të pasivit	Viti2016	Viti 2015	Dif.2016-2015
A	***Fonde të veta***	**800,744,627**	**649,009,120**	**151,735,507**
101	Fondet baze	762,755,803	638,974,120	123,781,683
105	Grande të brendshme kapitale	0	0	
106	Grande te huaja (Donatore)	23,578,075	0	23,578,075
107	VleraAkt.Qend.tecaktuara në përdorim	4,587,490	0	4,587,490
11	**II.Fonde të tjera të vetat**	0	**211,741**	**-211,741**
115	Caktimnga rezultatitivitit për investime	0	211,741	-211,741
	III Rezultat i mbartur			
14	Pjesmarrje te inst ne invest për të tretet	9,823,259	9,823,259	0

B	**DETYRIMET**	**45,026,003**	**183,738,526**	**-138,712,523**
401-408	Furnitore e llogari të lidhura me to	3,324,299	848,756	2,475,543
42	Personeli dhe llogari të lidhura me to	20,781,112	9,208,737	11,572,375
431	Detryrimendaj shtetit	0	156,396	-156,396
435	Sigurime shoqërore	3,326,447	2,568,559	757,888
436	Sigurime shendetsore	0	356,556	-356,556
45	Mardhenie me instit. brenda sistem	0	158,911,135	-158,911,135
467	Kreditor të ndryshem	17,594,145	11,688,387	5,905,758
	TOTALI PASIVIT (A+B)	**845,770,630**	**832,747,646**	**13,022,984**

Sa mësipërm paraqitëm totalin e Aktivit, i cili është i barabartë me totalin e Pasivit.
Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë më shumë se një vit më parë për **13,022,984** lekë, ndërsa me grupe e klasa, janë si më poshtë:
Llogaria fondeve të veta janë shtuar në këtë vit për **123,781,683** lekë, këto fonde i përgjigjen pjesës së aktivit të bilancit.
Llogaritë e detyrimeve afat shkurtëra, është pakësuar në vlerë **-138,712,523** lekë, (të analizuara të Llogaria 42 "Personeli e llogari të lidhura me to",është shtuar këtë vit në vlerë 11,572,375 lekë me arsyetimin se janë shtuar pagat dhe pagat e dhjetorit kalojnë për vitin pasardhës.
Llogaria 431"Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa", është pakësuar këtë vit në vlerë 156,396 lekë:
Llogaria 435"Sigurime shoqerore", është shtuar këtë vit në vlerë 757,888 lekë.
Llogaria 43 "Sigurime shendetesor", është pakësuar këtë vit në vlerë 356,556 lekë. detyrime këto që do likuidohen me çeljen e fondeve buxhetore të vitit të ardhëm, të pasqyruara tek llog 4342.
Llogaria 45 "Mardhenie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit " është pakësuar këtë vit në vlerë **158,911,135 lekë** pasi kjo vlerë ka kaluar ne APR, bashkëlidhur shkresat dhe procesverbalet.
-*Përcaktimi i vlerës së detyrimeve të pa paguara nga blerjet e periudhave të mëparshme*.
Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", është në vlerë 5,905,758 lekë.

Fatura të pa likuiduara furnizime të vitit 2016 për tu shlyer ne vitin 2017, shuma 4,587,490 lekë, rikonstruksion përbën vlerën e investimit në proces për rikonstruksionin e LulishtesLlazi Miho "Kombinat" e cila është në proces Gjyqësorë *si dhe fatura roje private të vitit 2016 shërbim postar ujë energji* detyrime këto që do likuidohen me çeljen e fondeve buxhetore të vitit të ardhëm, të pasqyruara tek llog 467.

Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" është **5,181,306 lekë**, fatura të pa likuiduara si rip garanci 5% ", e cila përfaqëson shumën 5% ndalur për shërbime punimesh, furnizime të ndryshme si furnizim me buke, riparim kondicionershe 5% riparime fotokopje, të cilat shkojnë ne vlerën e mësipërme të cilat janë të pa likuiduara në vite për mos plotësim dokumentacioni .
-Institucioni nuk ka fatura dhe detyrime të pa paguara.

Për Vlerën prej 62.082.698 lekë, të merren masa të hartohen urdhra me komisione të posaçme nga titullari i institucionit për nxjerrjen nga përdorimi të këtyre aktiveve dhe të

shkarkohen nga kontabiliteti, pasi kjo ka sjellë impakt negativ në pasqyrat financiare, për arsye se në aktivet e qëndrueshme mbahen të regjistruara vlerat e këtyre mjeteve të cilat nuk janë në përdorim.

Për këtë vlerë është bërë një shkrese (Relacion) si dhe një procesverbal drejtuar Bashkisë Tiranë, në muajin nëntor të vitit 2009, nga titullari i asaj periudhe ku është mbajt një procesverbal me një komision të posacem mbi gjëndjen teknike aktuale të katër mjeteve (***traktore me zinxhirë***) të cilat i përkasin vitit të prodhimit 1995, në të cilën shprehen se gjendja e këtyre mjeteve është teje e amortizuar dhe janë jashtë kufijve të lejuar teknike për riparimin e tyre**.**

Por nuk është kthyer asnjë përgjigje nga ana e Bashkisë Tiranë.

Llogria 107 në pasiv të bilancit përbëhët nga vlera prej 4,587,490 lekë, e cila është ne proces e trajtuar dhe në aktiv të bilancit, e cila mbetet deri ne përfundimin e procesit gjyqësore dhe marrjen në dorëzim nga DPN1.

Në pasqyren e lëvizjeve CASH të vitit 2016, totali pagesat e vitit në bilanc totali *516,989,718* lekë në strishen e Bankës lëshuar nga Dega e thesarit me vlerë *516,232,988* lekë diferenca prej -756,730 lekë përbën dy faturat të kaluara në sistem SIFQ, te Thesarit Dhjetor 2016, te kaluara në bankë në muajin janar 2017, (913,098 lekë), ndërsa vlera 15,368 lekë perbën vlerën e faturave të dhjetorit 2015, të kaluara në janar 2016.

Ndërsa vlera 156,368 lekë përbën vlerën e faturave të dhjetorit 2015, të kaluara në janar 2016,

913,098 -156,368 = 756,730 lekë .

Në pasqyrën gjendja dhe ndryshime të aktiveve të qëndrueshme (Vlera Bruto) 2016

Kolona Blerje dhe Krijuar me vlere **124,614,609 leke,** përben vlerën e aktiveve te realizuara nga fondi buxhetor; si me poshtë :

1- 111,747,119 lekë paguar 2016,
2- 8,280,000 leke hyre në 2016 e palikujduar,
3- 4,587,490 leke rikonstruksion i Lulishtes Llazi Miho "Kombinat",
Në proces (deri ne dorëzim përfundimtar).

Total **124,614,609 lek**

f) Vlera e donacioneve për vitin 2016 është **23,578,075** lekë, pasqyruar ne pasqyrën 6-7 ne kolonën shtesa jashtë sistemi.

g) Në kolonën Lëvizje brenda aktiveve vlera e paraqitur **3,683,203 lekë**, përbehet nga lëvizje brenda DPN1 të hyrjeve dhe daljeve ndërmjet magazinës rikupero dhe rrjetit të cilat i nënshtrohen riparimit dhe seleksionimit

-Konfirmimi i pagesës së sigurimeve. Saktësimi i Vlersimit të detyrimeve për paga dhe sigurime të pasqyrave ne bilancë në fund të periudhës.

Nga auditimi i dukumentacionit rezulton se sigurimet janë paguar konforme legjislacionit në fuqi,vlerat e paraqitura në bilance janë të sakta dhe pa diferenca.

Formatet e miratuara që shoqërojnë llogarinë vjetore të vitit 2016 janë plotësuar si më poshtë:
Formati 3/1"Shpenzimet e ushtrimit", është plotësuar me zërat përkatës të klasës 6, pra me artikujt 600/paga e shtesa, 601/sigurimet shoqërore, 602/shpenzime operative. Në këtë format janë përfshirë shpenzimet faktike nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor 2016. Pra situacionit vjetor i është zbritur pagesa e detyrimeve që kanë qenë më 1 janar 2016 në bilanc dhe i janë shtuar detyrimet të cilat kanë ngelur si detyrim për vitin e ardhshëm.

Formati 3/2 "Të ardhurat e ushtrimit", është plotësuar duke përfshirë grantet korente të brendeshme, pra, janë paraqitur shpenzimet faktike të vitit 2016, duke zbritur likujdimet e deturimeve të trashëguara, plus zëri financim i pritshëm nga buxheti, për detyrimet e fund vitit që do të likujdohen në janar 2017. Pra kuadratura e llogarisë 7206 në këtë format është e barabarte me llogarinë 4342 në aktiv të bilancit dhe si përfundim, pasqyra 3/1 është e barabartë me pasqyrën 3/2 që shoqërojnë llogarinë vjetore të 2016.

Formati 4 "Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet për vitin 2016", është plotësuar duke përfshirë grantet të brendëshme kapitale. Tepricë në çelje kjo llogari nuk ka, sikur dhe gjendje në fund të vitit 2016, **sepse projektet e likujduara pjesërisht, nuk kontabilizohen në llogaritë 230 dhe 231** "shpenzime për investime në proces", por direkt bëhen hyrje në llogaritë e aseteve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.

Formati 5"Pasqyra e levizjes "Cash" për vitin 2016", është plotësuar sipas situacionit faktik të shpenzimeve, ku janë të rregjistruar fondet buxhetore kornete dhe kapitale (plani me ndryshimet), pagesat për shpenzime korente dhe kapitale faktike dhe gjendja në fund e autorizimeve buxhetore të papërdorura. Këto shifra për çdo zë janë të konfirmuara dhe të kuadruara nga dega e thesarit.

Formati nr.6 "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qendrueshme (vlera bruto) 2016", është plotësuar sipas gjendjes dhe lëvizjes së bërë sipas klasave dhe hyrjeve faktike dhe burimeve të financimit.

Amortizimi është llogaritur për çdo grup veç e veç sipas klasifikimit ekonomik dhe sipas normave te paraqitura. Si gjendjet ne fillim, hyrjet daljet dhe gjendja në fund të këtyre 2 pasqyrave, janë të barabarta me llogaritë në aktiv të bilancit.

Formati 8 Pasqyra e levizjes se fondeve", është plotësuar duke filluar si në çelje, ashtu edhe lëvizjet debi e kredi dhe gjendja në fund është e barabarte me pasivin e bilancit, e kuadruar me fondin në total.

Formati nr.9 "Numri i punonjësve dhe fondi i pagave", është plotësuar pjesa për gjendjen lëvizjet dhe gjendja në fund e punonjësve, është plotësuar nga burimet njerëzore, ndërsa pjesa për fondin e pagave është e plotësur sipas të dhënave nga pasqyra e shpenzimeve.

Opinion: Në pasqyrat financiare janë konstatuar parregullsitë dhe shkelje në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare që janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin neni 12, me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël" si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2007 për institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhim/zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të huaj" të ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007.

Për këto veprime të kryera në kundërshtim me ligjet e sipërcituara mbajnë përgjegjësi:
z. --------- në cilësinë e hartuesit të pasqyrave Financiare dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues të njësisë për këtë periudhë.
***znj.* ---------** në cilësinë e personit të autorizuar nga titullari për zëvendësimin e tij si nëpunëse autorizuese e njësisë**.**

2. Mbi auditimin e ushtruar në DPN.1, Tiranë "Mbi ndarjen e mjediseve të punës, mjetet të punës, automjeteve, furnizimimeve dhe gjendjes në magazinë për vitin 2015 ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 dhe Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit".

Nga auditimi i kryer mbi ndarjen dhe riorganizimin e kësaj Ndërmarrjeje rezultoi se:

Në zbatim të Ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 për "Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" (I Ndryshuar);Vendimit Nr. 41, datë 23.09.2015 të Këshillit Bashkiak Për "Riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe Krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit" pika 8 ; *Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë me Nr. 15772, datë 22.10.2015 për "Ndarjen e mjediseve të punës, mjetet të punës, automjeteve, furnizimeve dhe gjendjes në magazinë për vitin 2015 ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 dhe Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit"; si dhe Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*

DPN1 dhe APR kanë hartuar Akt- Marrëveshjen dypalëshe me Nr.2585 prot. Datë 29.10.2015 te DPN1 dhe nr.221 prot, datë 29.10.2015 "Për ngritjen e Komisionit të përbashkët për zbatimin e urdhërit të kryetarit të bashkis nr.15772 datë 22.10.2015"
Për sa më lartë komisioni në datë 03.11.2015 ka hartuar Proces - Verbalin në të cilin, në zbatim të Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë kanë konstatuar :
Ndarja e mjediseve të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit në rrugën "5 Majit*"duke i kaluar në përdorim* Agjencisë së Parqeve të Rekreacionit, në katin e dytë të godinës , gjysmës në krahun e majtë të hyrjes, si dhe ambienteve të magazinave, kapanonet e punës, oficina, hapësirë parkimi në oborr, si dhe dy kapanone serash në rrugën :Jordan Misja" sipas planimentrive bashkëngjitur.

Gjysma e kapanonit të mirëmbatjes sëbashku me paisjet dhe veglat e punës janë të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit dhe gjysma tjetër e kapanonit të mirëmbatjes i kalon në përdorim Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit.
- Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë mbi ndarja e mjeteve, veglave e paisjeve të punës në zyra si dhe mobiliet, të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit duke I kaluar në formën e kapitalit Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit" .
-Mjetet dhe veglat e punës nga Nr. 1 -9
1.Gjenerator saldimi 3 fazor copë 1*264,000 = 264,000 lekë
2.Motosharrë saldimi R17440 copë 1*98,904 = 98,904 lekë
3. Motosharrë në lartësi copë 1*90000 = 90,000 lekë
4. Motosharrë bari copë 1*72,000 =72,000 lekë
5. Prerëse bari copë 1*36,000 = 36,000 lekë
6.Prerëse ligjustrashcopë 1*72000 = 72,000 lekë
7.Prerësbari ferrashcopë 1*72000 = 72,000lekë
8. Korrësebaricopë 1* 168000 =168,000lekë
9. Motokorresecopë 1* 52800 =52,800lekë
SHUMA=925, 704lekë (nëntëqindnjëzetëpesëmijë e shtatëqindekatër)

B- Pajisjet e punësdhe mobiljet me vlerën lekë, sipas pasyrës bashkëlidhur Me Nr.1-184 dhe me vlerë **5 416 313 lekë**(Pesëmilion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqinde e trembëdhjetë) lekë

Pika Nr.3 dhe pika nr 5 **:** Për ndarjen e automjeteve dhe sasinë e karburantit është bërëme process-verbalme datë 31.10.2015 i cili është bashkëlidhur. Ku në mbështetje të pika 5 të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë, ndarja do të bëhet sipas sasisë mesatare mujore të konsumit të automjeteve që i kalojnë në kalim capital APR(25% e totali mujor) pra APR i kalojnë1 640 litra nafte dhe 250 litra benzinë nga gjëndja aktuale dhe me tej do marrë nga çdo furnizim sipas % specifike.Ndersa Mjetet e Transportit që i kalojnë APRsipas janë në vlerë 35,922,789 lekë .

*Pika Nr.4*E Urdhërit të Kryetarittë Bashkisë mbi ndarjen e gjendjes së kancelarive në magazinë (bojë printer, mjeteve shkrimi, letër ,blloqë, kapëse, dosje , bojë fotokopje)duke kaluarnë masën 40% Agjencisë Parqeve dhe Rekreacionit sipaslistësbashkëlidhur në vlerën: 149 309 (Njëqind e dyzet e nëntëmijë e treqind e nëntë) lekë sipas fletë daljeve Nr.280,281,281,datë 18.12.2015 dhe me fletë-hyrje të APR nr.17,18,datë 18.12.2015.

Pika Nr.6 Ndarjen e shërbimeve furnizimeve me mallrat ë prokuruara për vitin 2015 të cilatjanë të domosdoshme për realizimin e detyravefunksionaletë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, si dhe çdo shtesë e kontrataveaktualetë furnizimit të lidhura ngaDrejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit derinë realizimin e prokurimitpërkatës për vitin 2016 ndarja do të kryetnë mënyrë propocionale sipas nevojave të secilit institucion.

Eshtë nënshkruar Akt – Marrëveshja dypalëshe me Nr.3374.Prot, datë 11.12.2015 (Nr.Prot.DPN1) dhe Nr.378.Prot, datë 11.12.2015 (Nr.Prot.APR) ku është ngritur komisioni i përbashkët me punonjësit:
Për sa më lartë:

Është mbajtur procesverbal me nr.378/1 Prot,datë 31.12.2015 (Nr.Prot APR), dhe Nr.3533.Prot, datë 31.12.2015 (Nr.prot DPN.1) Mbi marrjen ne dorrëzim të intentarit fizikdhe kontabël për sektorët (ParkuMadh, Parku Memorial Varrezat e Dëshmorëve të Kombit Tiranë dhe Pezë dhe Kopshti Zoologjik) që kalojnë në APR.
Komisioni i mësipërmkreu akt – dorëzimet dhe marrjen në dorrëzim të inventaritfizik dhe kontabël për sektorët(ParkuMadh,Parku Memorial Varrezat e Dëshmorëve të KombitTiranëdhe Pezë dhe Kopshti Zoologjik) që i kalojnë APR, konkretisht :
Bashkëngjitur proces-verbalit përmbledhës, janë Procesverbalet për çdo sektor që kalon në APR (ParkuMadh,Parku Memorial Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, Tiranëdhe Pezë dhe Kopshti Zoologjik, Serat e Luleve) me inventarin fizik dhe vlerën përkatësesipas numrit të llogarive.Në total vlera **122,335,068 lekë** kaluar APR .
Gjithashtu bashkëngjitur gjenden inventari i bimësisë dekorative që i kalon APR me sasinë total 2620 copë dhe vlerë 33 654 412 lekë, inventari i imët llogaria 327 e ndarë me sektorë e persona në vlerë 232 476 lekë dhe tabela e amortizimit e ndarë sipas llogarive përkatëse.
Është mbajturprocesverbal me nr.378/2 Prot,datë 31.12.2015 (Nr.Prot APR) dhe me Nr.3533/1.Prot,datë 31.12.2015 (Nr.prot DPN.1) Mbi marrjen ne dorrëzim të intentarit fizikdhe kontabël për sektorinParku Memorial Varrezat e Dëshmorëve të KombitTiranëdhe Pezë që kalojnë në APR.
Komisioni i mësipërmka kryer akt – dorëzimet dhe marrjen në dorëzim të inventaritfizik dhe kontabël për sektorinParku Memorial Varrezat e Dëshmorëve të KombitTiranëdhe Pezë që kalojnë në APR, konkretisht :
Inventari Fizik (Terrene/Troje) Llogaria 210 në vlerë 49 397 920 lekë
Inventari Fizik (Ndertesa) Llogaria 212 në vlerë 60 654 lekë
Inventari Fizik (mjet kryesor, Kosha) Llogaria 214 në vlerë 254 705,8 lekë
Inventari Fizik (mjet kryesor, Stola) Llogaria 214 në vlerë 634 934,5 lekë
Inventari Fizik (mjet kryesor, Kazana) Llogaria 214 në vlerë 329 940 lekë
Inventari mallra material dhe inventari imët Llogaria 327 në vlerë 8 120 lekë
Është mbajtur procesverbal me nr.378/3 Prot,datë 31.12.2015 (Nr.Prot APR) , dhe Nr.3533/2.Prot,datë 31.12.2015 (Nr.prot DPN.1) Mbi marrjen ne dorrëzim të një pjesë të bimësisë së serave që kalojnë në APR.
Komisioni i mësipër ka paraqiturakt – dorëzimet dhe marrjen në dorrëzim të për ndarjen e bimësisë së kultivuar në objektin serat e Luleve sipas marrëveshjes dypalëshe për sasinë 25 %.
Është mbajturprocesverbali me nr.378/4 Prot,datë 31.12.2015 (Nr.Prot APR) dhe Nr.3533/3.Prot,datë 31.12.2015 (Nr.prot DPN.1) Mbi marrjen ne dorëzim të intentarit fizikdhe kontabël për sektorinParku Zoologjik që kalojnë në APR.
Komisioni i mësipërka paraqitur kreu akt – dorëzimet dhe marrjen në dorëzim të inventaritfizik dhe kontabël për sektorinParku Zoologjik që kalojnë në APR, konkretisht :
Inventari Fizik (Ndërtesa) Llogaria 212 në vlerë 20 745 764 lekë
Inventari Fizik (mjet kryesor, Kosha) Llogaria 214 në vlerë 373 031.6 lekë
Inventari Fizik (mjet kryesor, Stola) Llogaria 214 në vlerë 1 048 813 lekë
Inventari Fizik (mjet kryesor, Kazana) Llogaria 214 në vlerë 147 240 lekë
Inventari mallra material dhe inventari imët Llogaria 327 në vlerë 30 526 lekë

Inventari i kafshëve Llogaria 217 total 33 kafshë dhe shpendë në vlerë 1 156 900 lekë.
Është mbajtur procesverbal me nr.378/5 Prot, datë 31.12.2015 (Nr.Prot APR) dhe Nr.3533/4.Prot,datë 31.12.2015 (Nr.prot DPN.1) Mbi marrjen ne dorëzim të intentarit fizik dhe kontabël për sektorin Parku Liqeni i Tiranës Parku i Madh që kalojnë në APR
Komisioni i mësipërm ka kryer akt – dorëzimet dhe marrjen në dorëzim të inventarit fizik dhe kontabël për sektorin Parku i Liqenit Tiranë (Parku i madh) që kalojnë në APR, konkretisht;
Inventari Fizik (Nd ërtesa) Llogaria 212 në vlerë 286 064 lekë
Inventari Fizik (mjet kryesor, Kosha) Llogaria 214 në vlerë 350 640 lekë
Inventari Fizik (mjet kryesor, Stola) Llogaria 214 në vlerë 596 000 lekë
Inventari Fizik (mjet kryesor, Kazana) Llogaria 214 në vlerë 537 300 lekë
Inventari mallra material dhe inventari imët Llogaria 327 në vlerë 6 910 lekë
Inventari i bimësisë Llogaria 211 situacionenë vlerë 127 530 lekë
Për sa më lartë në zbatim të Akteve ligjore në fuqi, sipas dokumentacionit zyrtar dypalësh të mbajtur nga dy Institucionet, te detajuar sa më lartë, në total Vlera e cila është kaluar nga DPN1 te APR 158,911, 171 lekë si marrëdhënie Brenda sistemit.
Është bërë ndarja e mjediseve të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit në rrugën "5 Majit" duku i kaluar në përdorim Agjencisë së Parqeve të Rekreacionit,në katin e dytë të godinës, gjysmës në krahun e majtë të hyrjes, si dhe ambienteve të magazinave, kapanonet e punës, oficina, hapësirë parkimi në oborr, si dhe dy kapanone serash në rrugën Jordan Misja.
Ndarja e mjeteve, veglave, paisjeve të punës në zyra si dhe mobiljeve, mjediseve të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit duke I kaluar Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit" bërë kalim kapital. Ndarja e automjeteve të transportit të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit duke I kaluar Agjencisë së Parqevë dhe Rekreacionit. Ndarjen e gjendjes së kancelarisë në magazinë (bojë printer, mjeteve shkrimi, letër, blloqe, kapëse, dosje, bojë fotokopje) në masën 60% për Drejtorinë e Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit dhe 40% Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit" dhe të gjitha këto janë bërë me komision të përbashkët me akt- marrëveshje me procesverbal.

3. Regjistri i aktiveve dhe administrimi i pronës shtetërore.

Nga auditimi i kryer në *Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë* për rregjistrin aktiveve në këtë njësinga dokumentacioni i vënë në dizpozicion rezultoi se:
Kjo njësi nuk ka të mbajtur rregjistër të aktiveve, *veprime të cilat bien në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010* "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ku përcaktohen qartë.Në kundërshtim të*udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011* "Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë ë sektorit Publik" keru IIIRegjistri i aktiveve të njësite të sektorit publik pika 26,27,28, 30.
Menaxhimi i aktiveve është një pjesë themelore e menaxhimit financiar, prandaj është një prej përgjegjësive të Nëpunësit Autorizues në njësitë e sektorit publik. Çdo njësi duhet të vendosë procedura për pranimin, përdorimin efektiv, efiçent për ruajtjen, qarkullimin dhe asgjësimin e aktiveve nën kontrollin e tyre.
Regjistrat e aktiveve: Është një praktikë e mirë pune për çdo njësi që të hartojë, të mbajë dhe të rifreskojë një regjistër të të gjitha aktiveve që ajo ka në pronësi dhe që përdor. Ky regjistër do të jetë i vlefshëm në përgatitjen e llogarive të saj. Është gjithashtu një praktikë e mirë, që të verifikohet gjendja e aktiveve aktuale të njësisë dhe të planifikohen ndryshime. Regjistri i

aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet e luajtshme dhe ato të paluajtshme si dhe të specifikojë aktivet, të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën kontrollin e tij ligjor.
Pika 26. Çdo njësi Publike duhet të krijojë dhe të përditsojë një rregjistër kontabël të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshirë dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura .Regjistri mbahet në formenkartelave ose në forme të sintetizuar.
Pika 27. Nenpunesi i Autorizuar i njësië, Brenda strukturës së institucionit cakton nënpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e rregjistrit",.
Pika 28 .Regjistri i aktiveve vetë njësisë duhet të përfshijë si aktivet afatë gjata ashtu dhe aktivet afatë shkurta material dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet te cilat gjendën në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë në forëm pjesmarrje në kapital".
Pika 30.Formati i rregjistrit të aktiveve hartohet në vartësi llojit të tyre afat gjatë apo afatë shkurtër si dhe grupi përkatësë Brenda llojit.Kerkedsat minimale që duhet të përmbajë rregjistri I aktiveve në vartësi të llojit ,perfshijnë :Data e hyrjes ose e marrjes në dorzim,pershkrimi I aktivitetit,vlera e blerjes,data e hyrjes së mallit,vlera e shpenzimeve kapitale të mëpashme që sjellë rritje të vlerës së aktivit ".
Po kështu, përgjegjësia e personave të ngarkuar me lëvizjen e aktiveve monetare e materiale,rrjedh dhe nga mos zbatimi i kërkesave ligjore të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011" Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", në pikën 12 e 20, ku përcaktohet që :

12. Aktivet jepen në ngarkim të punonjësve të cilët kanë përgjegjësi ligjore për humbjet, dëmtimet e shpërdorimet, pasqyrimin me saktësi në dokumentacionin përkatës të të dhënave, si dhe për gjendjen e lëvizjen e aktiveve që kanë në ngarkim.
*20. Ka një numër rastesh ose situatash të mundshme të cilat mund të kenë ndikim në aftësinë e aktiveve për të përmbushur misionin e tyre dhe për të arritur objektivat që njësia ka caktuar për to. Të tilla përmenden vjedhjet, vandalizmat, dëmi i shkaktuar nga përmbytjet, zjarri, kushtet e kohës, avaritë**,** konsumimi dhe shpërbërja e pajisjeve, vjetrimi fizik dhe teknik, mospërshtatja me objektivin për shkak të ndryshimit të kërkesave teknike, etj.*
"Pika 6. Mbi bazën e rregullave dhe procedurave të miratuara nga titullari i njësisë publike, përgjegjësitë për menaxhimin e aktiveve duhet të shpërndahen nga nëpunësi autorizues në njësinë publike nëpërmjet një sistemi delegimesh dhe ndarje funksionesh me rregulla të qarta dhe të dokumentuara. Çdo individ duhet të jetë i qartë dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij mbi aktivet e njësisë.

Mbi inventarizimin e pronës shtetërore për vitin 2016.
Auditimi i inventarizimit të pronës shtetërore për vitet 2016 u krye në përputhje me legjislacionin e mëposhtëm:
-Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe *Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30,* datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", datë ku përcaktohen qartë:
Kategori kryesore të aktiveve afatgjata të sektorit publik janë*: Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara:* Toka, ndërtesat, aktivet të trupëzuara të dhëna me lizing, magazinat dhe dyqane,

fabrikat dhe makineritë, pajisjet, automjetet, mobilie dhe montimet, aktivet në ndërtim, aktivet fizike të dhuruara, aktivet e infrastrukturës, aktivet të trashëguara, punimet e artit dhe antikuariatet, soft-ëare që zhvillohet nga vetë njësia. *Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuara dhe Financiare:* E drejta e autorit, markat, franchises, patentat, të drejtat e pronësisë intelektuale, emri i mirë, të dhënat dhe informacioni, njohuritë dhe knoë-hoë, liçencat e përdorimit të soft-ëare-ve, aksionet dhe obligacionet, kapitali i dividendit publik, huatë dhe depozitat dhe investime të tjera.
Lista e aktiveve për inventarizim hartohet nga Nëpunësi Zbatues në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë.

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi. Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës për monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë publike, jep llogari tek Titullari për mënyrën e funksionimit të tyre dhe ka detyrimin që të kryejnë të gjitha analizat deri në vlerësimin për ngarkim shkaktarëve që lejojnë veprime abuzive në trajtimin e aktiveve.
Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për: Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit. *Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike". Personat e ngarkuar për kryerjen e inventarizimeve mbajnë sipas rastit përgjegjësi disiplinore, materiale a penale për moskryerjen me saktësi të inventarit.*

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.20, datë 17.11.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", citohet: "Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe me urdhër/udhëzim të miratuar nga titullari i njësisë publike.
Komisioni I inventarizimit nuk ka hartuar dhe përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësim paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet, lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara.gjendjen fizike dhe vërejtjet, lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues".
Për vitin 2016. Në zbatim të pikës 81 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",Titullari I njësisëka nxjerrë Urdhëra të Brendshëmpër Ngritjen e Komisioneve të Inventarizimeve për çdo Llogari Ekonomike në kuadër të mirëmenaxhimit të aseteve të drejtorisë.

Me urdhrin e brendshëm nr.3965, datë 30.12.2016, është urdhëruar nga Nëpunësi Autorizues në cilësinë etitullarit tëinstitucionit ngritja e komisionit të inventarizimit,mbi inventarizimin e Aseteve ,Inventari Ekonomiknë kuadër të mirë menaxhimit të aseteve në institucion, i cili është i

përbërë nga 3 antarë: ----------.Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri: Drejtoria e Planifikimeve, Menaxhimit dhe sherbimeve dhe Financë .
Kjo llogarieshtë në vlerë 6, 848,392 lekë .
Me urdhrin e brendshëm nr. 3967datë 30.12.2016, është urdhëruar nga Nëpunësi Autorizues dhe titullari i institucionit ngritja e komisionit, mbi inventarizimin e magazinës Qendrore e përbërë nga komisioni ----------, me vlerë 29,922,189 lekë.
Me urdhrin e brendshëm nr. 3969 datë 30.12.2016, është urdhëruar nga Nëpunësi Autorizues dhe titullari i institucionit ngritja e komisionit, mbi inventarizimin e Aseteve,Mjete Transporti.me anëtare Rakip Osmani, --------- dhe --------- ,artikujsh nga 1-49 me vlerë 338,269,710 lekë.
Me urdhrin e brendshëm nr.3968 datë 30.12.2016, është urdhëruar nga Nëpunësi Autorizues dhe titullari i institucionit ngritja e komisionit të inventarizimit,e prodhimeve në proces.me nr artikujsh nga 1-167 me vlërë 9,909,453 lekë .
Me urdhrin e brendshëm nr.3971, datë 30.12.2016, është urdhëruar nga Nëpunësi Autorizues dhe titullari i institucionit ngritja e komisionit, mbi inventarizimin e Aseteve ,Instalime teknike paisja dhe vegla pune me komision Kujtim Mane ,--------- ,dhe ----------, me vlerë 4,086,218 lekë.
Me urdhrin e brendshëm nr.3977, datë 30.12.2016, është urdhëruar nga Nëpunësi Autorizues dhe titullari i institucionit ngritja e komisionit, mbi inventarizimin e Aseteve, Ndërtime e Konstruksione edhe rrugë,Rrjete e vepra Ujore.me vlerë 25,626,533 lekë.
Në bazë të proçes verbalit të mbajtur nga komisioni I ngritur për inventarizimin e MagazinësRikupero me urdhërinnr.3963/1 Prot. Datë 20.01.2017 gjendja kontabël në fudë të periudhës."Llogaria " 245,964,669 lekë.
Gjendja në"Llogari311" , 29,928,148 lekë,
Gjendja në"Llogarinë 214", stola kosha kontenierë , Instalime Teknike,Pajisje, Instrumente dhe Vegla Pune" në vlerë 306,540,292 lekë,
Gjendja në"Llogarinë 215 "Mjete Tranbsporti"në vlerë 338,269,710 lekë,
Gjendja në"Llogarinë 211 "Për Pyje, Kullota Plantacione"në vlerë 393,924,048 lekë
Gjendja në Llogaria 218 "Inventari Ekonomik" 6,848,392 lekë,
Gjendja në Llogaria 212 " Ndertime e konstruksione " në vlerë 25,626,533 lekë
Llogaria 213. "Rrugerrjete" 82,276,662 lekë .
Në bazë të proçes verbalit të mbajtur nga komisioni I ngritur për inventarizimin e MagazinësRikupero me nr.3963/1 Prot. Datë 20.01.2017 gjendja kontabël në fund te vititrezulton e njëjtë me gjendjen fizike të Magazines Rikupero, në vler 5,964,669 lekë
Fillimi i procesit të inventarizimit kishte këto mangësi:
Sektori i Financës nuk kishte një regjistër të mirëfilltë të aktiveve, me të gjitha karakteristikat e hyrjes (numrin dhe datën faturës dhe kush e ka në ngarkim, llogaritjen vjetore dhe progresive të amortizimit, shtesat dhe pakësimet gjatë vitit dhe gjendja në fund të vitit ushtrimor.

Veprime të cilat bien në kundërshtim të udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011, të Ministrit të Financave "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit public" të ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

-Nga auditimi i kryerme zgjedhje dokumentave të magazinave rezulton se flete hyrjet dhe flete daljet ishin të prera në rregull me numër rendror në mënyrë kronologjike si dhe te rregjistrur ne libër magazine , çdo fletë hyrje dhe daljë ishteefirmosur nga përgjegjësi material(magazinier) si dhe nga marresi i mallit,në rastet e daljeve nga magazineishin të shoqeruarame urdhër dorzimi bashkëlidhur .

Si konkluzion:

a. Nga komisioni i inventarizimit është mbajtur proces verbali i rezultateve të inventarizimit të cili nuk i është vënë në dizpozicion dhe nuk është konfirmuar nga Drejtorja e Përgjithshme dhe cikluar vetëm me firmat e komisionit "Mbi inventarizimin etë gjthaaktiveve të qëndrueshmetë trupëzuara", pa përfshirë edhe inventarin e imët dhe materialeve të konsumit në magazine.

b. Në disa raste, **n**uk kishte në dosjen e inventarizimit*proces verbal për fillimin* e inventarizimit, ku të përcaktohej numri i fundit i fletë hyrjeve dhe fletë daljeve të magazinës.

c. Në proces verbalin e rezultateve të inventarizimit theksohej se, në listat e aktiveve dhe vlerën e tyre *ndodheshin së bashku edhe vlerat e aktiveve të dëmtuara*gjendje në magazinë dhe në kontabilitet, gjë e cila bie në kundërshtim me ligjin dhe udhëzimin e mësipërm.

ç. Në këtë proces-verbal, *nuk është përcaktuar lista e pajisjeve dhe objekteve të inventarit për jashtë përdorimit***,** pra nuk janë grupuar, nuk u është llogaritur amortizimi i akumuluar për secilin artikull apo grup artikujsh, mbi bazën e viteve të përdorimit dhe normave të amortizimit dhe pastaj të procedohej me fotografimin dhe marrjen e mendimit më të specializuar teknik për vlerësimin e tyre.

d. Kartelat personale të inventarit në ngarkim të punonjësve *ishin të pa sakta* dhe të plotësuara formalisht sepse:

Nuk kishte kartela me të dhënat pajisjet në ngarkim të punonjësve*; të pa* plotësuara me periudhën kohore;

- Për këtë vit**,** inventarizimi për aktivet qarkulluese për llogaritë 312 "Materiale" dhe 327 "Objekte inventari", nuk ka dalë urdhër i vecantë nga titullari por është një urdheri përbashkët për inventarizimin e tyre i cili vështirësonnxjerrjen të këtyre llogarive nga Sektori i Financës.

Nga auditimi rezultoi se nuk është kryer Kontabilizimi i ditarit të magazinaveveprime të cilat bien në kubndërshtim te udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011.si dhe ligjin i "Kontabilitet nr. 9228 datë 29.04.2004"neni 3 pika1.

1. Sektori i Financës nuk kishte një regjistër të mirëfilltë të aktiveve, me të gjitha karakteristikat e hyrjes (numrin dhe datën faturës dhe kush e ka në ngarkim) , llogaritjen vjetore dhe progresive të amortizimit, shtesat dhe pakësimet gjatë vitit dhe gjendja në fund të vitit ushtrimor.

2. Nga komisioni i inventarizimit është mbajtur proces verbali i rezultateve të inventarizimiti pa i konfirmuar nga Drejtorji I Përgjithshme *dhe cikluar vetëm me firmat e komisionit* .

3. Nuk kishte në dosjen në të gjitha rastete *inventarizimit proces verbal* për fillimin e inventarizimit, ku të përcaktohej numri i fundit i fletë hyrjeve dhe fletë daljeve të magazinës.

Veprime të cilat bien në kundërshtim të udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011 të Ministrit të Financave "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit public" të ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Përgjegjës për këto veprime janë :
znj. --------- si nënpunëse zbatuese të DPN 1 për periudhën e mësipërme.
z. --------- Drejtor i Planifikimit Menaxhimit dhe sherbimit.
znj. ---------- në cilësinë e speciaistes së financës.
Si dhe komisioni i inventarizimit sipas urdhërave të ngritur nga titullari për mos zbatim te udhëzimit dhe ligjit të sipërcituar.

4.Auditimi i ushtruar mbi Gjendjen e mallrave stok dhe me qarkullim të ngadalshëm.Kryerja e inventarit të aktiveve qarkulluese. Saktësia e vlerës së inventarëve ekonomik pasqyruar në pasqyrat financiare dhe konfirmimi i vlerëssë inventarit fizik.

Për periudhën e audituar nga dokumentacioni i venë në dispozicioni nga subjekti i audituar u konstatua se kamallrastok dhe me qarkullim të ngadalshëmnë vlerën 9,102,723 lekë, vlerë kjo e trashëguar ndër vite.

Për periudhën e audituar ishin ngritur urdhrat nga titullari, për kryerjen e inventarizimit të cilat ishin përfunduar në kohën ë caktuar në urdhra dhe nuk u konstatuan diferenca, gjendja kontabile ishte e barabarte ne gjendjen fizike .

Pas kryerjes se inventarizimit të materialeve dhe inventarit ekonomik, është ngriturnga Titullari i institucionit urdhri i brendshëm nr. 742 datë 23.03.2017, "Për vlerësimine aktiveve". Komisioninga titullari është ngritur duke u bazuar në udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësite e sektorit Publik ".

Me*shkresën me nr. 742/1datë 20.06.2017, i është*përcjellë *Bashkisë Tiranë, për ngritjen e një grupinga strukturate kësaj njësie, për nxjerrjen nga përdorimi të materialeve stok dhe me qarkullim të ngadalshëm.*

Kryerja e inventarit të aktiveve qarkulluese. Për periudhen e audituar ne DPN 1,është kryer inventari i aktiveve qarkulluese me urdhërim nr. 3964datë 21.12.2016. Nga kryerja e inventarzimit rezulton se nuk ka difernca midis inventrit fizik dhe atij kontabil, rezulton segjendja e aktiveve qarkulluese në fund të periudhës 31.12.2016, rezulton në klasën 3 "Aktive qarkulluese", në vlërë 109,076,611 lekë .

-Saktësia e vlerës së inventarëve ekonomik pasqyruar në pasqyrat financiare dhe konfirmimi i vlerës së inventarit fizik.
Vlera e inventarit ekonomik e pasqyruar në pasqyrat financiare paraqitet sipas inventarit fizik në vlera 6 ,848,392lekë .

-Auditimi mbi statusin juridik të tyre regjistrimin në ZVRPP.

Nga auditimi i kryer mbi statusin juridik të *Drejtorisë së Përgjiothshme të Punëtorëve Nr.1 të* Qytetit Tiranë, si dhe regjistrimi në ZVRPP-së, u konstatua se ndertesa në të cilën kjo Ndërmarrjekryen aktivitetin e saj, nuk është në pronësi pasi këto janëndërtesa në pronësi të Bashkisë Tiranë.

Në zbatim të pikës 3 dhe nënpikës të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
Nga auditimi me zgjedhje i kryer për dokumentimin dhe përdorimin e karburantit në këtë drejtori konstatohet se kjo drejtori me ndarjen e re teritoriale ka shtrirje të gjerë në pastrimin dhe gjelbërimin e ambjentit. Lëvizjet e mjeteve shoqëroheshin me urdhra pune të cilët hartoheshin çdo fillim muaji dhe javë të miratua nga titullari i njësisë.
Duhet theksuar se duhet kryer monitorimi në çdo rast për transoprtimin e mbejteve në çdo rast dhe te evidentohet si dhe të kryhen relacione përmbledhëse në fundë të çdo muaji.
Nga auditimi me zgjedhje i kryer për dokumentimin dhe përdorimin e karburantit në këtë drejtori konstaohet se me ndarjen e re territoriale ka shtrirje të gjerë në pastrimin dhe gjelbrimin e ambjentit. Lëvizjet e mjeteve shoqëroheshin me urdhra pune të cilët hartoheshin çdo fillim muaji dhe javë, të miratua nga titullari i njesisë.
Duhet theksuar se duhet kryer monitorimi në çdo rast për transportimin e mbetjeve dhe të evidentohet si dhe te kryhen relacione përmbledhese në fund të çdo muaji.
Nga auditimi i kryer per mbajtjen e kartelave të çdo mjeti theksojmë se nuk kishte nje rregjister ose kartele të mirfilltë në mënyre qe të evidentohen të përshkruhen gjithe të dhënat që nga hyrja ne magazinë e deri te shërbimet e kryera për çdo mjet.
Për përdorimin e karburantit për dy gjenratorët u konstaua se pavarsisht punës që kryejnë dy gjeneratorët për prerjet prishjet etj., në bashkëpunim me task force dhe urdhrave të nxjerrë nga Bashkia Tiranë, duhet të kenë nje dokumentacion më të plotë për të justifikuar sa më mire dhe me eficencë përdorimin e karburantit. Po ashtu nuk ka informacion (Nga librat e inventarit) për amortizimin e gjeneratorwve, mungon informacioni i vitit të prodhimit e montimit dhe patenta shoqëruese.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë në lidhje me

1.Saktësia e pasqyrimit të të ardhurave sipas llojit të tyre (transferime nga buxheti, të krijuara vetë, grande, finacime të llojeve të ndryshme), paraqitja e drejtë e transaksioneve në kontabilitet.
2.Auditim me zgjedhje mbi organizimin, dokumentimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore që realizohen nga aktivitetet.
Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve Nr.1 e Qytetit, për periudhën objekt auditimi ka dhënë me qira 2 prona në vartësi, si mëposhtë:
1."---------" me një sipërfaqe prej 3510 m², referuar kontratës së datës 12.04.2001, nënshkruar nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë), përfaqësuar nga ---------, në cilësinë e qiramarrësit.
Kontrata është nënshkruar me afat 20 vjet dhe në nenin 6 "Pagesa e qirasë" citohet se qiramarrësi detyrohet t'i paguajë qiradhënësit detyrimin mujor të qirasë në vlerën 10$ dhe 93,334 lekë/muajbrenda datës 5 të çdo muaji.
Bazuar në dokumentacionin në dispozicion konstatohet se nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve Nr.1 e Qytetit, është ndjekur arkëtimi për detyrimin e qirasë nga qiramarrësi si edhe janë plotësuar evidencat e kërkuara nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore dhe Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë), në lidhje me nivelin e pagesave të qirasë dhe paraqitjen e dokumentacionit ligjor të qiramarrësit.

Qiramarrësi, ka shlyer detyrimet e qirasë çdo muaj në zbatim të kontratës deri në muajin qershor të vitit 2016.
Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.337, datë 04.05.2016 "Për shkëmbimin e pronës me Nr.2/141, me emërtim "---------", me sipërfaqe 3510 m², në zonën k---------le 8280, Tiranë, me pronën me Nr.2/345, me emërtim "Truall" me sipërfaqe 3660 m², në zonën k---------le 8280, Tiranë", është vendosur shkëmbimi i pronës shtetërore me nr.2/141, me emërtim "---------" me sipërfaqe 3510 m², në zonën k---------le 8280, Tiranë, në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1, të Qytetit, në varësi të Bashkisë Tiranë, me pronën me nr. /345, me emërtim "Truall" me sipërfaqe 3660 m², në zonën k---------le 8280, Tiranë", në pronësi të shoqërisë "---------" sipas planvendosjes dhe kartelave bashkëlidhur vendimit. Shkëmbimi i këtyre 2 pronave të kryhet pa shpërblim apo kompensim mbi vlerën e tyre, dhe të realizohet nëpërmjet një kontrate shkëmbimi me shoqërinë "---------", e cila të nënshkruhet nga Bashkia, Tiranë. Pas shkëmbimit, pasuria me nr.2/345 me emërtim "truall", me sipërfaqe 3660 m² 8280, Tiranë, të përdoret nga Bashkia, Tiranë.
Bazuar në vendimin e mësipërm Ndërmarrja e Qytetit nr.1, Tiranë, nuk ka marrëdhënie kontraktuale me subjektin "---------" për ambientet me qira prej muajit qershor të vitit 2016.
2."Ish këndi i lojrave për fëmijë në rrugën e Elbasanit" me një sipërfaqe prej 3140 m², referuar kontratës së datës 05.04.2001, nënshkruar nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit(sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë), përfaqësuar nga ----------, në cilësinë e qiramarrësit.
Kontrata është nënshkruar me afat 20 vjet dhe në nenin 6 "Pagesa e qirasë" citohet se qiramarrësi detyrohet t'i paguajë qiradhënësit detyrimin mujor të qirasë në vlerën 41,867 lekë/muajbrenda datës 5 të çdo muaji.
Bazuar në dokumentacionin në dispozicion konstatohet se nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve Nr.1 e Qytetit, është ndjekur arkëtimi për detyrimin e qirasë nga qiramarrësi si edhe janë plotësuar evidencat e kërkuara nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore dhe Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë), në lidhje me nivelin e pagesave të qirasë dhe paraqitjen e dokumentacionit ligjor të qiramarrësit.
Qiramarrësi, ka shlyer detyrimet e qirasë në shumën 502,404 lekë, në 2 periudha 6-mujore, në muajin Shkurt dhe në muajin Dhjetor të vitit 2016.
Për 6-mujorin e I të vitit 2017, qiramarrësi ka shlyer detyrimin e qirasë në muajin Janar në shumën 251,202 lekë, për periudhën Janar-Qershor të vitit 2017.
Sa më sipër arrihet në konkluzionin se:
Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve Nr.1 e Qytetit, është ndjekur arkëtimi për detyrimin e qirasë nga qiramarrësi si edhe janë plotësuar evidencat e kërkuara nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore dhe Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë), në lidhje me nivelin e pagesave të qirasë dhe paraqitjen e dokumentacionit ligjor të qiramarrësit, por nuk janë hartuar raportet për respektimin e kushteve të kontratës, nuk janë hartuar dhe paraqitur në degën e shoqërive publike pranë prefekturës, raportet e hollësishëm për ecurinë e tyre, për ndryshimet apo lirimet nga detyrimet dhe të drejtat në kontrata nuk ka njoftuar degën e shoqërive publike pranë prefectures. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve Nr.1 e Qytetit, nuk është kryer

monitorimi i kontratave të qirasë, veprim në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" kreu VI "Monitorimi i kontratave", pikat 1 dhe 2,ku citohet se: "Monitorimi i kontratave të qirasë ose të enfiteozës drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë. Monitorimi bëhet nga njësitë monitoruese që janë institucionet shtetërore, shoqëritë tregtare dhe ish ndërmarrjet shtetërore, që kanë në administrim objektet e dhëna me qira...."
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:
-VKM nr. nr.54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" kreu VI "Monitorimi i kontratave", pikat 1 dhe 2 "
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen mepërgjegjësi Z. ---------, me detyrë Drejtor i Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve dhe Zj. ---------, me detyrëzv.Drejtore e Përgjithshme e DPN1.

Vlerësimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore etj),

1. Përcaktimi i pagave sipas klasifikimit të funksioneve dhe vendeve të punës në shërbimin civil dhe atyre me kod pune.
2. Lidhja e kontratave të punës me punonjësit. (Njësia e Burimeve Njerëzore të paraqesë një listë të punonjësve në lidhje me trajtimin juridik të marrëdhënieve të punës të punonjësve civil (nëse ka) dhe me kodin e punës).
3. Respektimi i dispozitave ligjore për dhënien e shpërblimeve nga fondi i vecantë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore, etj.
4. Respektimi i dispozitave ligjore për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, konfirmimi i pagesës së sigurimeve. Saktësimi i vlerës së detyrimeve për paga dhe sigurime të pasqyruara në bilanc në fund të periudhës.
Nga auditimi rezultoi se:
Hartimi, miratimi dhe respektimi i strukturës organike të miratuar nga këshilli bashkiak.
Struktura organizative e DPN1për periudhën objekt auditimi është e rregulluar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.41 datë 23.09.2015 "Për Riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit", në bazë të këtij urdhri është vendosur që numri i përgjithshëm i punonjësve të DPN1 të jetë 360 punonjës gjithsej. Për këtë arsye në organigramën e DPN1 pati disa ndryshime në strukturën si në numër punonjësisht ashtu edhe me organizim të sektorëve dhe drejtorive.
Pas vendimit Nr.41, mes DPN1 dhe APR u nënshkrua Akt-marrëveshja Nr.1720 Prot dt 06.10.2015 të DPN1, dhe Nr.5 Prot. datë 06.10.2015 të APR në bazë të së cilës u transferuan një pjesë të punonjësve nga DPN1 tek APR.
Po në këtë datë është bërë edhe njoftimi i të gjithë punonjësve të tjerë të DPN1, me shkresën Nr.1731 Prot. datë 06.10.2015, ku njoftohen për riorganizimin e drejtorisë sipas strukturës së miratuar me Urdhërin Nr.14430 datë 05.10.2015 për "Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit" me numër të përgjithshëm punonjësish 360

punonjës. Të gjithë punonjësit që morën njoftimin për riorganizimin e drejtorisë kanë nënshkruar në listën emërore bashkëlidhur njoftimit të sipërpërmendur.
Sipas rastit, për punonjësit është ndjekur procedura ligjore për njoftimin dhe për të rënë dakord për pozicionin e ri të punës sipas strukturës së re të miratuar.
Gjithashtu, punonjësve që u suprimohej vendi i punës iu është bërë njoftimi për zgjidhjen e kontratës së punës. Pas këtij njoftimi, sipas afateve ligjore që parashikon ligji, u është bërë urdhër lirimi për shkak të ristrukturimit dhe mos pranimit të kalimit në pozicionet e lira të punës 109 punonjësve, nga të cilët:
- 42 punonjës kanë hapur proces gjyqsorë ndaj DPN1.
-5 prej punonjësve që kanë hapur proces gjyqësor në momentin kur ka patur vende vakante u është ofruar të rikthehen në punë, por vetëm një punonjëse ka pranuar pozicionin e punës Lumturi Lilani, të tjerët e kanë refuzuar, më konkretisht Naxhije Abazi, Aferdita Metaliaj, Agron Kaimi, Dëshire Buçi.
- Në momentin që DPN1 i janë miratuar punonjës shtesë nga Bashkia Tiranë u është ofruar rishtazi pozicioni i punës këtyre punonjësve, por vetëm 33 prej tyre deri në periudhën objekt auditimi e kanë pranuar pozicionin e punës dhe janë emëruar sipas legjislacionit përkatës dhe sipas VKB-së në fuqi.
Në mbështetje të Urdhërit Nr.14430 datë 05.10.2015 për "Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit" me numër të përgjithshëm punonjësish 360 veta organika e drejtorisëka qenë e shpërndarë si më poshtë vijon:
Drejtor i Përgjithshëm
Asistent
Njësia e Monitorimit të Terrenit1 Drejtor + 12 specialistë
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse1 Drejtor + 11 punonjës
Sektori Juridik 1 përgjegjës + 3 specialistë
Sektori i Personel, Vlerësimit 1 përgjegjës + 3 specialistë dhe 1 punëtore
Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Raportimin Online 1 përgjegjës dhe 2 specialistë
Drejtoria e Planifikimeve, Menaxhimit dhe Shërbimeve 1 Drejtor + 57 punonjës
Sektori i Financë, Programimit 1 përgjegjës + 6 specialistë
Sektori i Flota, transportit 1 përgjegjës + 1 Specialist + 40 shoferë
Sektori i prokurimeve 1 përgjegjës dhe 2 specialistë
Sektori i Oficina, Mirëmbajtje 1 përgjegjës dhe 4 teknikë
Drejtoria e Zhvillimit dhe e Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit 1 Drejtor dhe 45 punonjës
Sektori i Zhvillimit 1 përgjegjës + 4 specialistë
Sektori i Projekteve 1 përgjegjës +4 specialistë
Sektori i Mirëmbajtjes 1 përgjegjës + 1 specialist + 6 teknikë =14 punëtor
Sektori i Prodhim, Bimësisë 1 përgjegjës + 17 punëtor
Drejtoria e Pastrimit të Qytetit 1 Drejtor dhe 197 punonjës
Sektori teknik 1 përgjegjës dhe 3 specialistë
Sektori i Pastrimit të rrugëve dytësore dhe blloqeve të banimit të sipërfaqeve të gjelbërta të qytetit 12 përgjegjësa + 160 punëtor
Sektori i Taskë Forcë, emergjenca 1 përgjegjës + 20 punëtor

Drejtoria e Trajtim, Mbetje, Landfill dhe Riciklim 1 Drejtor +24 punonjës
Sektori i Teknik, Koordinimit 1 përgjegjës +5 specialistë
Sektori i Landfillit 1 përgjegjës +14 punëtor
Sektori i Riciklim, Trajtim Mbetjesh 1 përgjegjës +2 specialistë
Në mbështetje të këtij Urdhëri, duke qënë se u ndryshua organigrama dhe mjaft emërtesa të drejtorive dhe sektorëve të gjithë punonjësve iu është bërë emërim i ri dhe kontratë e re pune.

VKB-të dhe Urdhërat e Kryetarit gjatë vitit 2016

- Urdhri Nr.3188/1 datë 01.02.2016 "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.56 datë 24.12.2012 Për "Riorganizimin e strukturës organizative të disa institucioneve në Varësi të Bashkisë Tiranë" ku miratohej numri prej 441 punonjësish për Drejtorinë e Përgjithsme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit.
- Urdhri Nr.3263 datë 01.02.2016 për "Transferimin e punonjësve të Njësive Administrative pranë Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit" 29 nga punonjësit e Njësive Administrative kanë kaluar pranë DPN1, të cilët u emëruan në pozicionet e miratuara shtesë për DPN1 në Urdhërin Nr.3188/1 datë 01.02.2016 "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.56 datë 24.12.2012 Për "Riorganizimin e strukturës organizative të disa institucioneve në Varësi të Bashkisë Tiranë".
- Me shktresën Nr.12550/1 datë 25.04.2016 "Për një ndryshim të strukturës organizative të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit miratuar me Urdhërin e Kryetarit Nr. Prot.3188/1 datë 01.02.2016" numri i punonjësve mbeti i pa ndryshuar për DPN1 me 441 gjithsej, por në organigramë u shtua pozicioni i Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm si nevojë me shtesën e njësive të tjera administrative nga reforma e re administrative.
- Vendimit Nr.38 datë 23.05.2016 për "Miratimin e numrit të punonjësve me kontratë me kohëzgjatje të caktuar për Drejtorinë e Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, Drejtorinë e Përgjithshme Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit dhe Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit", DPN1 iu miratuan 40 punëtorë me kontratë me kohëzgjatje të caktuar për vitin 2016 për një periudhë 4 mujore (qershor-tetor) për mirëmbajtjen dhe vaditjen e sipërfaqeve të gjelbërta dhe 24 punëtor me kohëzgjatje të caktuar për një periudhë 2 mujore (tetor-dhjetor) për mbjellje dhe kultivim bimësie. Ky miratim erdhi pas kërkesës së bërë nga DPN1 me shkresën Nr.1346 Prot. datë 26.04.2016 ku janë kërkuar 80 punonjësme kontratë të caktuar për nevoja specifike të drejtorise, nga të cilët janë miratuar vetëm 40.Në zbatim të këtij vendimi DPN1 emëroi 40 punëtor dhe u lidhi këtyre punëtorëve kontrata të caktuara 4 mujore për periudhën qershor-tetor.
- Vendimi Nr.69 datë 07.10.2016 për "Disa shtesa në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.38 datë 23.05.2016 "Për Miratimin e numrit të punonjësve me kontratë me kohëzgjatje të caktuar për Drejtorinë e Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, Drejtorinë e Përgjithshme Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit dhe Agjencinë e Parqeve dhe të Rekreacionit" ku DPN1 për periudhën tetor-dhjetor iu shtuan edhe 76 punëtorë të tjerë me kohëzgjatje të caktuar për mbjelljen dhe kultivimin e bimësisë. Ky miratim është bërë pas kërkesës së bërë nga DPN1 me shkresën Nr.2839 Prot. datë 16.09.2016 ku janë kërkuar sipas nevojave100 punonjës me kontratë të caktuar, nga të cilët janë miratuar vetëm 76.

VKB-të dhe Urdhërat e Kryetarit Bashkisë së Tiranës gjatë vitit 2017

- Në zbatim të Urdhërit 4441/2 datë 01.02.2017 "Për shtimin e organigramës së Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, Njësi në Varësi të Bashkisë Tiranë" DPN1 numri i punonjësve në organigramë e bë 466 vetë gjithsej.
- Vendimi Nr. 84 datë 29.12.2016për "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017" Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit iu miratuan 75 punonjës me kontratë të caktuar 3 mujore për periudhën shkurt-prill 2017.
- VKB Nr. 50 datë 31.05.2017 Për "Një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.84 datë 29.12.2016 për "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017 si dhe Miratimin e Numrit të punonjësve me Kontratë me Kohëzgjatje të Caktuar Për APR" sërisht ka emëruar në këto pozicione pune me kontrata të caktuara 4 mujore për periudhën korrik –tetor 2017 po këto punonjës, të cilët vazhdojnë edhe aktualisht në punë.

Urdhërat e lirimeve sipas viteve 2015-2017

Që nga miratimi i Vendimit Nr. 41 sipas viteve janë bërë këto largime me arsyetimin përkatës, si më poshtë listuar:

Gjatë vitit 2015 urdhër lirime për:

-130 punonjës sipas Akt –marrëveshjes mes DPN1 dhe APR
-109 punonjës për shkak të ristrukturimit
-37 punonjës me dorëheqje
-1 pension pleqërie
-1 punonjësKMCAP

Gjatë vitit 2016 urdhër lirime për:

-4 punonjës për shkak të përfundimit të kontratës si zëvendësuese leje lindje
-17 punonjës për dalje në pension
-10 punonjës për mos paraqitje në punë
-4 punonjës përfundon kontrata
-14 punonjës për shkelje të detyrimeve kontraktuale
-2 punonjës KMCAP
-17 punonjës me dorëheqje
-1 punonjës ristrukturim

Gjatë vitit 2017 (deri në muajin qershor) kanë qenë këto urdhër lirime:

-2punonjës shkak vdekje
-4 punonjës për dalje në pension
-6 punonjës me dorëheqje
-2 punonjës KMCAP
-5 punonjës për mos paraqitje në punë

Nga auditimi rezulton se në total nuk ka tejkalim të numrin të punonjësve ndërsa në disa drejtori për shkak të shtesave të kërkuara për arsye të plotësimit me personel për një periudhë sezonale sipas rasteve të sipërcituara propozuar nga DPN.1 mesatarja vjetore e numrit të punonjësve del më e lartë se plani dhe gjithashtu në disa drejtori ka punonjëse që janë me leje lindje.

Përcaktimi i pagave sipas klasifikimit të funksioneve dhe vendeve të punës në shërbimin civil dhe atyre me Kodin e Punës.

Nga auditimi u konstatua se të gjithë punonjësit e DPN1 janë me kod pune. Nga auditimi me zgjedhje i sistemit të pagave konstatohet se paga për pozicion pune përputhet me pagën e vendosur sipas tabelës së pagave, bashkëlidhur shkresës Nr. Prot 3852 datë 08.02.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit FInanciar, Bashkia Tiranë.

Lidhja e kontratave të punës me punonjësit. Plotësimi i listë pagesave nga punonjësi i caktuar për pagat, si dhe mbështetja në të dhënat e dokumentacionit bazë (listë prezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Kontrolli dhe nënshkrimi nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij.

Nga auditimi me zgjedhje i listë pagesave dhe borderove (janar 2016, prill2016, shkurt 2017, mars 2017) për periudhën e përcaktuar në program, rezultoi se shuma e përgjithshme e listë pagesave është e njëjtë me urdhër shpenzimi i përgatitur për këtë qëllim. Përmbledhëset e listë pagesës në çdo rast janë të nënshkruara nga specialistja e pagave në zyrën e financës, Drejtori i Planifikimit Menaxhimit, Shërbimeve dhe Drejtorii Përgjithshëm. Listë pagesat janë të shoqëruara me listë prezencat përkatëse për çdo drejtori. Listë pagesat paraqesin nga paga bruto, shtesat, ndalesat, orët jashtë orarit deri në pagën neto.

Në procedurën e pagesës hartohet listë prezenca dhe nënshkruhet nga drejtorët e drejtorive më pas hartohet listë pagesa mbi bazën e klasifikimit të pagave të miratuara me vendim të KB, duke kryer llogaritjet për orët jashtë orarit, për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi dhe kontributet e sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësore plotësohet listë-pagesa përkatëse dhe dërgohet në thesar për pagesë.

Nga auditimi u konstatua se në disa raste të punëve jashtë orarit zyrtar, punonjësit shënojnë dhe miratojnë njëkohësisht orët e punës. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 22 pika 3/b të ligjit 10296 "Menaxhimin financiar dhe kontrollin" ku citohet: "*Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht: b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave*". Gjithashtu nga auditimi i listë prezencave mujore të punonjësve në disa raste u konstatua punonjësit kanë kaluar limitin ligjor për sa i përket orëve jashtë orarit. Në pikën 2 të neni 90 të Kodit të Punës citohet: "2) Nuk mund të kërkohet kryerja e orëve shtesë javore kur punëmarrësi ka kryer 50 orë pune në javë". Pra, duke patur parasysh se 40 orë në javë është norma e punës për punonjësit, numri maksimal i orëve shtesë duhe të jetë 10 orë në javë (ose 40 në muaj) normë e cila në disa raste rezulton të jetë tejkaluar.

Janë kryer ndalesat për tatimin e të ardhurave personale nga punësimi sipas përcaktimeve në përputhje me UMF nr. 5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar dhe janë paguar brenda datës 20 të muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.

Është përllogaritur, ndalur dhe derdhur në organet tatimore kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbi bazën e pagës minimale dhe maksimale si dhe përqindjeve përkatëse punëdhënës e punëmarrës sipas VKM nr. 114, datë 30.7.2008 i ndryshuar "Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11. 5.1993, të ndryshuar, ligji nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për

mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe UMF nr. 26, datë 16.4.2009 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore" i ndryshuar, dhe pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 457, datë 09.07.2014, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 114, datë 30.7.2008, të këshillit të ministrave, "Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.9.2003, të ndryshuar, dhe nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".Fondi i pagave për Drejtorinë e Përgjithshme të Punëtorëve të Qytetit N.r1 për vitin 2016 rezulton 233,000 mijë lekë.Janë audituar me zgjedhje listë-pagesa të vitit 2016 nga të cilat rezulton se janë hartuar në rregull dhe nuk ka probleme mbi llogaritjen e ndalesave të tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqërore. Detyrimet janë derdhur pranë institucioneve përkatëse dhe institucioni nuk është penalizuar me gjoba apo interesa të paguara për pagesë të vonuar.

Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore, etj.

Nga auditimi, konstatohet se fondi i shpërblimeve është krijuar dhe përdorur sipas VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", i ndryshuar.

Në total për periudhën objekt auditimi nga fondi i vecantë është dhënë shpërblim për dy raste vdekje dhe tre raste shpërblim pensioni.

Përllogaritjet, aplikimet dhe derdhja e detyrimeve, për tatimin mbi të ardhurat, kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore etj.

Nga auditimi në tërësi të listë pagesave për periudhën e përcaktuar në program, u konstatua se llogaritja e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimi mbi pagat dhe të ardhurat personale, është bërë në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994"Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Llogaritjet janë bërë për çdo punonjës, janë ndaluar nga paga sigurimet shoqërore e shëndetësore, duke respektuar kufirin minimal e maksimal, tatimi mbi pagën, dhenjëkohësisht janë xhiruar në institucionet përkatëse,të rakorduara me listat përkatëse.

Nga auditimi i vlerësimit të punonjësve rezultoi se në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar mënyra dhe afatet për vlersimin vjetor të punonjësve të DPN1 me synim përmirësimin e performacës së punonjësve dhe evidentimin e mangësive në zbatimin e detyrave funksionale të tyre. Gjithashtu nga auditimi konstatohet se nuk janë përcaktuar kritere për vendin e punës të cilat duhet të shërbejnë edhe për marrjen në punë të punonjësve.

U audituan me zgjedhje disa dosje personale dhe u konstatua se ato ishin të plota, me të gjitha dokumentet personale por nuk janë të inventarizuara në përputhje me VKM 117 datë 05.03.2014.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Për sa i përket miratimeve të orëve jashtë orarit, shënimi dhe miratimi i tyre, në disa raste është kryer nga vetë punonjësit që kanë përfituar pagesat për këto orë shtesë.

NëDPN1 nuk ka asnjë procedurë të shkruar për sa i përket mënyrës së rekrutimit të stafit, apo shpalljen e vendeve vakante. Gjithashtu nuk ka kritere të mirëcaktuara për vendet e punës, të

cilat do të shërbenin si bazë për vlerësimin e rekrutimit të stafit aktual dhe rekrutimeve në të ardhmen.Nga ana e Sektorit të Personelit të DPN1 nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM Nr.117datë 05.03.2014, përsa i përket administrimit të dosjeve të personelit.
Nga ana e DPN1 nuk janë zbatuar dispozitat ligjore për sa i përket numrit maksimal të orëve shtesë.
Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
-Ligji Nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"
-Ligji Nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi I Punës", i ndryshuar.
-VKM Nr. 117 datë 05.03.2014.

V. Mbi zbatimin e kërkesave të Prokurimit Publik

1. Hartimi i një tabele për Ndërmarjen në lidhje me procedurat e prokurimit publik, objekti i prokuruar, lloji i procedurës, fondi limit, data dhe vlera e kontratës lidhur, shtesat e kontratës, diferenca nga fondi limit, operatori ekonomik fitues dhe cila procedure prokurimi dhe audituar nga grupi/audituesi i KLSH në vlerë dhe në përqindje.
2. Përcaktimi i nivelit të shpenzimeve të prokuruara në referencë të totalit të shpenzimeve si dhe vlerësimi i zonave me risk për auditim. Dhënia e opinionit për rregullshmërinë e realizimit të procesit të prokurimit në sigurimin e mallrave dhe shërbimeve.

a. Mallra dhe shërbime.

1. Mënyra e evidentimit dhe ndjekjes së nevojave për mallra dhe shërbimebrenda ndërmarrjes. Niveli i deviacioneve nga programimi i buxhetit për këto zëra.
2. Gjendja e mallrave stok dhe me qarkullim të ngadalshëm. Kryerja i inventarit të aktiveve qarkulluese. Saktësia e vlerës së inventarëve ekonomik pasqyruar në pasqyrat financiare dhe konfirmimi i vlerës së inventarizimit fizik.
3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.
4. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës lidhur me sigurimin e mallrave dhe shërbimeve për aktivitetin e ndërmarrjes.
5. Analiza dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik, kontroll i zbatimit të kontratës dhe marrja në dorëzim të mallrave/shërbimeve në referencë të kërkesave ligjore. Kontrolli fizik për marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe verifikimi i zbatimit të kushteve të kontratës nga komisioni i ngritur për zbatimin dhe marrjen në dorëzim
6. Saktësia e vlerës së pasqyruar në shpenzimet e periudhës kontabël

b. Aktiveve e Trupëzuara dhe të Patrupëzuara (230, 231)

1. Rregjistri i aktiveve dhe administrimi i pronës shtetërore
2. Saktësia e vlerës së pasqyruar në aktive sipas klasifikimit bazë kontabël dhe llogaritja e amortizimit të tyre
3. Shtesat e aktiveve gjatë vitit, dhe krahasimi me nevojat për investime të programuara. Argumentimi dhe përllogaritja e vlerës limit të kontratës sipas nevojave konkrete për investime.
4. Kontrolli fizik për marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit. Zbatimi i kushteve të kontratës nga komisioni i ngritur për zbatimin dhe marrjen në dorëzim (Paraqitja në formë tabelare të objekteve ndërtimore të përfunduara sipas vlerës, operatori,

fitues, data e kontratës, afatet e përfundimit të punimeve sipas kontratës, dhe përzgjedhja e tyre për verifikim në teren, etj).
5. Pakësimet e aktiveve dhe arësyet e këtyre transaksioneve. Ndjekja e procedurave të nxjerrjes jashtë përdorimit sipas kërkesave të Udhëzimit nr.30 të Ministrisë së Financave
6. Saktësimi i vlerave që prekin bilancin dhe konfirmimi i shifrës me inventarizimin fizik të realizuar në fund të periudhës. Verifikimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm lidhur me administrimin e aktiveve të qëndrueshme.
7. Përcaktimi i vlerës së detyrimeve të papaguara nga investimet e periudhave të mëparshme (lista e detyrimeve e saktësuar përmes testimeve të dokumentacionit të disponueshëm)
8. Inventarizimi dhe krijimi i regjistrit/data base të aseteve të për periudhën e auditimit, auditimi i ndryshimeve të aseteve të kryera (dhënie me qira, shitje troje etj.), ligjshmëria dhe rregullariteti i veprimeve të kryera me asetet e qëndrueshme; Auditim mbi statusin juridik të tyre, regjistrimi në ZVRPP.

Për periudhën janar 2016 - qershor 2017, u audituan veprimet e kryera nëpërmjet bankës, nga ku janë konstatuar shkelje dhe mangësi ligjore, në mbajtjen e dokumentacionit.

Urdhër shpenzimet janë nënshkruar nga personat urdhërues dhe zbatues, shoqëruar me dokumentacion justifikues. Plotësimi i tyre është bërë në të gjithë ekstremitetet, ku përcaktohet qartë objekti i shpenzimit sipas strukturës buxhetore, kreditori përfitues dhe dokumentet justifikues. Urdhërshpenzimet janë konfirmuar në çdo rast nga specialistët e Degës së Thesarit.

Veprimet ekonomike, janë regjistruar në bazë të dokumenteve autorizuese dhe vërtetuese, veprimet janë regjistruar në kompjuter, por nuk është mbajtur ditari i bankës sipas kërkesave tëligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2012, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", "Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve" dhe "Dokumentimi i vlerave monetare".

Nëpërmjet bankës janë kryer likuidimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, ujë, energji, pagesat ndaj furnitorëve për kontratat e nënshkruara për furnizime dhe shërbime, etj. Janë kryer pagesa për punonjësit e larguar nga puna që kanë paraqitur vendime gjyqësore si pasojë e largimeve të padrejta, në shumën *6,276,971 lekë, e cila përbën efekt negativ për buxhetin e shtetit.* Largimet nga puna i përkasin viteve 2011-2013, të cilat janë kryer nga ish drejtori Shemsi Aga.

-Me Urdhër Shpenzimin nr.78, datë 27.06.2016, është likuiduar shuma 4,975,920 lekë, për ***"Blerje karburant"*** sipas faturës së datës 29.03.2016, fatura dhe fletë hyrja datojnë më 29.03.2016. *Likuidimi është kryer 3 muaj me vonesë*, në kundërshtim me ligjin nr.48/ 2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7, ku citohet se: *"Afati për autoritetet publike, në veprimet juridike dhe tregtare, në të cilat debitori është autoritet publik, afati i pagesës nuk duhet të jetë më i gjatë se 30 ditë kalendarike pas marrjes në dorëzim të faturës, mallrave dhe shërbimeve"* dheUdhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", "Dokumentimi i vlerave monetare" pika 61, ku citohet: "*Pagesat ndërmjet njësive publike dhe entiteteve të sektorit privat bëhen nëpërmjet Sistemit të Thesarit direkt në llogarinë bankare të përfituesit. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë të*

detyruara të procedojnë me kryerjen e pagesës për mbylljen e detyrimeve menjëherë pas marrjes së faturës tatimore nga furnitori dhe të vërtetuar me kryerjen e shërbimit/marrjes në dorëzim të aktiveve në përputhje me kushtet e kontratës".

- Me Urdhër Shpenzimin nr.79, datë 27.06.2016 është likuiduar shuma 3,538,560 lekë, për ***"Blerje karburant"*** sipas faturës së datës 10.03.2016, fatura dhe fletë hyrja datojnë më 10.03.2016. *Likuidimi është kryer 3 muaj me vonesë*, në kundërshtim me ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7.

- Me Urdhër Shpenzimin nr.191, datë 20. 12.2016, është likuiduar shuma 538,800 lekë për *"Shërbim analize monitorimi"* ndaj shoqërisë "-------" sipas faturës tatimore nr.37, datë 22.07.2016. Shërbimi është kryer sipas urdhër prokurimit nr.1500/2, datë 23.06.2016, me fond limit 634,200 lekë. *Likuidimi 4 muaj me vonesë,* në kundërshtim me ligji nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7.

- Me Urdhër Shpenzimin nr.113, datë 17.08.2016, është likuiduar shuma 839,820 lekë, operatorit ekonomik --------- për ***"Blerje karburant"*** fatura nr.978, datë 14.06.2016. *Likuidimi 2 muaj me vonesë.*

- Me Urdhër Shpenzimin, nr.108, datë 16.08.2016,është likuiduar shuma 856,767 lekë, operatorit ekonomik --------- për *"Blerje karburant"* naftë 8038 litra fatura nr.967, datë 25.04.2016 dhe fatura nr.964, datë 18.04.2016 benzinë 2000 litra. *Likuidimi 4 muaj me vonesë.*

- Me Urdhër Shpenzimin nr.135, datë 27.09.2016,është likuiduar shuma 9,155,520 lekë, operatorit ekonomik --------- për *"Blerje karburant"* naftë 55,000 litra fatura nr.976, datë 03.06.2016. *Likuidimi 3 muaj me vonesë.*

- Me Urdhër Shpenzimin nr.143, datë 12.10.2016, është likuiduar shuma 13,000,020 lekë, ndaj operatorit ekonomik "Alb Garden" sipas faturës tatimore nr.42, datë 14.07.2016 dhe hyrje mallit nr.11, datë 14.07.2016. *Likuidimi 3 muaj me vonesë.*

- Me Urdhër Shpenzimin nr.144, datë 12.10.2016 është likuiduar shuma 4,456,800 "---------" për *"Blerje elektropompa"* sipas faturës tatimore nr.30, datë 23.06.2016, hyrje nr.9, datë 23.06.2016 dhe akt marrje në dorëzim 23.06.2016. *Likuiduar 4 muaj me vonesë.*

- Me Urdhër Shpenzimin nr.145, date 12.10.2016 është likuiduar shuma 9,240,000 lekë, për *"Blerje motokorrëse"* "--------" sipas faturës tatimore nr.18, datë 25.08.2016, hyrje nr.17, datë 25.08.2016 dhe akt marrje në dorëzim 25.08.2016. *Likuiduar 2 muaj me vonesë*

- Me Urdhër Shpenzimin nr.149, datë 01.11.2016, është likuiduar shuma 830,695 lekë, për blerje karburant --------- sipas faturës tatimore nr.983, datë 11.07.2016, hyrje nr.30, datë 11.07.2016. *Likuiduar 4 muaj me vonesë.*

Mungon procesverbali i marrjes në dorëzim, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", "Dokumentimi i lëvizjes së tyre".*Likuidimi 2 muaj me vonesë.*

Me Urdhër Shpenzimin nr.21, datë 08.03.2017, është likuiduar shuma 1,457,971 lekë, "---------" pagesë e faturës tatimore nr.794, datë 06.12.2016, nënshkruar nga ---------. Mungon dokumentacioni justifikues, nuk ka procesverbal të mbajtur për kryerjen e shërbimit. Eshtë mbajtur 1 procesverbal datë 04.12.2016 nga operatori ekonomik dhe nuk është nënshkruar nga

komisioni i caktuar për ndjekjen e kontratës së shërbimit, i përbërë nga Enisa Doraci, specialiste në sektorin e personelit, Lumturie Haxhi, përgjegjëse e serave dhe fidanishtes, ---------, drejtor i landfillit dhe ---------, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", "Dokumentimi i lëvizjes së tyre". *Likuidimi 2 muaj me vonesë.*

-***Me Urdhër Shpenzimin nr.53, datë 10.05.2017***, është likuiduar shuma 1,748,400 lekë, "---------" pagesë e faturës tatimore nr.2894, datë 02.05.2017, nënshkruar nga Arjola Rada, sipas kontratës nr.167/11, date 01.02.2017. Mungon dokumentacioni justifikues, nuk ka procesverbal të mbajtur për kryerjen e shërbimit me roje private, thjesht likuidimi i faturës muajit mars pa detajuar nr. roje, etj, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

-***Me Urdhër Shpenzimin nr.65, datë 09.06.2017***, është likuiduar shuma 1,269,846 lekë, "---------" pagesë e faturës tatimore nr.863, datë 30.12.2016, pa u nënshkruar nga blerësi. Mungon dokumentacioni justifikues, nuk ka procesverbal të mbajtur për kryerjen e shërbimit me roje private, thjesht likujdimi i faturës muajit dhjetor pa detajuar nr roje etj, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", "Dokumentimi i lëvizjes së tyre".

Likuidimi 6 muaj me vonesë .

-***Me Urdhër Shpenzimin nr.39, datë 26.04.2017,*** është likuiduar shuma 1,748,400 lekë, "---------" pagesë e faturës tatimore nr.2651, datë 01.04.2017, nënshkruar nga Arjola Rada, sipas kontratës nr.167/11, datë 01.02.2017. Mungon dokumentacioni justifikues, nuk ka procesverbal të mbajtur për kryerjen e shërbimit me roje private, thjesht likuidimi i faturës muaji mars pa detajuar nr. roje etj, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", "Dokumentimi i lëvizjes së tyre".

-***Me Urdhër Shpenzimin nr.45, datë 03.05.2017,*** është likuiduar shuma 3,000,000 lekë, --------- pagesë pjesore e faturës tatimore nr.969, datë 01.02.2017 në shumën 11,999,958 lekë, (64,006 litra naftë dhe 3,000 litra benzinë), sipas kontratës nr.168/1, datë 01.02.2017. Mungon dokumentacioni justifikues, nuk ka procesverbal të mbajtur por thjesht likujdimi i faturës pa përcaktuar marzhin llogaritjen e çmimit, etj, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", "Dokumentimi i lëvizjes së tyre". *Likudimi 3 muaj me vonesë.*

-***Me Urdhër Shpenzimin nr.25/1, datë 23.03.2017***, është likuiduar shuma 8,194,680 lekë, për *"Blerje karburant"* ndaj operatorit ekonomik --------- sipas faturës tatimore nr.940, datë 30.12.2016, hyrje nr.51, datë 30.12.2016 Fatura për 46,000 litra naftë dhe 2233 litra benzene. Kontrata shtesë date 30.12.2016 shuma 20% e kontratës fillestare. *Likuidimi 3 muaj me vonesë.*

-***Me Urdhër Shpenzimin nr.63, datë 25.05.2017,*** është likuiduar shuma 5,000,000 lekë, --------- sipas faturës tatimore nr.8868, datë 17.03.2017, (60,000 litra naftë dhe 5,000 litra benzinë), dhe kontratës nr.667/12, datë 18.03.2017. *Likuidimi 2 muaj me vonesë.*

-***Me Urdhër Shpenzimin nr.74, datë 09.06.2017***, është likuiduar shuma 1,747,699 lekë, "--------- pagesë e faturës tatimore nr.2932, datë 01.06.2017, pa u nënshkruar nga blerësi, sipas kontratës nr.1019/7, datë 02.05.2017. Mungon dokumentacioni justifikues, nuk ka procesverbal të mbajtur për kryerjen e shërbimit me roje private, thjesht likuidimi i faturës muajit maj pa detajuar nr. roje etj, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", "Dokumentimi i lëvizjes së tyre".

-***Me Urdhër Shpenzimin nr.76, datë 19.06.2017***, është likuiduar shuma 5,000,000 lekë, --------- sipas faturës tatimore nr.8868, datë 17.03.2017, (60,000 litra naftë dhe 5,000 litra benzinë) , sipas kontratës nr.667/12, datë 18.03.2017.*Likuidimi 3 muaj me vonesë.*

-***Me Urdhër Shpenzimin nr.82, datë 22.06.2017,*** është likuiduar shuma 1,156,460 lekë, --------- sipas faturës tatimore nr.8868, datë 17.03.2017, (60,000 litra naftë dhe 5,000 litra benzinë), sipas kontratës nr.667/12, datë 18.03.2017. *Likuidimi 3 muaj me vonesë.*

-***Me Urdhër Shpenzimin nr.84, datë 22.06.2017*** është likuiduar shuma 2,483,395 lekë, --------- sipas faturës tatimore nr.8870, datë 18.04.2017, hyrja nr.7, datë 18.04.2017 dhe kontratës nr.667/11, datë 18.03.2017. *Likuidimi 2 muaj me vonesë.*

-***Me Urdhër Shpenzimin nr.83, datë 22.06.2017*** është likuiduar shuma 3,194,638 lekë, --------- sipas faturës tatimore nr.969, datë 01.02.2017 dhe kontratës nr.168/1, datë 01.02.2017. flete hyrja nr.1, datë 01.02.2017. *Likuidimi 4 muaj me vonesë.*

-***Me Urdhër Shpenzimin nr.96, datë 21.07.2016***, është likuiduar shuma 830,689 lekë, operatorit ekonomik --------- për *"Blerje karburant"*fatura nr.902, datë 25.04.2016 dhe hyrja nr.18, datë 25.04.2016. *Likuidimi 3 muaj me vonesë.*

-***Me Urdhër Shpenzimin nr.87, datë 19.07.2016***, likuiduar shuma 28,150,000 lekë, operatorit ekonomik "---------" për *"Blerje dru dhe shkurre dekorative"* fatura nr.32, datë 09.05.2016 dhe hyrja nr.20, datë 09.05.2016. *Likuidimi 2.5 muaj me vonesë.*

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se: *Dega e financës në disa raste, ka vepruar në mosnjohje të legjislacionit ekonomiko-financiar, veprimet ekonomike, janë regjistruar në bazë të dokumenteve autorizuese dhe vërtetuese, veprimet janë regjistruar në exel, nuk është mbajtur ditari i bankës, në 7 raste për pagesat e kryera për prokurime mallra dhe shërbime, kanë mangësi në plotësimin me dokumente justifikues, procesverbal, etj, në 22 raste, janë kryer pagesa të vonuara, nuk është ndjekur zbatimi i kontratave nga dega e financës sa i takon detyrimeve kontraktuale. Dega e financës nuk ka punuar me programet financiare për mbajtjen e llogarive.*

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në -Ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.-Ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" -Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Z. ---------, me detyrë Drejtor i Planifikimit, Menaxhimit, Shërbimeve dhe Financës dhe Zj. ---------, me detyrë zv.Drejtore e Përgjithshme e DPN1, në cilësinë e ish Drejtor i Planifikimit, Menaxhimit, Shërbimeve dhe Financës.

Blerjet e vogla

Nga auditimi rezultoi se Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve të Qytetit nr.1, për zhvillimin e aktivitetit ka parashikuar dhe zhvilluar procedura prokurimi me vlera të vogla në sistemin elektronik në faqen e APP, procedura emergjente si edhe procedura shkresore në rastet e mosarritjes së konkurrencës dhe ofertave ekonomike të cilat plotësojnë kërkesat e autoritetit kontraktor.

Për vitin 2016, është parashikuar për blerjet me vlera të vogla, shuma prej **16,101,872 lekë,** janë realizuar 18 procedura me vlerë **9,503,275 lekë.**

Referuar prokurimeve me vlera të vogla për vitin 2016, konstatohet se nga autoriteti kontraktor nuk janë planifikuar drejt nevojat për prokurime, pasi ato në vlerë janë realizuar në masën 59%.

Fondi limit i llogaritur për këtë qëllim është i fryrë dhe i pa bazuar në çmimet e periudhave të mëparshme, çmimet e publikuara nga INSTAT, etj, me qëllim arritjen e prokurimeve me efektivitet, ekonomicitet dhe eficencë, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9643, 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, germa b, VKM nr.914, datë 29.12.2014"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 40 "Procedura e prokurimit me vlerë të vogël" pika 1,ku citohetse *"Autoriteti kontraktor planifikon në fillim të vitit natyrën, sasitë dhe llojet e kontratave që do të prokurohen me këtë procedure prokurimi. Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedure llogariten grup mallrash apo shërbimesh dhe, në asnjë rast nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure"* dhe Udhëzimin nr.3, datë 27.01.2015 "Për prokurimet me vlera të vogla" pika 4.

Me urdhrin nr.401/2, datë 11.02.2016, të titullarit të Autoritetit Kontraktor është ngritur komisioni i blerjeve me vlera të vogla për vitin 2016, i përbërë nga ---------, me detyrë shefe sektorit të prokurimeve, ---------, me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve dhe ---------, me detyrë specialist në sektorin e prokurimeve.

-Me urdhër shpenzimin nr.41, datë 15.04.2016, është likuiduar shuma 445,000 lekë, subjektit ----------, sipas UP nr.935/1, datë 09.03.2016, janë prokuruar ***"Bojra printeri"*** me fond limit 596, 567 lekë.

Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e prokurimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, ku citohet se:*"Autoriteti kontraktor nuk është i detyruar të prokurojë njëherësh të gjithë sasinë e mallrave, shërbimeve apo të punëve për plotësimin e nevojave të veta. Autoriteti kontraktor mund të realizojë disa procedura prokurimi me vlerë të vogël gjatë vitit kalendarik,në varësi të nevojave dhe mundësive të tij, por vlera e përllogaritur në total e këtyre procedurave për të njëjtin mall/shërbim/punë ose grup mallrash/shërbimesh/punësh, nuk duhet të jetë më e madhe se 800.000 (tetëqindmijë) lekë në vit*" si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.

Llogaritja e fondit limit është kryer nga ---------, pra mungon llogaritja e fondit limit nga komisioni i ngarkuar për këtë qëllim, në kundërshtim me Pikën 4 të Udhëzimit nr. 3 datë,

27.01.2015, "Për prokurimet me vlera të vogla", ku citohet se: *"Në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël duhet të përllogarisë fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme". Kur lind nevoja për punë, mallra ose shërbime, titullari i autoritetit kontraktor ose një zyrtar tjetër i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohen objekti i prokurimit dhe sasia e tyre.*

Fatura e datës 18.03.2016 në shumën 445,000 lekë, nuk është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të blerjeve me vlerë të vogël, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 20.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik", neni 40, pika 7 "Procedura e prokurimit me vlerë të vogël", ku citohet se: *"Pagesa për prokurimet me vlerë të vogël bëhet sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Në çdo rast, faturat e mallrave apo të shërbimeve duhet të jenë të rregullta sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të nënshkruhen nga anëtarët e komisionit. Faturat e lëshuara kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë nënshkruar një të tillë.*
blerjeve me vlera të vogla".

Në datën 21.03.2016, në prani të komisionit të marrjes në dorëzim dhe operatorit ekonomik është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim i përbërë nga ----------, ku citohet se: *"nga verifikimi në vend i mallrave me specifikimet teknike të kërkuara, arritëm në përfundimin se malli është në rregull sipas gjithë kërkesave dhe pas marrjes në dorëzim nga komisioni u bë hyrje në magazinë"*. Procesverbali është fiktiv sepse referuar dokumentacionit të magazinës, mallrat *janë bërë hyrje në magazinë me fletëhyrjen nr.12, datë 18.03.2016, ose 4 ditë më parë se marrja në dorëzim.*

- Me urdhër shpenzimin nr.66, datë 08.06.2016, është likuiduar shuma 1,433,636 lekë, për kryerjen e shërbimit me roje private ndaj operatorit "---------". Likuidimi është kryer në datën 08.06.2016, ose 2 muaj me vonesë, në kundërshtim me ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7, ku citohet se: *"Afati për autoritetet publike, në veprimet juridike dhe tregtare, në të cilat debitori është autoritet autoritet publik, afati i pagesës nuk duhet të jetë më i gjatë se 30 ditë kalendarike pas marrjes në dorëzim të faturës, mallrave dhe shërbimeve".*

- Me urdhër shpenzimin nr.77, datë 22.06.2016 është likuiduar shuma 268,884 lekë, për ***"Blerje materiale kancelarie"*** nuk është zbatuar procedura elektronike fatura e shitësit dhe fletëhyrja datojnë më 17.05.2016. Në datën 17.05.2016 komisioni i blerjeve me vlera të vogla ka mbajtur një procesverbal ku konfirmon se për mungesë konkurrence në datat 19.04.2016 dhe 03.05.2016 nuk u zhvillua procedura dhe komisioni vendosi të bëjë procedurë shkresore.

Mungojnë kërkesatnga degët për nevojën e prokurimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.

Mungon llogaritja e fondit limit nga komisioni i ngarkuar për këtë qëllim, në kundërshtim me Pikën 4 të Udhëzimit nr. 3 datë,27.01.2015, "Për prokurimet me vlera të vogla".
Mungojnë specifikimet teknike, për materialet e listuara nuk ka asnjë specifikim teknik në lidhje me llojin, përmasat ngjyrën, materialin etj, etj, të dhëna të nevojshme për artikujt që do të prokurohen, sepse bazuar në specifikimet teknike përcaktohet/diferencohet cilësia dhe çmimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 23 "Specifikimet teknike" dhe VKM nr.914, datë 20.12.2014, neni 27.
-Me urdhër shpenzimin nr.76, datë 20.06.2016, është likuiduar shuma 523,000 lekë, operatorit ekonomik "------" për ***"Riparim stola dhe kosha"***, fatura nr.271, datë 27.05.2016 dhe situacioni i kryerjes së punimeve datë 27.05.2016, kontrata nr.1575/3, date 23.05.2016.
Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e kryerjes së shërbimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.
Mungon llogaritja e fondit limit nga komisioni i ngarkuar për këtë qëllim, në kundërshtim me Pikën 4 të Udhëzimit nr. 3 datë,27.01.2015, "Për prokurimet me vlera të vogla".
Mungojnë specifikimet teknike, për riparimin, numrin e stolave dhe koshave, lloji i riparimit, specifikimet për riparimet që do të kryhen, etj, të dhëna të domosdoshme për kryerjen e shërbimit nuk ka asnjë specifikim teknik në lidhje me llojin, përmasat ngjyrën, materialin etj, etj, të dhëna të nevojshme për artikujtdo të prokurohen, sepse bazuar në specifikimet teknike përcaktohet/diferencohet cilësia dhe çmimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 23 "Specifikimet teknike" dhe VKM nr.914, datë 20.12.2014, neni 27.
-Me urdhër shpenzimin nr.89, datë 15.07.2016, është likuiduar shuma 129,600 lekë, operatorit ekonomik "---------" për ***"Blerje shkallë"***, fatura nr.370, datë 20.04.2016 dhe hyrja nr.16, datë 20.04.2016,
Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën prokurimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.
Mungon llogaritja e fondit limit nga komisioni i ngarkuar për këtë qëllim, në kundërshtim me Pikën 4 të Udhëzimit nr. 3 datë,27.01.2015, "Për prokurimet me vlera të vogla".
Fatura e datës 20.04.2016 në shumën 129,600 lekë, nënshkruar në cilësinë e blerësit nga ----------, dhe jo nga anëtarët e komisionit të blerjeve me vlerë të vogël, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 20.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik", neni 40, pika 7 "Procedura e prokurimit me vlerë të vogël", ku citohet se: *"Pagesa për prokurimet me vlerë të vogël bëhet sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Në çdo rast, faturat e mallrave apo të shërbimeve duhet të jenë të rregullta sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të nënshkruhen nga anëtarët e komisionit*

blerjeve me vlera të vogla. Faturat e lëshuara kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë nënshkruar një të tillë".

***Likuidimi** është* kryer 3 muaj me vonesë**,** në kundërshtim me ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7, ku citohet se: *"Afati për autoritetet publike, në veprimet juridike dhe tregtare, në të cilat debitori është autoritet autoritet publik, afati i pagesës nuk duhet të jetë më i gjatë se 30 ditë kalendarike pas marrjes në dorëzim të faturës, mallrave dhe shërbimeve".*

-Me urdhër shpenzimin nr.90, datë 15.07.2016, është likuiduar shuma 167,999 lekë, operatorit ekonomik "---------" për ***"Blerje karroca dore"*** fatura nr.30, datë 23.05.2016 dhe hyrja nr.23, datë 23.05.2016 .

Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e kryerjes së prokurimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.

Mungojnë specifikimet teknike, nuk ka asnjë specifikim teknik në lidhje me llojin, përmasat ngjyrën, materialin, madhësinë, modelin, etj, etj, të dhëna të nevojshme për artikujt do të prokurohen, sepse bazuar në specifikimet teknike përcaktohet/diferencohet cilësia dhe çmimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 23 "Specifikimet teknike" dhe VKM nr.914, datë 20.12.2014, neni 27.

Likuidimiështë kryer 2 muaj me vonesë**,** në kundërshtim me ligjin nr.48/ 2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7, ku citohet se: *"Afati për autoritetet publike, në veprimet juridike dhe tregtare, në të cilat debitori është autoritet autoritet publik, afati i pagesës nuk duhet të jetë më i gjatë se 30 ditë kalendarike pas marrjes në dorëzim të faturës, mallrave dhe shërbimeve".*

- Me urdhër shpenzimin nr.91, datë 19.07.2016, është likuiduar shuma 439,200 lekë, operatorit ekonomik ---------- për ***"Blerje pjesë për fadroma"*** fatura nr.26, datë 16.03.2016 dhe hyrja nr.11, datë 16.03.2016.

Urdhër prokurimi nr.934/1, datë 09.03.2016, ftesa për ofertë datë 10.02.2016 pra ftesa për ofertë është dërguar më parë se të dalë urdhri i prokurimit nga kryetari i autoritetit kontraktor. Kërkesa për prokurimin datë 09.03.2016 nga --------- ku citohet se duhet prokuruar fondi prej 416,666 lekë, pa tvsh ose 500,000 lekë me tvsh,specifikimet teknike dhe llogaritja e fondit megjithëse në kërkesën drejtuar titullarit citohet se llogaritja e fondit është bashkëlidhur, nuk janë pjesë e dokumentacionit.

Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e kryerjes së prokurimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.

Mungojnë specifikimet teknike, nuk ka asnjë specifikim teknik në lidhje me llojin,materialin, etj, etj, të dhëna të nevojshme për artikujt do të prokurohen, sepse bazuar në specifikimet teknike

përcaktohet/diferencohet cilësia dhe çmimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 23 "Specifikimet teknike" dhe VKM nr.914, datë 20.12.2014, neni 27.

Mungon llogaritja e fondit limit, në kundërshtim me Pikën 4 të Udhëzimit nr. 3 datë,27.01.2015, "Për prokurimet me vlera të vogla", ku citohet se: *"Në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij,komisioni i prokurimit me vlerë të vogël duhet të përllogarisë fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme". Kur lind nevoja për punë, mallra ose shërbime, titullari i autoritetit kontraktor ose një zyrtar tjetër i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohen objekti i prokurimit dhe sasia e tyre.*

Likuidimiështë kryer 4 muaj me vonesë, në kundërshtim me ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7, ku citohet se: *"Afati për autoritetet publike, në veprimet juridike dhe tregtare, në të cilat debitori është autoritet autoritet publik, afati i pagesës nuk duhet të jetë më i gjatë se 30 ditë kalendarike pas marrjes në dorëzim të faturës, mallrave dhe shërbimeve".*

- Me urdhër shpenzimin nr.122, datë 18.08.2016, është likuiduar shuma 513,360 lekë, operatorit ekonomik "---------" për ***"Blerje materiale"*** fatura nr.13, datë 21.06.2016.

Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e kryerjes së prokurimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4 si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.

Mungon llogaritja e fondit limit, në kundërshtim me Pikën 4 të Udhëzimit nr. 3 datë,27.01.2015, "Për prokurimet me vlera të vogla", ku citohet se: *"Në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij,komisioni i prokurimit me vlerë të vogël duhet të përllogarisë fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme". Kur lind nevoja për punë, mallra ose shërbime, titullari i autoritetit kontraktor ose një zyrtar tjetër i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohen objekti i prokurimit dhe sasia e tyre.*

Likuidimiështë kryer 2 muaj me vonesë, në kundërshtim me ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7, ku citohet se: *"Afati për autoritetet publike, në veprimet juridike dhe tregtare, në të cilat debitori është autoritet autoritet publik, afati i pagesës nuk duhet të jetë më i gjatë se 30 ditë kalendarike pas marrjes në dorëzim të faturës, mallrave dhe shërbimeve".*

- Me urdhër shpenzimin nr.123, datë 18.08.2016, është likuiduar shuma 157,200 lekë, operatorit ekonomik "---------" për ***"Blerje karroce me 2 kazane"*** fatura nr.32, datë 15.06.2016

Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e kryerjes së prokurimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.

Mungojnë specifikimet teknike, nuk ka asnjë specifikim teknik në lidhje me llojin,materialin, etj, etj, të dhëna të nevojshme për artikujt do të prokurohen, sepse bazuar në specifikimet teknike përcaktohet/diferencohet cilësia dhe çmimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 23 "Specifikimet teknike" dhe VKM nr.914, datë 20.12.2014, neni 27.

Mungon llogaritja e fondit limit, në kundërshtim me Pikën 4 të Udhëzimit nr. 3 datë,27.01.2015, "Për prokurimet me vlera të vogla", ku citohet se: *"Në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij,komisioni i prokurimit me vlerë të vogël duhet të përllogarisë fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme". Kur lind nevoja për punë, mallra ose shërbime, titullari i autoritetit kontraktor ose një zyrtar tjetër i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohen objekti i prokurimit dhe sasia e tyre.*

Likuidimiështë kryer 2 muaj me vonesë, në kundërshtim me ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7.

- Me urdhër shpenzimin nr.124, datë 18.08.2016 është likuiduar shuma 375,000 lekë, operatorit ekonomik "PC Store" për ***"Blerje pajisje kompjuterike"*** fatura nr.2838, datë 27.06.2016.

Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e kryerjes së prokurimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.

Mungon llogaritja e fondit limit, në kundërshtim me Pikën 4 të Udhëzimit nr. 3 datë,27.01.2015, "Për prokurimet me vlera të vogla".

Likuidimiështë kryer 2 muaj me vonesë, në kundërshtim me ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7.

- Me urdhër shpenzimin nr.112, datë 18.08.2016 është likuiduar shuma 680,400 lekë, operatorit ekonomik "Arben Abasllari" për ***"shërbim pajisje aparate peshore e vegla pune"*** fatura nr.14, datë 15.06.2016.

Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e kryerjes së prokurimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4 si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.

Mungojnë specifikimet teknike, nuk ka asnjë specifikim teknik në lidhje me shërbimin, etj, të dhëna të nevojshme për shërbimin, sepse bazuar në specifikimet teknike përcaktohet/diferencohet cilësia e shërbimit dhe çmimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 23 "Specifikimet teknike" dhe VKM nr.914, datë 20.12.2014, neni 27.

Mungon llogaritja e fondit limit, në kundërshtim me Pikën 4 të Udhëzimit nr. 3 datë,27.01.2015, "Për prokurimet me vlera të vogla".

Likuidimiështë kryer 2 muaj me vonesë, në kundërshtim me ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7.

- Me urdhër shpenzimin nr.165, datë 23.11.2016, është likuiduar shuma **279,960 lekë,** për ***"Shpenzime mirëmbajtje e mjeteve të transportit"*** ndaj "---------" sipas faturës tatimore nr. 5, datë 18.10.2016.

- Me urdhër shpenzimin nr.167, datë 23.11.2016, është likuiduar shuma **140,040 lekë,** për "shpenzime mirëmbajtje e mjeteve të transportit" operatorit ekonomik "---------" sipas faturës tatimore nr. 12, datë 16.11.2016.

Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e kryerjes e shërbimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4 si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.

Mungojnë specifikimet teknike, nuk ka asnjë specifikim teknik në lidhje me shërbimin, nr. e mjeteve, llojin e riparimit, etj, por janë evidentuar mjetet dhe sasia, në asnjë rresht nuk ka specifikime teknike, të dhëna të nevojshme për shërbimin, sepse bazuar në specifikimet teknike përcaktohet/diferencohet cilësia e shërbimit dhe çmimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 23 "Specifikimet teknike" dhe VKM nr.914, datë 20.12.2014, neni 27.

Specifikimet teknike janë hartuar nga ---------, ---------, Besnik Sina.

Mungon llogaritja e fondit limit, në kundërshtim me Pikën 4 të Udhëzimit nr. 3 datë,27.01.2015, "Për prokurimet me vlera të vogla".

Për këtë shërbim, referuar dokumentacionit justifikues janë mbajtur 2 procesverbale të nënshkruar nga komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga ---------, -------, të cilët janë mbajtur formal pasi nuk kanë datë, nuk përshkruan qëllimin, vendin dhe përdorimin e këtyre pajisjeve të blera për shërbimet e kryera.

Likuidimi është kryer referuar kontratës nr.1636/7, datë 28.06.2016, nënshkruar nga --------- dhe përfaqësuesi i shoqërisë "----------, me objekt "Mirëmbajtje e mjeteve të transportit, riparim goma" kontrata ka vlerën 420,000 lekë me tvsh e cila është likuiduar plotësisht brenda afatit.

Mungon dokumentacioni justifikues i cili konfirmon domosdoshmërinë dhe kryerjen e shërbimit nr e mjeteve, mungojnë procesverbalet nga palët për çdo shërbim të kryer sipas defekteve, llojit të mjetit pra nuk ka asnjë gjurmë për kryerjen e shërbimeve.

- Me urdhër shpenzimin nr.183, datë 20. 12.2016 është likuiduar shuma 237,895 lekë, për ***"Blerje mish për kafshët e kopshtit zoologjik"*** ndaj "---------" sipas faturave tatimore nr.550, datë 31.01.2016 dhe nr.29.02.2016 hyrjeve nr.1, datë 31.01.2016 dhe nr.2, datë 29.02.2016.

Sipas nenit 5 Afati kontratës, malli duhej lëvruar deri në datën 27.02.2016, pra furnizimi 2 ditë me vonesë. Mungojnë specifikimet për mallin, mungojnë kërkesat, bashkëlidhur praktikës së likuidimit dhe sipas procesverbaleve të mbajtura nga komisioni i përbërë prej ---------, pergjegjës sektori, --- punonjës i parkut zoologjik, zootekniku dhe mjeku veteriner në datat 31.01.2016 dhe

29.02.2016 citohet se: janë therrur 9 dhe 12 krerë gomerë nga ku është përfituar 703 kg mish i freskët. Nuk ka të dhëna në lidhje me sasinë që konsumohet në muaj numrin e kafshëve etj.
Procedura e ndjekur është "me negocim pa shpallje" referuar procesverbalit të mbajtur në datën 05.01.2016 nga njësia e prokurimit e përbërë nga ---------, --------- dhe --------- bazuar në kontratën nr.369/7, datë 02.04.2015 për nevojat e fillim vitit.
Urdhër prokurimi nr.3515, datë 31.12.2015 me fond limit 198,246 lekë.
Likuidimiështë kryer 10 muaj me vonesë, në kundërshtim me ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7.
- Me urdhër shpenzimin nr.186, datë 20. 12.2016, është likuiduar shuma 465,600 lekë, për ***"Riparime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave"*** ndaj "---------shpk" sipas faturës tatimore nr.35, datë 11.07.2016. Sipas urdhër prokurimit nr.1928/2, datë 24.06.2016 me objekt "shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave" me fond limit 541,666 lekë (---------)
Urdhër nr.1928/7, datë 01.07.2016 (---------), për marrjen në dorëzim.
Njoftimi fituesit nr.1928/5, datë 30.06.2016
Kontrata nr.1926/6, datë 01.07.2016 ku janë paraqitur edhe specifikimet teknike, si më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Vlefta me tvsh
1	Riparim fotokopje IR 1210 probleme me drumin	Cope	1	30,000
2	Riparim fotokopje Toshiba E-Studio 16,rrula furre, gishta furre, gomina,etj	Cope	1	48,600
3	Riparim fotokopje OKI MC 352 probleme me drumin	Cope	1	50,000
4	Riparim kompjuteri PC	Cope	3	24,000
5	Riparim tavolinave të zyrave	Cope	21	105,000
6	Riparim kondicionere (ndërrim motori)	Cope	2	208,000
	Shuma			**465,600**

Ftesa për ofertë nr. 1928/3, datë 24.06.2016, ku përcaktohet kryerja e këtij shërbimi sipas tabelës së mësipërme.
Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e kryerjes e shërbimit dhe evidentimi i defekteve nga specialistët, nuk ka asnjë gjurmë si janë përcaktuar defektet, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.
Mungojnë specifikimet teknike, nuk ka asnjë specifikim teknik në lidhje me riparimin e tavolinave se çfarë riparimesh do të kryhen për tavolinat, fotokopjet, kompjuterat, etj, për të përcaktuar më tej volumin e punës dhe çmimet llojin e riparimit, etj, por janë evidentuar artikujt dhe sasia, në asnjë rresht nuk ka specifikime teknike, të dhëna të nevojshme për shërbimin, sepse bazuar në specifikimet teknike përcaktohet/diferencohet cilësia e shërbimit dhe çmimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 23 "Specifikimet teknike" dhe VKM nr.914, datë 20.12.2014, neni 27.
Specifikimet teknike (tabela pa specifikime) hartuar nga --------- ing mekanik, --------- ish shefe personeli dhe --------- specialist transporti.

Mungon llogaritja e fondit limit, sepse është kryer pa pasur në dispozicion specifikimet teknike, në kundërshtim me Pikën 4 të Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera të vogla".

Sipas procesverbalit nr.2, datë 30.06.2016, mbajtur nga komisioni konfirmohet se fitues eshte renditur ofertuesi i tretë sepse nuk u paraqitën 2 ofertuesit e klasifikuar.

Komisioni i blerjeve nuk ka arritur ofertën ekonomike më të mire si pasojë e mangësive në hartimin e ftesës për ofertë dhe specifikimeve për kryerjen e shërbimit.

Procesverbali i mbajtur për kryerjen e shërbimit në datën 11.07.2016 nga ---------, është formal sepse konfirmon se u bë kontrolli në vend i mallit për sasinë dhe specifikimet teknike dhe u arrit në përfundimin se sasia dhe lloji i mallit kanë ardhur sipas sasisë dhe specifikimeve të përcaktuara. Pra, procesverbali nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

Likuidimiështë kryer 5 muaj me vonesë, në kundërshtim me ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7.

- Me urdhër shpenzimin nr.187, datë 20. 12.2016, është likuiduar shuma 474,000 lekë, për ***"Blerje pajisje zyra"*** ndaj "---------" sipas faturës tatimore nr.2617, datë 05.08.2016 dhe fletë hyrjes nr.15, datë 05.08.2016. Marrja në dorëzim nga ----------, sipas procesverbalit të datës 05.08.2016, konfirmohet se u bë kontrolli në vend i mallit për sasinë dhe specifikimet teknike dhe u arrit në përfundimin se sasia dhe lloji i mallit kanë ardhur sipas sasisë dhe specifikimeve të përcaktuara.

Sipas urdhër prokurimit nr.2182/1, datë 07.07.2016 me objekt ***"Pajisje orendi zyre, soba"*** me fond limit 400, 000 lekë (---------).

Urdhër nr.1928/7, datë 01.07.2016 (---------), për marrjen në dorëzim të kondicionerëve, ku janë riparuar 2 kondicionerë në shumën 208,000 lekë, ose nga 104,000 lekë/ copë.

Procesverbali datës 05.08.2016, mbajtur nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla, për rastet e mosrealizimit të prokurimit në sistemin elektronik për mungesë konkurence 2 herë në datat 27.08.2016 dhe 08.07.2016 dhe procedura është realizua në rrugë shkresore. Eshtë testuar tregu dhe janë marrë ofertat nga "---------" në shumën 395,000 lekë pa tvsh, 3R me ofertë 397,900 lekë pa tvsh dhe --------- Guaranty Transformer në shumën 399,700 lekë.

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlefta pa tvsh
1	Karrike zyre	copë	8	4,500	36,000
2	Karrike poltroon	copë	1	43,000	43,000
3	Kondicioner	copë	2	75,000	150,000
4	Dollap	copë	1	65,000	65,000
5	Frigorifer zyre	copë	1	16,000	16,000
6	Tavolinë pune e madhe	copë	1	40,000	40,000
7	Kolltuk me 3 vende	copë	1	45,000	45,000
	Shuma				**395,000**

Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e artikujve si dhe destinacioni, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.

Mungojnë specifikimet teknike, nuk ka asnjë specifikim teknik në lidhje me artikujt e kërkuar. Prokurimi është kryer jashtë procedurave ligjore, nuk mund të realizohet prokurimi në kushtet kur nuk janë përcaktuar specifikimet për karriket, poltronet dhe kolltukun si: ngjyra, madhësia - dimensionet, modeli, materiali etj, për kondicionerët nuk janë përcaktuar volumi i ngrohje/ftohjes, ngjyra, përmasat etj, për dollapin nuk ka specifikime në lidhje me ngjyrën, materialin, përmasat, modelin, etj… për tavolinën e punës caktohet vetëm tavolinë pune e madhe, nuk specifikohet ngjyra, modeli, materiali, përmasat, trashësia e suprinës, etj, specifikime të domosdoshme për prokurimin me qëllim përcaktimin e çmimeve dhe vlerës nga ofertuesit, por janë evidentuar artikujt dhe sasia, në asnjë rresht nuk ka specifikime teknike, të dhëna të nevojshme për artikujt, sepse bazuar në specifikimet teknike përcaktohet/diferencohet cilësia e mallrave dhe çmimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 23 "Specifikimet teknike" dhe VKM nr.914, datë 20.12.2014, neni 27.

Mungon llogaritja e fondit limit, sepse është kryer pa pasur në dispozicion specifikimet teknike (---------, ----- --------- dhe ---------), në kundërshtim me Pikën 4 të Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera të vogla".

Komisioni i blerjeve nuk ka arritur ofertën ekonomike më të mire si pasojë e mangësive në hartimin e ftesës për ofertë dhe specifikimeve për kryerjen e shërbimit.

Likuidimi është kryer 4 muaj me vonesë, në kundërshtim me ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7.

Referuar dokumenteve të prokurimit të riparimit dhe prokurimit të 2 kondicionerëve, konstatohet se:

- Objekti i prokurimitpërcakton blerje soba dhe jo kondicionerë.

-Urdhri i prokurimit i nxjerrë nga z.---------, në të 2 rastet për riparim dhe blerje kondicionerësh nuk ka të argumentuar nevojat dhe kërkesat për riparimn dhe për blerjen.

-Kondicionerët e riparuar kanë punuar 1 javë dhe janë prokuruar 2 kondicionerë të tjerë brenda 1 jave nga data e riparimit.

-Mungojnë procesverbalet që vërtetojnë defektet .

-Mungojnë specifikimet teknike, etj.

-Vlera e riparimit është më lartë se blerja e 2 kondicionerëve të rinj, në shumën 58,000 lekë.

Në këto kushte është vepruar në kundërshtim meligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, VKM nr.914, datë 20.12.2014 dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", "Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve" pikat 35 dhe 36, ku citohet se: *"Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumenta origjinale "dokumenta vërtetues"që vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë*

kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, proçesverbalet, dhe te tjera akte me natyre verifikues shpenzimi. Dokumentacioni quhet i rregullt kur pershkruan me vertetesi veprimin ose ngjarjen, permban te dhena per shkakun e veprimit, daten dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato te vleres, personat qe kane urdheruar dhe ekzekutuar veprimin dhe te tjera te dhëna te nevojshme qe i japin dokumentit forcën e nje prove ligjore ose administrative".

Vlera prej *208,000 lekë,* prokuruar për riparimin e kondicionerëve, ngarkon me përgjegjësi z.----------.

- Me urdhër shpenzimin nr.193, datë 20.12.2016, është likuiduar shuma 936,000 lekë, për ***"Blerje materiale specifike celesa, kacavida, pinca, lima, etj"*** ndaj "Poëers industry" sipas faturës tatimore nr.23, datë 18.10.2016 dhe fletëhyrjes nr.40, datë 18.10.2016. Urdhër prokurimi nr.2996/11, datë 29.09.2016 me fond limit 800,000 lekë, ---------.

Sipas procesverbalit të datës 18.10.2016 komisioni blerjeve të vogla konfirmon se si pasojë e mungesës së konkurencës në sistemin elektronik në datat 21 dhe 30.09.2016, procedura u zhvillua shkresore.

Janë marrë çmimet ofertë nga 3 operatorë ekonomikë:

---- vlerë 780,000 lekë fitues.

---------- vlerë me vlerë 790,000 lekë

-------- me vlerë 800,000 lekë

Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e artikujve si dhe destinacioni, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.

Mungojnë specifikimet teknike, nuk ka asnjë specifikim teknik në lidhje me artikujt e kërkuar. Prokurimi është kryer jashtë procedurave ligjore, nuk mund të realizohet prokurimi në kushtet kur nuk janë përcaktuar specifikimet teknike të domosdoshme për prokurimin me qëllim përcaktimin e çmimeve dhe vlerës nga ofertuesit, por janë evidentuar artikujt dhe sasia, në asnjë rresht nuk ka specifikime teknike, të dhëna të nevojshme për artikujt, sepse bazuar në specifikimet teknike përcaktohet/diferencohet cilësia e mallrave dhe çmimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 23 "Specifikimet teknike" dhe VKM nr.914, datë 20.12.2014, neni 27.

Mungon llogaritja e fondit limit, sepse është kryer pa pasur në dispozicion specifikimet teknike, në kundërshtim me Pikën 4 të Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera të vogla".

Mungon procesverbali i marrjes në dorëzim të artikujve, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", "Veprimet që

kryejnë strukturat e Nëpunësit Zbatues", pika 54, ku citohet se: "Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës qe verteton marrjen ne dorezim te aktiveve sipas kushteve të kontratës si process verbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione te shpenzimeve per investimet, fletë hyrje origjinale, proçes-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj".

Likuidimi është kryer 2 muaj me vonesë, në kundërshtim me ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7.

- Me urdhër shpenzimin nr.195, datë 20.12.2016, është likuiduar shuma 119,862 lekë, për ***"Blerje kancelari"***, ndaj "---------" sipas faturës tatimore nr.109, datë 01.11.2016 dhe fletëhyrjes nr.42, datë 01.11.2016, procesverbali i marrjes në dorëzim datë 01.11.2016.

Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e artikujve si dhe destinacioni, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.

Mungojnë specifikimet teknike, nuk ka asnjë specifikim teknik në lidhje me artikujt e kërkuar. Prokurimi është kryer jashtë procedurave ligjore, nuk mund të realizohet prokurimi në kushtet kur nuk janë përcaktuar specifikimet teknike të domosdoshme për prokurimin me qëllim përcaktimin e çmimeve dhe vlerës nga ofertuesit, por janë evidentuar artikujt dhe sasia, në asnjë rresht nuk ka specifikime teknike, të dhëna të nevojshme për artikujt, sepse bazuar në specifikimet teknike përcaktohet/diferencohet cilësia e mallrave dhe çmimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 23 "Specifikimet teknike" dhe VKM nr.914, datë 20.12.2014, neni 27.

Sipas urdhër prokurimit nr.3352/2, datë 01.11.2016 nga --------- procedura është kryer për prokurime me vlerë 100,000 lekë. Janë marrë çmimet ofertë në datën 01.11.2016, nga 3 operatorë ekonomikë:

---------- vlerë 105,075 lekë

--------- vlerë me vlerë 112,635 lekë fitues.

---------me vlerë 99,885 lekë

Marrja e ofertave, procesverbalet për zhvillimin e procedurës, marrja në dorëzim, vlerësimi, fatura fletë hyrja, janë kryer brenda 1 dite në datën 01.11.2016, kohë e pamjaftueshme për vlerësimin e ofertave, me qëllim arritjen e prokurimit në cilësi dhe vlerë ekonomike më të mire.

Likuidimiështë kryer 2 muaj me vonesë, në kundërshtim me ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7.

- Me urdhër shpenzimin nr.213/1, datë 29.12.2016, është likuiduar shuma 117,600 lekë, për ***"Blerje kancelari"***, ndaj "---------" sipas faturës tatimore nr.4285, datë 22.12.2016 dhe fletëhyrjes nr.47, datë 22.12.2016. Sipas urdhër prokurimit nr.3843/2, datë 22.12.2016 nga ---------, procedura është kryer për prokurime me vlerë 100,000 lekë.

Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e artikujve si dhe destinacioni, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.

Mungojnë specifikimet teknike, nuk ka asnjë specifikim teknik në lidhje me artikujt e kërkuar. Prokurimi është kryer jashtë procedurave ligjore, nuk mund të realizohet prokurimi në kushtet kur nuk janë përcaktuar specifikimet teknike të domosdoshme për prokurimin me qëllim përcaktimin e çmimeve dhe vlerës nga ofertuesit, por janë evidentuar artikujt dhe sasia, në asnjë rresht nuk ka specifikime teknike, të dhëna të nevojshme për artikujt, sepse bazuar në specifikimet teknike përcaktohet/diferencohet cilësia e mallrave dhe çmimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 23 "Specifikimet teknike" dhe VKM nr.914, datë 20.12.2014, neni 27.

Janë marrë çmimet ofertë në datën 22.12.2016, nga 3 operatorë ekonomikë:
Eurolitame vlerë 120,100 lekëme tvsh
Infosoft officeme vlerë me vlerë 118,100 lekë.
---------me vlerë 117,600 lekë fitues

Marrja e ofertave, procesverbalet për zhvillimin e procedurës, marrja në dorëzim, vlerësimi, fatura fletë hyrja, janë kryer brenda 1 dite në datën 01.11.2016, kohë e pamjaftueshme për vlerësimin e ofertave, me qëllim arritjen e prokurimit në cilësi dhe vlerë ekonomike më të mire.

Procesverbal marrje në dorëzim nuk ka nga komisioni marrjes në dorëzim, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", "Veprimet që kryejnë strukturat e Nëpunësit Zbatues", pika 54, ku citohet se: "Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si process verbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione te shpenzimeve per investimet, fletë hyrje origjinale, proçes-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj".

<u>6-Mujori i vitit 2017</u>

Për 6-mujorin e I të vitit 2017, është parashikuar për blerjet me vlera të vogla, shuma prej **2,100,000 lekë,** janë realizuar 6 procedura me vlerë **2,530,380 lekë.**

Me urdhrin nr.91, datë 16.01.2017, të titullarit të Autoritetit Kontraktor është ngritur komisioni i blerjeve me vlera të vogla për vitin 2017, i përbërë nga ---------, me detyrë shef i sektorit të prokurimeve, ---------, me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve dhe ---------, me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve.

- Me urdhër shpenzimin nr.24, datë 13.03.2017 është likuiduar shuma 114,000 lekë, për ***"Blerje sistem telefonie PBX"*** pagesë e faturës tatimore nr.33, datë 16.02.2016, pa nënshkruar nga blerësit dhe komisioni blerjeve të vogla. Mungon dokumentacioni prokurimit, nuk ka

procesverbal të mbajtur për marrjen në dorëzim.Komisioni marrjes në dorëzim -------, sipas urdhrit nr.393/2, date 10.02.2017.

- Me urdhër shpenzimin nr.25, datë 13.03.2017 është likuiduar shuma 117,600 lekë, për ***"shërbim konfigurim mirëmbajtje rrjeti"*** pagesë e faturës tatimore nr.38, datë 21.02.2016, pa nënshkruar nga blerësit dhe komisioni blerjeve të vogla. Mungon dokumentacioni i prokurimit, nuk ka procesverbal të mbajtur për marrjen në dorëzim.Komisioni marrjes në dorëzim --------, sipas urdhrit nr.447/2, datë 17.02.2017.

- Me urdhër shpenzimin nr.29, datë 19.04.2017 është likuiduar shuma 471,600 lekë, për ***"Blerje bojë printerash"*** ndaj "---------" pagesë e faturës tatimore nr. 2437, datë 20.02.2017, e pa nënshkruar nga blerësit dhe komisioni blerjeve të vogla. Urdhër prokurimi nr.295/1, datë 01.02.2017, si pasojë e moskryerjes së procedurës on line anuluar 2 herë procedura, referuar procesverbalit të datës 20.02.2017 mbajtur nga komisioni blerjeve të vogla është kryer procedura shkresore ku citohet se pas testimit të tregut për çmimet janë paraqitur 3 oferta --------- në shumën 408,800 lekë pa tvsh, --------- me vlerë 416,600 lekë pa tvsh dhe --------- me vlerë 393,000 lekë. Urdhri për marrjen në dorëzim datë 20.02.2017, procesverbal marrje në dorëzim datë 20.02.2017.

Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e artikujve si dhe destinacioni, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.

Likuidimiështë kryer 2 muaj me vonesë, në kundërshtim me ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7.

- Me urdhër shpenzimin nr.46, datë 03.05.2017 është likuiduar shuma 936,960 lekë, për ***"Blerje materiale kancelarie dhe pastrimi"*** pagesë e faturës tatimore nr.113, datë 13.03.2017, pa u nënshkruar nga blerësi dhe komisioni blerjeve të vogla, fletë hyrja nr.5, datë 13.03.2017. Sipas procesverbalit të mbajtur në datën 13.03.2017 nga komisioni prokurimit me vlerë të vogël citohet se si pasojë e mosrealizimit të procedurës në sistemin elektronik për mungesë konkurence në datat 08.02.2017 dhe 20.02.2017 komisioni vendosi të realizojë këtë procedurë në rrugë shkresore, ku citohet se pas testimit të tregut për çmimet janë paraqitur 3 oferta:

--------- në shumën 780,800 lekë pa tvsh,
4 KTrading me vlerë 846,040 lekë pa tvsh
---------- me vlerë 814,780 lekë.

Referuar faturës dhe fletë hyrjes konstatojmë se çmimet e ofruara janë më të larta se çmimet me pakicë që ofron tregu, si psh:

Dezinfektues ëc 20 copë x 384 lekëShtupa 10 copë x 300 lekë
Solucion duarsh 40 copë x 408 lekëDoreza pastrimi20 copë x 264 lekë
Aromatik pllakash 20 copë x 420 lekëSolucion për pllaka 20 copë x 420 lekë
Stilolapsa 500 copë x 192 lekëFshesa plastike 10 copë x 408 lekë

Qese A4 100 pako x 780 lekë Bishta 10 copë x 120 lekë
Komisioni i marrjes në dorëzim ----------, ku citohet se mallrat janë sipas specifikimeve të kërkuara, në një kohë që nuk ka specifikime teknike.
Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e artikujve si dhe destinacioni, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, si dhe Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë.
Mungojnë specifikimet teknike, nuk ka asnjë specifikim teknik në lidhje me artikujt e kërkuar. Prokurimi është kryer në subjektin ---------, Paskuqan. Në praktikën e prokurimit janë përcaktuar vetëm emërtimi dhe sasitë, mungojnë specifikimet për mallrat si përmasat e artikujve, ngjyra, materiali, etj, etj specifika të domosdoshme për artikujt specifikimet teknike të domosdoshme për prokurimin me qëllim përcaktimin e çmimeve dhe vlerës nga ofertuesit, por janë evidentuar artikujt dhe sasia, në asnjë rresht nuk ka specifikime teknike, të dhëna të nevojshme për artikujt, sepse bazuar në specifikimet teknike përcaktohet/diferencohet cilësia e mallrave dhe çmimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 23 "Specifikimet teknike" dhe VKM nr.914, datë 20.12.2014, neni 27.
Procedura e përzgjedhjes së operatorit ekonomik, procesverbali blerjes, fatura, hyrja, procesverbal marrje në dorëzim janë kryer brenda 1 dite, kohë e pamjaftueshme për vlerësimin e ofertave dhe përgatitjen e dokumentacionit.
Likuidimiështë kryer 2 muaj me vonesë, në kundërshtim me ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7.
- Me urdhër shpenzimin nr.51, datë 10.05.2017 është likuiduar shuma 117,000 lekë, shoqërisë "Ekstrade" për ***"Blerje 150 copë bluza"*** pagesë e faturës tatimore nr.17, datë 21.04.2017, fletë hyrja nr.9, datë 21.04.2017.
Mungon llogaritja e fondit limit, sepse është kryer pa pasur në dispozicion specifikimet teknike, në kundërshtim me Pikën 4, të Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera të vogla".
Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e artikujve si dhe destinacioni, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, si dhe Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë.
Mungojnë specifikimet teknike, nuk ka asnjë specifikim teknik në lidhje me artikujt e kërkuar, specifikimet teknike, si duhen bluzat, ngjyra, materiali, masat etj, etj kërkesa te nevojshme, por janë evidentuar artikujt dhe sasia, në asnjë rresht nuk ka specifikime teknike, të dhëna të nevojshme për artikujt, sepse bazuar në specifikimet teknike përcaktohet/diferencohet cilësia e mallrave dhe çmimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 23 "Specifikimet teknike" dhe VKM nr.914, datë 20.12.2014, neni 27.
Sipas procesverbalit të mbajtur në datën 18.04.2017 nga komisioni prokurimit me vlerë të vogël citohet se: "*si pasojë e kërkesës nga sektori i riciklimit në kuadër të sensibilizimit dhe*

pamundësisë për kryerjen e shërbimit të parashikuar në regjistër u bë e mundur në rrethana emergjente".

Praktika nuk ka asnjë dokument tjetër përveç procesverbalit të blerjes emergjente, faturës dhe fletëhyrjes.

- Me urdhër shpenzimin nr.52, datë 10.05.2017 është lëkuiduar shuma 118,800 lekë, shoqërisë "Sokol Rrokaj" për ***"Blerje 3000 copë broshura"*** pagesë e faturës tatimore nr.46, datë 21.04.2017, fletë hyrja nr.10, datë 21.04.2017

Mungon llogaritja e fondit limit, sepse është kryer pa pasur në dispozicion specifikimet teknike, në kundërshtim me Pikën 4 të Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera të vogla".

Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e artikujve si dhe destinacioni, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, si dhe Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë.

Mungojnë specifikimet teknike, nuk ka asnjë specifikim teknik në lidhje me artikujt e kërkuar, specifikimet teknike, si duhen broshurat, ngjyra, materiali, përmasat, kopertina, etj, etj kërkesa te nevojshme, por janë evidentuar artikujt dhe sasia, në asnjë rresht nuk ka specifikime teknike, të dhëna të nevojshme për artikujt, sepse bazuar në specifikimet teknike përcaktohet/diferencohet cilësia e mallrave dhe çmimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 23 "Specifikimet teknike" dhe VKM nr.914, datë 20.12.2014, neni 27 ku citohet: "Specifikimetteknike që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeveqëdotë prokurohen,duhettë përgatitenpërtëpërshkruarsamësaktëdhenë mënyrëtëplotëobjektineprokurimit,dukekrijuarkushtepërkonkurrimtëpaanshëme tëhapurndërmjettëgjithëkandidatëveeofertuesve" dhe "Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPPdhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara".

Sipas procesverbalit të mbajtur në datën 18.04.2017 nga komisioni prokurimit me vlerë të vogël citohet se: "*si pasojë e kërkesës nga sektori i riciklimit në kuadër të sensibilizimit dhe pamundësisë për kryerjen e shërbimit të parashikuar në regjistër u bë e mundur në rrethana emergjente".*

Praktika nuk ka asnjë dokument tjetër përveç procesverbalit të blerjes emergjente, faturës dhe fletëhyrjes.

Faturat për blerjet e trajtuara më lart, nuk janë nënshkruar në cilësinë e blerësit nga anëtarët e komisionit të blerjeve me vlerë të vogël, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 20.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik", neni 40, pika 7 "Procedura e prokurimit me vlerë të vogël", ku citohet se: *"Pagesa për prokurimet me vlerë të vogël bëhet sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Në çdo rast, faturat e mallrave apo të shërbimeve duhet të jenë të rregullta sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të nënshkruhen nga anëtarët e komisionit blerjeve me vlera të vogla. Faturat e lëshuara kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë nënshkruar një të tillë".*

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se:

Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve Nr.1 e Qytetit, për procedurat e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, ka mangësi të theksuara në njohjen dhe zbatimin e legjislacionit, nuk janë hartuar drejt nevojat për mallra dhe shërbime, fondi limit i llogaritur për këtë qëllim është i fryrë dhe i pa bazuar në çmimet e periudhave të mëparshme, çmimet e publikuara nga INSTAT, etj, me qëllim arritjen e prokurimeve me efektivitet, ekonomicitet dhe eficencë, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9643, 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, germa b, VKM nr.914, datë 29.12.2014"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 40 "Procedura e prokurimit me vlerë të vogël" pika 1, dhe Udhëzimin nr.3, datë 27.01.2015 "Për prokurimet me vlera të vogla" pika 4.

Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e prokurimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, mungojnë specifikimet teknike, nuk ka asnjë specifikim teknik në lidhje me artikujt e kërkuar, sepse bazuar në specifikimet teknike përcaktohet/diferencohet cilësia e mallrave dhe çmimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 23 "Specifikimet teknike" dhe VKM nr.914, datë 20.12.2014, neni 27, Mungon llogaritja e fondit limit, në kundërshtim me Pikën 4 të Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera të vogla", është vepruar në kundërshtim meligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, VKM nr.914, datë 20.12.2014 dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", "Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve" pikat 35 dhe 36, për pajisjen me dokumentacioninvërtetues të shërbimeve të kryera.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:

-Ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.
-Ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare"
-VKM nr.914, datë 20.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",i ndryshuar.
-Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla".
-Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"
-Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57 datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen mepërgjegjësi:

Z. ---------, me detyrë Drejtor i Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve, Zj. ---------, me detyrë zv.Drejtore e Përgjithshme e DPN1, komisionet e blerjeve me vlera të vogla dhe hartimit të specifikimeve teknike zj. ---------, ish shefe sektorit të prokurimeve, z. ---------, me detyrë shef i sektorit të prokurimeve, zj. ---------,zj. ---------, ish specialiste në sektorin e prokurimeve, zj. ---------, me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve, z.---------, me detyrë shef i sektorit të transportit dhe z. ---------, me detyrë përgjegjës i ofiçinës.

- ***<u>Zbatimi i kontratave</u>***

Deri në fund të afatit u auditua 1 investim me vlerë të kontratës së lidhur 6,989,160 lekë me t.v.sh nga e cila rezultoi një dëm ekonomik në vlerën **102,000 lekë pa tvsh** si rrjedhojë e

përfshirjes së t.v.sh – së së pajisjeve në situacionin e punimeve, vlerë kjo e cila përbën një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për vitin 2016 - gjashtë mujori 2017, subjekti i audituar ka pasur fonde në dispozicion për të zhvilluar procedurat e tenderave dhe ka punuar me buxhet të miratuar rregullisht nga Këshilli Bashkiak.
Parashikimet e fondeve limite për çdo objekt prokurimi janë bërë duke u bazuar kryesisht në çmimet e testimit të tregut.
Nga verifikimi me zgjedhje i procedurave të prokurimeve publike të parashikuara dhe realizuara nga DPN 1, nëpërmjet evidencave të grumbulluara si dosjet e procedurave të prokurimit, arkiva në sistemin elektronik të prokurimit të APP dhe urdhër shpenzimeve të likujdimit të faturave për blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve nga procedurat e prokurimit publik për periudhën objekt auditimi, rezultoi se:

Në mijë lekë

	Fondi Limit	**Realizimi**	**Diferenca**
2016	201,659	195,055	6,604
2017	267,611	263,511	3,503

Nga auditimi rezultoi që DPN 1 ka zhvilluar gjatë vitit 2016, gjithësej 30 procedura prokurimi (pa përfshirë blerjet e vogla) me fondin limit rreth 201.659 mijë lekë dhe janë lidhur 30 kontrata në vlerën 195,055 mijë lekë.

Gjatë vitit 2017 (6-mujori I-rë) DPN 1 ka zhvilluar gjithësej 17 procedura prokurimi me fond limit 267.611 mijë lekë, janë lidhur 17 kontrata me vlerë 263,511 mijë lekë pa tvsh, janë zhvilluar gjashtë procedura blerje te vogla në shumën 797 mijë lekë si dhe janë lidhur po aq kontrata në shumë 937 mijë lekë me tvsh,.

Grupi i auditimit auditoi procedurën e prokurimit për 9 tendera, për të cilët u konstatuan mangësi dhe shkelje proceduriale të njëjtë si dhe mangësi e shkelje procedurale të veçanta për disa tendera, ku konkretisht gjendja paraqitet si vijon:

Në tenderin elektronik të zhvilluar me objekt*"Blerje Stola Dekorativ, Kosha"*, me të ardhurat e buxhetit të bashkisë, ku kanë marrë pjesë në konkurrim 3 operator ekonomik, e me të dhëna të tjera:

Urdhër prokurimi nr. 857/2,datë 06.05.2016	NJHDT **me urdhrin nr. 857/2,datë 06.05.2016**	**Urdhër prokurimi nr. 857/3,datë 06.05.2016** **Ndryshuar me urdhrin nr. 1784/1,datë 31.05.2016**
Fondi limit 8,333,256 lekë.	--------- ish- specialiste	
Procedura e prokurimit – e hapur	--------- pergjegjes sektori i prokurimeve ------- specialist sek prokurimeve	

Burimi i Financimit: Buxheti I Bashkisë Tiranë	Fitues "---------"shpk	Vlera fituese 8,310,000 lekë.
Datë e hapjes së tenderit01.06.2016	Diferenca nga fondi limit23,256 lekë.	Kontrata nr. 1734/3, datë 20.06.2016
Pjesmarrës – 3 S`kualifikuar - 2	Miratimi i procedurës03.06.2016	Vlera totale e kontratës 8,310,000 lekë pa TVSH 9,972,000 lekë me TVSH
Ankimimenë AK -s`ka Ankimimenë KPP -s'ka	Afati kontratës parashikuar30 ditë zbatuar 28 ditë.	Titullari AK/ personi I autorizuar– Rigels Memushaj
Likujduar deri në date 16.08.2016 në vlerën 9,972,000 lekë	Hyrje në magazine me fletehyrje nr. 12 datë 18.07.2016	

Nga auditimi rezultoi se:
Në dosje ndodhet shkresa e drejtorit të mirembajtjes dhe zhvillimit të qytetit i cili ka paraqitur kërkesen lidhur me nevojat emergjente të drejtorise për një sasi të caktuar stola dhe kosha dekorativ. Me shkresën me nr.857/1 prot, datë 06.05.2017 është miratuar kërkesa e drejtorisë së sipërpërmendur dhe është vijuar me hapjen e procedurave të prokurimit. Me shkresën me nr. 857 prot, datë 01.03.2016 është ngritur grupi i punës për përgatitjen e specifikimeve teknike si dhe me urdhërin nr. 857/2 prot datë 06.05.2016 të titullarit të autoritetit kontraktor është vijuar me procedurat duke nxjerrë urdhërin e prokurimit për procedurën në vlerën me fond limit 8,333,256(tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë ë dyqind e pesëdhjet e gjashtë) lekë pa tvsh, me objekt prokurimi blerje stola, kosha dekorativ dhe me lloj procedure: "procedurë e hapur". Njësia e prokurimit për hartimin e dokumentacionit të tenderit ka mbajt procesverbalin përkatës në të cilin janë miratuar kërkesat për kualifikim, afati i levrimit dhe është vendosur kriteri i vlersimit duke u nisur nga cmimi më i ulët.
Nga shqyrtimi i këtyre dokumentave konstatohet se në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga autoriteti kontraktor nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 61 "hartimi dhe publikimi I dokumenteve të tenderit".Në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit janë përcaktuar kriteret e kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë argumentuar.Gjithashtu, nga njësia e prokurimit në dokumentet standarte të tenderit janë kërkuar kritere të ekzagjeruara dhe të pa argumentuara**,** si;

- License profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:
- Për kategorinë NS-8 -A (Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri) sipas modelit të lëshuar nga MPPT
- Certifikatë ISO I menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë (OHSAS 18001-2007)
- Për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi, ofertuese duhet të ketë të përfshirë në listpagesa dhe në licensën e shoqërisë : inxhinier mekanik
- Dëshmitë aftësisë profesionale ose leje manovrimi për punonjësit që do të përdorin makinëritë e rënda që nevojiten për ekzekutimin e kontratës lëshuar nga Ministria e

Transportit dhe Infrastrukturës së vlefshme, minimumi 1 automakinista, të shoqeruar me kontratat e punës dhe te jenë të rregjistruar në kompaninë e tij.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një mjek ndërmarrjeje të punësuar dhe të regjistruar në kompaninë e tij për gjashtë muajt e fundit, në bazë të paragrafit 12/2 të shëndetit në punë të VKM Nr. 692 , datë 13.12.2001, i ndryshuar.etj
- Shoqëria duhet të ketë trajnuar stafin me kursin bazë të ndihmës së parë të zhvilluar nga KKSH
- Një punësim mesatar I të paktën 25 personave, për periudhën janar 2013- shkurt 2016
- Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

- Autovinc, saldatrice,kamioncinë veteshkarkuese,makineri e lëvizshme me paisjes peciale për testimin e materialeve të ndërtimit

Nga verifikimi i sitemit elektronik në app rezultoi se në këtë procedurë kanë marrë pjesëtre operatorëekonomik konkretisht **--------- shpk, --------- shpk dhe --------- shpk**.Pas hapjes së ofertave të paraqitura prej këtyre operatorve është realizuar regjistrimi i tyre në proçesverbalin e hapjes dhe është kaluar në fazën e vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.Nga shqyrtimi i tyre ka rezultuar se operatori --------- shpk me NIPT J 61922018, me çmim total të ofertës pa tvsh 8,310,000 lekë dhe 9,927,000 lekë me tvsh i plotëson kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, si dhe nuk ka gabime aritmetike përsa i përketllogaritjes së vlerës së ofertës. Nga kjo shoqëri nuk ka pasur tërheqje apo modifikim ofertash. Duke qenë se oferta e operatorit ekonomik --------- ka qenë në përputhje me kërkesat e tenderit, është shpallur si ofertë e vlefshme. Ofertat e paraqitura nga ofertuesit --------- shpk. dhe --------- shpk nuk i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të vecanta për kualifikim si dhe nuk kanë dorëzuar formularin e ofertës. Për këtë arsye këta operatorë ekonomik janë skualifikuar dhe nga komisioni i vlersimit të ofertave si dhe nuk kanë dorëzuar formularin e ofertës. Për këtë arsye këta operatorë ekonomik janë skualifikuar dhe nga komisioni i vlersimit të ofertave është klasifikuar në vend të parë oferta e paraqitur nga operatori ekonomik --------- Company sh.p.k si e vetmja ofertë e vlefshme.Në lidhje me këtë procedurë*nga verifikimi i sitemit elektronik në app rezultoi se asnjë nga operatorët ekonomik pjesmarrës në tender nuk ka paraqitur ankesa*. Ndërmjet DPN 1 dhe administratorit të firmës --------- është lidhur kontrata e furnizimit me nr. 1734/3 në datë 20.06.2016 me afat lëvrimi 30 ditë.Për marrjen në dorzimim të materialeve të prokuruara është ngritur komisioni i marrjes në dorzim me urdhrin nr. 1734/8 prot dt. 20.06.2016 i cili në date 18.07.2016 ka përpiluar dhe nënshkruar procesverbalin e marrjes në dorëzim ku citohet se sasia dhe lloji i mallit të ardhur është sipas sasisë dhe specifikimeve të përcaktuara në ftesën për ofertë. Malli është bërë hyrje në magazine me fletehyrje nr. 12 datë 18.07.2016. Fatura është likujtuar me urdhër shpenzimin Nr. 111 Datë 16.08.2016. Nga ana e Njësisë së prokurimit nuk janë zbatuar përcaktimet e bëra në nenet 3 e 29 të"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", përsa i përket inventarizimit të dosjes së prokurimit.Referuar nenit 3 e 29 të"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
Nga ana e njësisë së prokurimit nuk janë dhënë argumenta për përcaktimin e kritereve të kualifikimit.Nga ana e njësisë së prokurimit janë caktuar kritere kualifikimi të vlerësuara të panevojshme nga grupi i auditimit, veprim i cili ndikon negativisht në pjesëmarrjen masive të operatorëve ekonomikë.Dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar sipas legjislacionit në fuqi.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të përcaktuara në:
Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat". Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen mepërgjegjësi Z. --------- me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Hartimit të Dokumetave të Tenderit, Znj. ---------me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Hartimit të Dokumetave të Tenderit, Znj. --------- me detyrë ish/specialist e prokurimeve,në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Hartimit të Dokumetave të Tenderit.

Në tenderin elektronik të zhvilluar me objekt *"Blerje"Çakulli"për vitin 2016"*, me të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Tiranë, ku kanë marrë pjesë në konkurrim 3 operator ekonomik, e me të dhëna të tjera:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Blerje çakull"		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 1280/2, datë 06.05.2016	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr. 1280/1 datë 06.05.2016 --------- me detyrë _____	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** me urdhër nr.1280/3, datë 06.05.2016
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Kërkesë Propopozim"	NJHST me urdhrin nr.1280, datë 19.04.2016 --------- --------- ---------	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2.455.340 lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** 2,200,000 lekë	**7.Diferenca me fondin limit(pa tvsh)** 255,340lekë
8. Data e hapjes së tenderit 19.05.2016	**9.Burimi Financimit** Bashkia Tiranë	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tender Numër**3 OE** b)S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime **AK**-;**APP**–s'ka;**KPP-1** me shkresën nr. 1824 datë 08.06.2016	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK	**13.Përgjigje** Ankesës nga KKP me shkresën 582/1 datë 28.07.2016
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës 2443/3, datë 08.08.2016	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 2,640,000lekë	**16.Likuiduar deri dt. 29.12.2016 Lekë** 2,640,000 **lekë**
17-Situacioni Përfundimtar/ Faturë Malli/ Shërbimi nr. 81, datë 08.09.2016 **-Vlera me tvsh 2,640,000lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 30 ditë Zbatuar 30 ditë	**19.Zgjatja e kontratës me ditë**

-Vlera pa tvsh 2,200,000lekë		
22.Akt Kolaudimi datë.....	**23.Akt i marrjes në dorëzim** dt. 06.10.2016	**24**. Fletë Hyrja Nr. 34 datë06.10.2016 lekë

Nga auditimi rezultoi që:
Përllogaritja e vlerës së kontratës: Me shkresën nr. 1280 prot datë 17.04.2016 të titullarit të autoritetit kontraktor është ngritur grupi i specializur për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit "Blerje Çakulli". Grupi i specializuar me shkresën nr. prot s'ka, datë s'ka ka përcaktuar diametrin dhe sasinë e çakullit plus transport, të kërkuar bazuar në kërkesat dhe nevojat e DPN1 por, në dosje nuk ka dokumentacion mbi lindjen e nevojave për blerjen e këtij lloj malli, nuk ka preventiv nga drejtoria përkatëse, për të cilat në DT e shtojcën 10 është kërkuar sasia për rrugën sa vijon:

Lloji i materialit	Diametri	Sasia (mł)	Vendi
Çakëll	15-20 cm	2000	Landfilli- Sharrë

Gjithashtu nga ana e grupit të specializuar për hartimin specifikimeve teknike nuk është përcaktuar lloji i cakullit të kërkuar pasi nisur nga të dhënat e manualit të ndërtimeve nr. 1, "Prodhimi i materialeve te ndërtimit" të VKM nr. 568, datë 27.06.2013 (i cili ka qenë në fuqi në periudhën të cilën është zhvilluar tenderi)"Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", janë disa zëra të tillë dhe që kanë çmime të ndryshme si:

Nr.	Nr.an.	Emërtimi	Njësia	Cmimi
9	1.19/p	Prodhim çakëll për betone	m3	1485
10	1.19/1p	Prodhim çakëll makinerie	m3	1399
11	1.19/2p	Prodhim çakëll gurore	m3	489

Hartimi i dokumenteve të tenderit: Nga ana e NJHDT është mbajtur procesverbali datë 19.04.2016, për hartimin dhe miratimin e DT. Në këtë procesverbal objekti i prokurimit është caktuar "Blerje çakull" si dhe janë përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta për kualifikim. NJHDT në lidhje me përllogaritjen e vlerës së kontratës ka vendosur ti referohet çmimit të testimit të tregut, bazuar në tre oferta të ndryshme. Në bazë të përllogaritjes së tyre është vendosur vlera e fondit limit pa TVSH 2,455,340 lekë. NJHDT për llogaritjen e fondit limit duhej ti referohej çmimeve të miratuara nga institucionet shtetërore të përcaktuara në manualet e ndërtimit nr. 1 "Prodhimi i materialeve te ndërtimit" të VKM 568, datë 27.06.2013 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" për sa më sipër përllogaritja e fondit limit është bërë në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik": neni 57, "Njësia e prokurimit", në të cilën është përcaktuar se: "Njësia e prokurimit është përgjegjëse për: - përllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme".
Zhvillimi i procedurës së prokurimit: tenderi është hapur me procesverbalin datë 19.05.2016 dhe

kanë marrë pjesë këta OE:

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO procesverbal datë 02.04.15
1	--------- shpk	2,200,000	Kualifikuar e shpallur fitues
2	--------- shpk	2,308,000	Kualifikuar
3	--------- shpk	2,000,000	S`kualifikuar pasi nuk plotësonte numrin e makinerive

Në AK është paraqitur ankimim nga OE --------- shpk, nr.32, datë 16.04.2015, me argumentimin se bilanci i vitit 2015 ka afat dorëzimi deri më 31.03.2015 dhe konfirmimi merret mbas dorëzimit si dhe data e hapjes së tenderit është data 02.04.2015, duke mos krijuar mundësi kohore për dorzimin e tij.
Në lidhje me këtë ankimim janë ndjekur procedurat ligjore të LPP dhe OE i është kthyer përgjigje me shkresën nr.582/2016 prot, datë 28.07.2017 të Komisionit të Prokurimit Publik, me anë të së cilës sqarohet se ankimi i bërë nuk është marrë në konsideratë.
Ky OE i është drejtuar KPP, e cila me shkresën nr. 582/2016 datë 28.07.2015, nuk e ka pranuar ankesën.KVO ka kualifikuar të parin OE --------- shpk me vlerë të ofertës 2,200,000 lekë pa tvsh.
Lidhja e kontratës: Kontrata nr. 2445/3, datë 08.08.2016, është lidhur në shumën 2,200,000 lekë pa tvsh me cmim total 2,640,000 lekë me afat kohor 30 ditë nga lidhja e saj.
Likuidimi i kontratës: është bërë me urdhër shpenzimin nr. 202, datë 29.12.2016, në shumën 2,640,000 lekë dhe brenda afatit kohor sipas faturave tatimore të shitësit sa vijon:

Nr.	Faturë numër datë	Sasi m3	Çmim lekë/ m3 pa tvsh	Shuma pa tvsh
1	nr. 81, datë 08.09.2016	2000	1,100	2,200,000

Marrë në dorëzim me fletëhyrjen nr. 34 date 08.09.2016

2) Nga ana e Njësisë së prokurimit nuk janë zbatuar përcaktimet e bëra në nenet 3 e 29 të"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", përsa i përket inventarizimit të dosjes së prokurimit.
Referuar nenit 3 e 29 të"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".
Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
Nga ana e njësisë së përcaktimit të specifikimeve teknike nuk janë dhënë argumenta për përcaktimin e tyre si dhe nuk është specifikuar lloji i çakullit bazuar në manualet e ndërtimit të miratuara nga institucionet shtetërore.
Nga njësia e prokurimit është përzgjedhur metoda e përllogaritjes se vlerës së kontratës nga testimi i tregut dhe jo manuali i çmimeve të miratuara nga institucionet përkatëse.
Dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar sipas legjislacionit në fuqi.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në: Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar. VKM 568, datë 27.06.2013 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre. Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Z. [redacted] me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Hartimit të Dokumetave të Tenderit, Znj. --------- me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Hartimit të Dokumetave të Tenderit. Znj. --------- me detyrë ish/ specialist e prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Hartimit të Dokumetave të Tenderit, Z. --------- me detyrë drejtor pranë D.T.M.L.R, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Hartimit të Specifikimeve Teknike, Z. --------- me detyrë përgjegjës pranë D.T.M.L.R, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Hartimit të Specifikimeve Teknike, Z. --------- me detyrë specialist pranë D.T.M.L.R, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Hartimit të Specifikimeve Teknike.

Në tenderin elektronik të zhvilluar me objekt "*Blerje Kosha Për Diferencim"*, me të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Tiranë, ku ka marrë pjesë në konkurrim 1 operator ekonomik, e me të dhëna të tjera:

Urdhër prokurimi nr.2038/2, datë24.06.2016.	**Njësia e prokurimit me urdhrin nr. 2038/2 datë24.06.2016**	**KVO , me urdhër nr.2038/3, datë24.06.2016** Komisioni i marrjes në dorzim të mallit me urdhrin nr.2038/11, date 09.08.2016
Fondi limit 19,993,666 lekë		
Procedura e prokurimit – procedurë e hapur		
Burimi I Financimit: Bashkia Tiranë	Fitues [redacted]	Vlera fituese 19,980,000 lekë pa tvsh,
Datë e hapjes së tenderit21.07.2016	Diferenca nga fondilimit36.000lekë.	Kontrata nr. 2038/8, datë 09.08.2016
Marrin pjesë1OE S`kualifikuar0 OE	Njësia e përllogaritjes së fondit limit --------- Gerisa Keti --------- ---------	Vlera e kontratës 23,976,000lekë metvsh
Ankimime në AK-0 Ankimime në KPP-0	Afati Ikontratës nga data e lidhjes së kontratës me afat levrimi 30 ditë.	Titullari AK ndryshuar me urdhrinNr. 1690 Prot, datë27.05.2016–

Nga auditimi rezultoi që me urdhrin nr.2038 prot, datë 24.06.2016 është ngritur një grup i specializuar teknik për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt Kosha për Diferencim.

Me shkresën nr.2038/1 datë 24.06.2016 është kërkuar nga Drejtoria e Planifikimeve, Mirëmbajtjes dhe Shërbimeve kryerja e prokurimit me objekt "Kërkesë për Kosha për diferencim". Vlera e fondit limit është përllogaritur në bazë të testimit të tregut nga komisioni i përllogaritjes së vlerës limit të kontratave i cili është ngritur në bazë të urdhrit nr. 401/1 datë 11.02.2016.
Ky komision për përcaktimin e vlerës së fondit limit ka marr oferta financiare edhe nga operatorë të cilët nuk e kanë patur si objekt të aktivitetit të tyre llojin e objektit të kërkuar për t'u prokuruar, për pasojë vlera e fondit limit nuk mund të jetë përllogaritur saktë.
Nga ana e Njësisë së prokurimit nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përsa i përket vendosjes të disa kritereve të cilat ndikojnë negativisht në pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomik.
Referuar nenit 46, pika 3, të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në të përcaktohet që:

Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

Referuar nenit 23, pika 1, të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në të përcaktohet që:

Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Nga auditimi rezultoi që:
Me shkresën nr.2038/2 datë 24.06.2016 është nxjerrë urdhri i prokurimit me objekt prokurimi blerje kosha per diferencim, me vlerë kontrate 19,993,666 lekë me llojin e procedurës së hapur dhe me njësi prokurimi përgjegjëse për hartimin e dokumenteve të tenderit. Njësia e Prokurimit për hartimin e dokumentacionit të tenderit ka mbajt procesverbalin përkatës në të cilin janë miratuan kërkesat për kualifikim, afati i lëvrimit dhe është vendosur kriteri i vlersimit duke u nisur nga çmimi më i ulët. Disa nga kriteret e vendosura për këtë procedurë prokurimi, duke e lidhur këtë kriter edhe me sa trajtuar më sipër, grupi i auditimit i konsideron të panevojshme për përmbushjen e kontratës, duke shërbyer më së shumti për shmangien dhe largimin e ofertuesve, dhe jo për qëllimin apo frymën kryesore të prokurimit publik, atë të nxitjes së pjesëmarrjes së gjerë të operatorëve ekonomikë. Saktësisht:

- Çertifikatë ISO i menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë (OHSAS 18001-2007)
- Për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi, ofertuese duhet të ketë të përfshirë në listpagesa dhe në licensën e shoqërisë : inxhinier mekanik

- Dëshmitë aftësisë profesionale ose leje manovrimi për punonjësit që do të përdorin makinëritë e rënda që nevojiten për ekzekutimin e kontratës lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës së vlefshme, minimumi 1 automakinista, të shoqeruar me kontratat e punës dhe te jenë të rregjistruar në kompaninë e tij.
- Një punësim mesatar I të paktën 25 personave, për periudhën janar 2013- shkurt 2016
- Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:
- Autovinç, saldatriçe, kamionçinë vetëshkarkuese, makineri e lëvizshme me paisje speciale për testimin e materialeve të ndërtimit.

Në këtë procedurë ka marrë pjesë një operatorë ekonomik konkretisht [redacted]. Pas hapjes së ofertave të paraqitura është realizuar regjistrimi i tyre në proçesverbalin e hapjes dhe është kaluar në fazën e vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave i cili është ngritur me shkresën 2038/3 datë 24.06.2016. Operatori [redacted] shpk me NIPT J 61922018 S, me çmim total të ofertës pa tvsh 19,980,000 lekë dhe 23,976,000 lekë me tvsh i plotëson kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, si dhe nuk ka gabime aritmetike përsa i përketllogaritjes së vlerës së ofertës.Nga kjo shoqëri nuk ka pasur tërheqje apo modifikim ofertash duke qenë se oferta e operatorit ekonomik [redacted]ka qenë në përputhje me kërkesat e tenderit, është shpallur si ofertë e vlefshme. Me shkresën nr. 2038/5 datë29.07.2016 është mbajtur raporti përmbledhës nga KVO dhe me shkresën nr. 2038/6 datë 01.08.2016 është miratuar raporti përmbledhës i tenderit nga autoriteti kontraktor

Me shkresën nr.2038/7 datë 01.08.2016 është formulari i njoftimit të fituesit
Lidhur me këtë procedurë prokurimi nuk ka patur ankesa nga operatore të tjerë ekonomik.
Me shkresën nr. 2038/8 datë 09.08.2016 është lidhur kontrata e furnizimit ndërmjet autoritetit kontraktor dhe administratorit të shoqërisë --------- shpk
Me shkresën nr.2038/9 datë 09.08.2016 është bërë njoftimi i kontratës
Me shkresën nr. 2038/10 datë 09.08.2016 është dërguar njoftimi i kontratës në app
Me shkresën nr. 2038/11 datë 09.08.2016 është ngritur komisioni i marrjesnë dorzim të mallit i cili në datë 22.08.2016 ka mbajtur procesverbalin e pjesshëm të marrjes në dorëzim dhe më pas malli është bërë hyrje në magazinë me fletehyrjen me nr.15 datë 22.08.2016
Në datë 08.09.2016 komisioni ka mbajtur procesverbalin e marrjes në dorzim të pjesshëm sipas faturës 128 datë 08.09.2016 likujduar me urdhër shpenzimin nr.174 datë 23.11.2016 për shumën 12,168,000 lekë dhe nr.173 datë 23.11.2016 me fletëhyrjen në magazinë nr. 1119 datë 22.08.2016.
Nga ana e Njësisë së prokurimit nuk janë zbatuar përcaktimet e bëra në nenet 3 e 29 të"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", përsa i përket inventarizimit të dosjes së prokurimit.
Referuar nenit 3 e 29 të"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".
Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Njësia e përllogaritjes së vlerës së fondit limit gjatë testimit të tregut ka pranuar oferta financiare edhe nga operatorë të cilët nuk e kanë në objekt të aktivitetit të tyre objektin e procedurës së prokurimit.
Nga ana e njësisë së prokurimit nuk janë dhënë argumenta për përcaktimin e kritereve të kualifikimit.
Nga ana e njësisë së prokurimit janë caktuar kritere kualifikimi të vlerësuara të panevojshme nga grupi i auditimit, veprim i cili ndikon negativisht në pjesëmarrjen masive të operatorëve ekonomikë.
Dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar sipas legjislacionit në fuqi.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të përcaktuara në:
Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat"
Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Në tenderin elektronik të zhvilluar me objekt "*Për Blerje Elektropompa, pompa, (centrifugale, zhytës, sperkatëse, uji)"*, me të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Tiranë, ku kanë marrë pjesë në konkurrim 3 operator ekonomik, e me të dhëna të tjera:

1) a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Blerje elekropompa, pompa, (centrifugale, zhytëse, spërkatëse, uji)		
1.Urdhër Prokurimi Nr 1442/2 Datë 13.05.2016	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr.1442/2, dt.13.02.2016	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 1442/3 dt. 13.05.2016
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit **"Kërkesë për propozim"**	**Njësia e hartimit te specifikimeve teknike** **Urdhër Nr. 1442 datë 03.05.2016**	
Fondi Limit (pa tvsh) 3,750,000 lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** 3,714,000 lekë	**7.Diferenca me fondin limit(pa tvsh)**36,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 26.05.2016	**9.Burimi Financimit** Buxheti i Bashkisë Tiranë	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tender 2 **OE** b)S'kualifikuar1 OE, c) Kualifikuar1 OE "[redacted]"
11.Ankimime **AK**-s'ka;**APP**–s'ka;**KPP**-s'ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK s' ka	**13.Përgjigje** Ankesës ngaAPPapo AKKP - s ka
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 1838/Datë 09.06.2016	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)4,456,800** lekë	**16.Likuiduar deri dt. 12.10.2016Lekë 4,456,800** **Pa likuiduarderi dt.....Lekë.....**
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimidt 23.06.2016	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 30 ditë.Zbatuar 14 ditë	**19.Zgjatja e kontratësme..... ditë** Shkresa(Amendamenti) nr..... dt.....

-Vlerame tvsh 4,456,800 lekë **-Vlera pa tvsh 3,714,000 lekë**		
22.Akt Kolaudimidatë.....	**23.Akt i marrjes në dorëzim** dt. 23.06.2016	**24**. Fletë HyrjaNr. 9 datë 23.06.2016 lekë

Nga auditimi rezultoi se:
Nga verifikimi i specifikimeve teknike të dorëzuara për pajisjet e ofruara nga operatori ekonomik "Climacasa" i cili është shpallur fitues, rezultojnë se nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Për sa më sipër, në kushtet kur asnjë nga OE nuk i përmbush specifikimet teknike, tenderi duhet të anulohej.
Me shkresën me nr. 1442/1 Prot date 03.05.2016 drejtuar Drejtorit të Pergjithshëm është bërë kërkesë nga drejtoria e menaxhimeve, planifikimit dhe sherbimeve, për hapjen e procedurave te prokurimit publik ne mënyrë elektronike me fond limit 3,750,000 leke pa TVSH. Vlera e fondit limit është përcaktuar nga mesatarja e tre ofertave të marra paraprakisht nga katër anëtare të komisionit të përllogaritjes së vlerës limit të kontratave [redacted], referuar urdhërit nr. 401/1 datë 11.02.2016. Me urdhrin nr. 1442 prot datë 03.05.2016 janë caktuar specialistët për hartimin dhe përgatitjen e specifikimeve teknike të cilët, të cilët kanë përpiluar tabelën me llojin dhe sasinë e mallit që kërkohet. Kërkesa për hapjen e procedurave të prokurimit është bërë me shkresën nr. 1442/1 datë 03.05.2016, në të cilën specifikohet vlera e fondit limit dhe periudha e kontratës.
Me urdhrin nr.1442/2 datë 13.05.2016 është ngritur njësia e prokurimit për këtë procedurë me antarë [redacted]specialist pranë sektorit të prokurimeve, [redacted]specialist pranë sektorit të prokurimeve dhe [redacted]specialiste pranë sektorit juridik.Procedura e përzgjedhur për këtë rast nga autoriteti kontraktor është "Kërkesë për Propozim" me arsyetimin se vlera e kontratës është nën kufirin e ulët monetar. Komisioni i vlersimit të ofertave është ngritur me shkresen 1442/3 datë 13.05.2016 i përbërë nga [redacted]anëtare, [redacted]anëtare. Për këtë procedurë janë ftuar të marrin pjesë 5 operatorë ekonomik [redacted]por, nga ana e autoritetit kontraktorë nuk kemi argumentim në përzgjedhjen e operatorëve ekonomik të ftuar, në kundërshtim me nenin 39 pika 4 të VKM 914 datë 29.12.2014 " Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku citohet : " Pavarësisht nga publikimi i njoftimit të kontratës, sipas pikës 2, të këtij neni, autoriteti kontraktor fton për të marrë pjesë dhe të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomik që do të ftojë".
Tenderi është shpallur në datën 17.05.2016 dhe afati i dorzimit të ofertave është data 26.05.2016. në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomik [redacted] sh.p.kdhe [redacted]
Ofertat e tyre ekonomike janë si më poshtë:

1. [redacted] sh.p.k **3 714 000** (tremilioneshtatëqindekatërmbëdhjetëmijë) **lekë pa tvsh dhe 4 456 800 (**katërmilionekatërqindepesëdhjetëegjashtëmijëetetëqind) **lekë me tvsh**.
2. [redacted]sh.p.k **3.690.000**(tremilionegjashtëqindenëntëdhjetmijë) **lekë pa tvsh dhe 4.428.000 (**katërmilionekatërqindenjëzetetetëmijë) **lekë me tvsh**.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomik u konstatua se :
Operatori ekonomik "R&R Group sh.p.k"është skualifikuar për arsye se nuk ka paraqitur certifikata ISO të certifikuara si dhe katalogun e se cilit prodhues i përkasin elektropompat e kërkuara.

Operatori ekonomik "Climacasa" është shpallur fitues por, nga auditimi në sitemin elektonik si dhe në dosjen e dokumentave të dorzuar nga subjekti rezulton se nuk përputhen katalogët e modeleve te pompave me modelet e pompave të propozuara nga subjekti me specifikimet teknike të miratuara dhe kërkuara nga autoriteti kontraktor. Për sa më sipër, në kushtet kur asnjë nga OE nuk i përmbush specifikimet teknike, tenderi duhet te anullohej dhe të ribëhej nga e para duke rishikuar dhe ndryshuar dokumentet e tenderit.
Raporti përmbledhës është me nr.1442/5 datë 08.06.2016 ndërsa me shkresën nr. 1442/6 datë 08.06.2016 është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor. Kontrata e furnizimit është nënshkruar në datë 09.06.2016 me nr. 1838 prot me afat lëvrimi të mallit 30 ditë.Me shkresën nr. 1838/3 datë 09.06.2016 është nxjerrë urdhri për ndjekjen e zbatimit të detyrimeve të kontratës së furnizimit me komision të marrjes në dorzim të përbërë nga [redacted]. Ky komision në datë 23.06.2016 ka nënshkruar procesverbalin e dorzimit të mallit ku sasia dhe emërtimi i mallit është i njëjtë me atë të përcaktuar në dokumentet standarte të tenderit, fakt i cili ngre dyshime mbi vërtetësinë e këtij akt-kolaudimi përsa kohë operatori ekonomik nuk i ka paraqitur katalogët për modelet e kërkuara.
Malli është bërë hyrje në magazine me flete hyrjen nr.9 datë 23.06.2016. Likujdimi i subjektit është bërë më faturën tatimore nr.30 datë 23.06.2016.
Njësia e prokurimit nuk ka zbatuar përcaktimet e bëra në nenet 3 e 29 të"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", përsa i përket inventarizimit të dosjes së prokurimit. Referuar nenit 3 e 29 të"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat",
Sa më sipër arrihet në konkluzionin që nga ana e autoritetit kontraktor nuk është argumentuar përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të ftuar për ofertë, operatori i shpallur fitues nga komisioni i vlrësimit të ofertave nuk i ka plotësuar specifikimet teknike të kërkuara në DST, për pasojë duhet të ishte skualifikuar dhe procedura duhet të ishte anulluar, dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar sipas legjislacionit në fuqi.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".
Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen mepërgjegjës Znj. [redacted]me detyrë ish-specialiste (nuk ndodhet më në punë) në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, Znj. [redacted]me detyrë specialiste në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, Z. [redacted]me detyrë përgjegës në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, Znj. [redacted]me detyrë Drejtor Drejtorie në cilësinë e anëtares së komisionit të vlerësimit të ofertave, Z. [redacted]me detyrë Përgjegjëse sektori në cilësinë e anëtares së komisionit të vlerësimit të ofertave, Z. [redacted]me detyrë ish-shefe sektori (larguar nga puna) në cilësinë e anëtares së komisionit të vlerësimit të ofertave.

Në tenderin elektronik të zhvilluar me objekt "Blerje Drure dhe shkurre dekorative*"*, me të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Tiranë, ku kanë marrë pjesë në konkurrim 3 operator ekonomik, e me të dhëna të tjera;

1) a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :		
1.Urdhër Prokurimi Nr 424/2, datë 25.02.2016. **Miratimi i procedurës nr.67, datë 19.05.2015.**	3. Njësia e prokurimit me urdhrin nr. 401/1 datë 11.02.2016	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave**, me urdhër nr.424/3, datë 25.02.2016
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit **"**procedure e hapur"		
Fondi Limit 25.000.000 lekë **(pa tvsh)**	**6.Oferta fituese 23,459,000 lekë (pa tvsh)** Fitues [redacted] shpk. n	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)184,660 lekë.**
8. Data e hapjes së tenderit 01.06.2016	**9.Burimi Financimit** Buxheti i Bashkisë Tiranë	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tender 3 **OE** b)S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar OE
11.Ankimime **AK**-1; **APP**–s'ka;**KPP**-s'ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK **shkresa nr. 909/1 datë 09.03.2016**	**13.Përgjigje** Ankesës nga APPapo AKKP - s ka
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës **Nr. 1192/2 datë 14.04.2016**	**15. Vlera e kontratës (me tvsh) 23,459,000 lekë pa tvsh**	**16. Likuiduar deri dt. 12.10.2016** **Pa likuiduar deri dt.....Lekë.....**
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë **Malli/Shërbimi dt 23.06.2016** **-Vlera me tvsh** **-Vlera pa tvshlekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Afati kontratësbrenda 30 diteve kalendarike nga dita që janë pranuar mallrat ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë **.**	**19.Zgjatja e kontratës me..... ditë** Shkresa(Amendamenti) nr..... dt
22.Akt Kolaudimidatë.....	**23**.**Akt i marrjes në dorëzim** dt.	**24**.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për këtë procedurë prokurimi konstatohet se me shkresën Nr.424/2 Prot, dt.25.02.2016 është nxjerr urdhëri i prokurimit nga ana e titullarit tëautoritetit kontraktor me vlerën e fondit limit 25,000,000 lekë me objekt blerje drurë dhe shkurre dekorative dhe me llojin e procedurës e "HAPUR". Nga ana e Njësisë së prokurimit nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përsa i përket vendosjes të disa kritereve të cilat ndikojnë negativisht në pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomik. Konkretisht : Kërkesa për 20 punonjës për vitet 2014-2015 konsiderohet e tepërt për një kontratë blerje malli. Proçedurat e ndjekura nga Komisioni i Vlersimit të Ofertave janë si më poshtë: Komisioni I Vlerësimit të Ofertave I përbërë prej tre anëtarësh: Z.[redacted] pas hapjes së ofertve të paraqitura dhe kalimit në fazën e vlersimit të tyre është bë vlerësimi i tyre si më poshtë: Në këtë prokurim kanë paraqitur ofertat e tyre tre OE [redacted] Oferta e paraqitur nga ofertuesi [redacted] Sh.p.k me çmim total të ofertës pa tvsh23,459,000 (njëzet e tre milion e katërqind e pesëdhjetë e nëntë miijë) lekë dhe me çmim

total të ofertës me tvsh 28,150,800 (njëzet e tetë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë e tetëqind) lekë, i plotëson kërkesat e përgjithshme përkualifikim, i plotëson kriteret e veçanta të përcaktuara në DST, përsa I përket llogaritjes së vlerës së ofertës nuk ka gabime aritmetike. Komisioni i Vlersimit të Ofertave ka konstatuar se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlerë, duke e shpallur si ofertë të vlefshme. Oferta e paraqitur nga ofertuesi [redacted] nuk i plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim, nuk i plotëson kriteret e veçanta të përcaktuar anë DST si dhe nuk ka dorëzuar formularin e ofertës. Për këtë arsye kjo ofertë është skualifikuar. Nga vlerësimi i ofertës së paraqitur nga [redacted] ka rezultuar se ky OE nuk i ka plotësuar kërkesat e përgjithshme përkualifikim, nuk i plotëson kriteret e veçanta të përcaktuara në DST, për këto arsye nga KVO kjo ofertë është shpallur e pavlefshme duke e skualifikuar KVO në vlersimin dhe klasifikimin e saj përfundimtarë ka klasifikuar në vend të parë ofertën e paraqitur nga OE . [redacted] shpk. Lidhur me këtë procedurë operatori RETO ka paraqitur ankesë në datë 07.03.2016 me nr. 116 prot.Nga autoriteti kontraktor për shqyrtimin e kësaj ankese është ngritur komisioni për shqyrtimin e ankesave me nr. 909/2 datë 09.03.2016 i cili i ka kthyer përgjigje subjektit në po të njëjtën date duke për ta ridërguar ankesën e tyre sipas kërkesave ligjore duke respektuar edhe afatin përkatës për të qenë një ankesë e vlefshme. Edhe për këtë procedurë nga njësia eprokurimit nuk janë zbatuar përcaktimet e bëra në nenet 3 e 29 të"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", përsa i përket inventarizimit të dosjes së prokurimit.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se:Nga ana e njësisë së prokurimit nuk janë dhënë argumenta për përcaktimin e kritereve të kualifikimit. Nga ana e njësisë së prokurimit janë caktuar kritere kualifikimi të vlerësuara të panevojshme nga grupi i auditimit. Dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar sipas legjislacionit në fuqi.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "për prokurimin publik ", i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Ligji nr. 9154 datë 06.11.2003, "për arkivat", norma tekniko profesionale dhe metodologjise të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjeëgjësi : znj. . [redacted] me detyrë ish-specialiste (larguar nga puna) në cilësinë e anëtares së njësisësë prokurimi, znj. . [redacted] me detyrë specialiste në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, z. . [redacted] me detyrë përgjegjës në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit.

Në tenderin elektronik të zhvilluar me objekt "*"Blerje karburanti Diezel D1 dhe Benzinë për mjete e DPN"*, me të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Tiranë, ku kanë marrë pjesë në konkurrim 3 operator ekonomik, e me të dhëna të tjera:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Blerje karburanti Diezel D1 dhe Benzinë për mjete e DPN"

1.Urdhër Prokurimi **Nr.1055/1 prot, datë 23.03.2016** **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** **"Procedurë e Hapur"**	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr. 1055/1, dt. 23.03.2016	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 1055/2 dt. 23.03.2016
5.Fondi Limit (pa tvsh) 34,145,010.4 lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** 34,145,010.4 lekë	**7.Diferenca me fondin limit(pa tvsh)** 0lekë
8. Data e hapjes së tenderit 18.04.2016	**9.Burimi Financimit** Bashkia Tiranë	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tender Numër **3 OE** b)S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime **AK**-ska; **APP**–s'ka; **KPP**-s'ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK Ska	**13.Përgjigje** Ankesës ngaAPPapo AKKP ska
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 1055/6 Datë 13.05.2016	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 40,974,012.48 lekë	**16.Likuiduar deri dt.23.11.2016 Lekë 40,974,012.48** **Pa likuiduarderi dt.....Lekë.....**
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimidt 23.11.2016 **-Vlera me tvsh 6,366,290 lekë** **-Vlera pa tvsh 5,305,242 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 232 ditë Zbatuar122 ditë	**19.Zgjatja e kontratësme..... ditë** Shkresa(Amendamenti) nr..... dt.....
22.Akt Kolaudimidatë.....	**23.Akt i marrjes në dorëzim** dt. 13.09.2016	**24**. Fletë HyrjaNr 35 datë 6,366,290 lekë

Nga auditimi rezultoi se:

Disa nga kriteret e vendosura për këtë procedurë prokurimi, duke e lidhur këtë kriter edhe me sa trajtuar më sipër, grupi i auditimit i konsideron të panevojshme për përmbushjen e kontratës, duke shërbyer më së shumti për shmëngien dhe largimin e ofertuesve, dhe jo për qëllimin apo frymën kryesore të prokurimit publik, atë të nxitjes së pjesëmarrjes së gjerë të operatorëve ekonomikë. Saktësisht:

"Ofertuesi duhet të ketë të siguruar minimumi 40 punonjës të siguruar per Janar-Dhjetor 2015, Janar 2016 vertetuar nga tatim taksat, shoqëruar me Listë pagesat dhe FDP përkatëse".

Nga ana e DPN1, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përsa i përket shtesave të kontratave me 20%.

Referuar nenit 33 pika 5/a të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në të përcaktohet se:

Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit, mund të përdoret për kontratat e punëve dhe të shërbimeve:
a) për punë apo shërbime shtesë, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në kontratën fillestare, por që, për shkak të rrethanave të paparashikuara, janë bërë të domosdoshme, me kusht që t'i jepen

operatorit ekonomik, që realizon këto ndërtime apo shërbime, si dhe kur vlera e punës dhe/ose shërbimeve shtesë nuk e tejkalon 20 për qind të vlerës së kontratës fillestare.

Duke u bazuar në rregjistrin e realizimeve të prokurimeve për vitin 2016 konstatohet se janë kryer 6 procedura prokurimi për blerje karburanti me vlerë totale 86,194,615.08 lekë. Më poshtë listohen:

Në Lekë

Data	Vlera (me TVSH)	Lloji i procedurës
18.04.2016	40,974,012.48	E hapur
11.07.2016	15,000,000	E hapur
01.12.2016	3,000,000	Shtesë kontrate 20%
30.12.2016	8,194,802	Shtesë kontrate 20%
05.01.2016	8,823,859	Shtesë kontrate 20%
01.03.2016	10,201,942	Negocim pa shpallje
TOTAL	86,194,615.08	

Nga sa më sipër konstatohet:
- Fondi për blerjen e karburantit është copëzuar gjatë vitit, veprim në kundërshtim me nenin 28.2 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Ky veprim ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në uljen e efiçensës në përdorimin e këtyre fondeve.
- Fakti se ka qënë e nevojshme të kryhen 6 procedura prokurimi për të njëjtin objekt, tregon se kemi një parashikim mjaft të dobët nga ana e DPN1 për përdorimin vjetor të karburantit.
- Për vitin 2016 janë kryer 3 procedura shtesë kontrate 20%, veprim në kundërshtim me ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Shtesa e kontratës me negocim pa shpallje kryhet në raste specifike të cilat përmenden në ligjin e prokurimit publik, dhe gjithsesi përdoret jo më shumë se një herë.

Nga ana e Njësisë së prokurimit nuk janë zbatuar përcaktimet e bëra në nenet 3 e 29 të"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", përsa i përket inventarizimit të dosjes së prokurimit.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Nga ana e njësisë së prokurimit nuk janë dhënë argumenta për përcaktimin e kritereve të kualifikimit.

Nga ana e njësisë së prokurimit janë caktuar kritere kualifikimi të vlerësuara të panevojshme nga grupi i auditimit, veprim i cili ndikon negativisht në pjesëmarrjen masive të operatorëve ekonomikë.

Autoriteti kontraktor ka zhvilluar disa procedura për blerjen e karburantit për vitin 2016, veprim i cili tregon për një parashikim mjaft të dobët të këtij institucioni. Gjithashtu janë kryer disa procedura shtesë prej 20%, veprim i cili nuk gjen mbështetje ligjore.

Dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar sipas legjislacionit në fuqi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETQEVERISJES VENDORE
Raport Përfundimtarë Auditimi për subjektin, "Drejtoria E Punëtorëve Të Qytetit Nr. 1", Bashkia Tiranë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen mepërgjegjësi Z. . [redacted] me detyrë Drejtor Finance në cilësinë e personit të autorizuar nga titullari për ta përfaqësuar në procedurat e prokurimit, Znj. . [redacted] me detyrë ish-specialiste (nuk ndodhet më në punë) në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit. Znj. . [redacted] me detyrë specialiste në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit. Z. . [redacted] me detyrë përgjegës në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit.

Në tenderin elektronik të zhvilluar me objekt "*Blerje Plehra Kimike, Farëra, bari, Fidane,etj"*, me të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Tiranë, ku kanë marrë pjesë në konkurrim 3 operator ekonomik, e me të dhëna të tjera;

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Blerje Plehra Kimike, Farëra, bari, Fidane,etj..."		
1.Urdhër Prokurimi Nr.1119/2 prot, datë 01.04.2016 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Procedurë e Hapur"**	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr. 1119/2, dt. 01.04.2016	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 2507/3dt. 08.08.2016
5.Fondi Limit (pa tvsh) 11,909,100lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** 10,833,350 lekë	**7.Diferenca me fondin limit(pa tvsh)** 1,075,750lekë
8. Data e hapjes së tenderit 27.04.2016	**9.Burimi Financimit** Bashkia Tiranë	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tender Numër **3 OE** b)S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime **AK**-OE . [redacted] ka paraqitur ankesë me nr 1498 prot datë 09.05.2016; **APP**–s'ka;**KPP-**s'ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK Përgjigje me nr 1498/1 datë 11.05.2016	**13.Përgjigje** Ankesës ngaAPPapo AKKP ska
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 1903 Datë 15.06.2016	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 13,000,020lekë	**16.Likuiduar deri dt.12.10.2016 Lekë 13,000,020** **Pa likuiduarderi dt.....Lekë.....**
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimidt. 14.07.2016 -Vlerame tvsh 13,000,020 lekë -Vlera pa tvsh 10,833,350 lekë	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 30 ditë Zbatuar29 ditë	**19.Zgjatja e kontratësme..... ditë** Shkresa(Amendamenti) nr..... dt.....

20. **Mbikëqyrësi i punimeve** EmriMbiemri.....	Licenca Nr.....	Kontrata Nr.....Prot.....datë.....lekë	Likuiduar .....lekë)	Pa likuiduar .....lekë)
21. **Kolaudatori i punimeve** EmriMbiemri.....	Licenca Nr	Nr.....Prot.....datë.....	Likuiduar(lekë)	Pa likuiduar (lekë)
22.Akt Kolaudimidatë.....	**23**.**Akt i marrjes në dorëzim** dt. 14.07.2016		**24**. Fletë HyrjaNr.11 datë 14.07.2016 13,000,020 lekë	

Nga auditimi rezultoi se:
Nga ana e Njësisë së prokurimit nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përsa i përket argumentimit të kritereve të përckatuara për kualifikim.
Referuar nenit 61 pika 2 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në të përcaktohet se:

"Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre."

Nuk janë dhënë shpjegime apo arsyetime në lidhje me kriteret e përzgjedhura për kualifikim, veprim në kundërshtim me nenin 61 pika 2 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Çdo kriter duhet të vendoset bazuar në një logjikë po arsyetim, dhe të shërbejë për përzgjedhjen e operatorit ekonomik i cili ka kualifikimet e nevojshme për të zbatuar në mënyrën më të mirë kontratën. Në kriteret e vendosura në këtë procedurë prokurimi nuk janë dhënë arsyetime.
Nga ana e Njësisë së prokurimit nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përsa i përket vendosjes të disa kritereve të cilat ndikojnë negativisht në pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomik.
Referuar nenit 46, pika 3, të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në të përcaktohet se:

Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

Referuar nenit 23, pika 1, të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në të përcaktohet që:

Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Disa nga kriteret e vendosura për këtë procedurë prokurimi, duke e lidhur këtë kriter edhe me sa trajtuar më sipër, grupi i auditimit i konsideron të panevojshme për përmbushjen e kontratës, duke shërbyer më së shumti për shmëngien dhe largimin e ofertuesve, dhe jo për qëllimin apo

frymën kryesore të prokurimit publik, atë të nxitjes së pjesëmarrjes së gjerë të operatorëve ekonomikë. Saktësisht:

- Një punësim mesatar i të paktën 15 (njëzetë) personave, për periudhën Janar 2014- Dhjetor 2015. Duke qënë se kjo është një kontratë furnizimi, ky kriter vlerësohet si i panevojshëm nga grupi i auditimit.
- Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës. Operatori të paraqesë një deklaratë sipas shtojcës Nr.9. Nr.Pershkrimi, Sasia: Kamionçine 1; Kamionçine me vinç 1; Kamion (me kapacitet mbajtes mbi 4 Ton).

Nga ana e DPN1, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përsa i përket shtesës së kontratës me 20%.

Referuar nenit 33 pika 5/a të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në të përcaktohet që:

Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit, mund të përdoret për kontratat e punëve dhe të shërbimeve:
a) për punë apo shërbime shtesë, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në kontratën fillestare, por që, për shkak të rrethanave të paparashikuara, janë bërë të domosdoshme, me kusht që t'i jepen operatorit ekonomik, që realizon këto ndërtime apo shërbime, si dhe kur vlera e punës dhe/ose shërbimeve shtesë nuk e tejkalon 20 për qind të vlerës së kontratës fillestare.

Me anë të shkresës Nr. 24/05/1 Prot datë 29.07.2016 të Drejtorit të Zhvillimit Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit, është kërkuar blerje shtesë për disa lule sezonale për ambjente të ndryshme të qytetit, të ndryshme nga ambjentet për të cilat është kryer procedura e parë e prokurimit. Më pas me shkresën Nr. 2765 Prot datë 07.09.2016 të personit të autorizuar nga titullari, ---------, është miratuar aplikimi i shtesës prej 20 % të procedurës së trajtuar më sipër. Për këtë shtesë nuk ka asnjë argumentim, dhe nga grupi i auditimit konsiderohet e parregullt, pasi ky veprim është në kundërshtim me nenin nenit 33 pika 5/a të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Gjithashtu konstatohet se në preventiv janë shënuar thjesht "Lule sezonale", pa u përcaktuar saktësisht lloji i luleve duke e lënë evaziv përzgjedhjen e tyre.

Nga ana e Njësisë së prokurimit nuk janë zbatuar përcaktimet e bëra në nenet 3 e 29 të"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", përsa i përket inventarizimit të dosjes së prokurimit.

Dosja nuk është inventarizuar dhe arkivuar.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Nga ana e njësisë së prokurimit nuk janë dhënë argumenta për përcaktimin e kritereve të kualifikimit.

Nga ana e njësisë së prokurimit janë caktuar kritere kualifikimi të vlerësuara të panevojshme nga grupi i auditimit, veprim i cili ndikon negativisht në pjesëmarrjen masive të operatorëve ekonomikë.

Autoriteti kontraktor ka zhvilluar një procedurë shtesë kontrate prej 20% të vlerës, rast i cili nu është në përputhje më kriteret ligjor për implementimin e kësaj procedure.

Dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar sipas legjislacionit në fuqi.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në: Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen mepërgjegjësi Z. [redacted] me detyrë Drejtor Finance në cilësinë e personit të autorizuar nga titullari për ta përfaqësuar në procedurat e prokurimit, Znj. . [redacted] me detyrë ish-specialiste (nuk ndodhet më në punë) në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, Znj. . [redacted] me detyrë specialiste në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, Z. . [redacted] me detyrë përgjegës në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit.

Në tenderin elektronik të zhvilluar me objekt "*Blerje Vaj dhe Filtra****"***, me të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Tiranë, ku kanë marrë pjesë në konkurrim 4 operator ekonomik, e me të dhëna të tjera;

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Blerje Vaj dhe Filtra"		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 2507/2 prot, datë 08.08.2016 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** **"Kërkesë Propopozim"**	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr. 2507/2, dt. 08.08.2016	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 2507/3dt. 08.08.2016
5.Fondi Limit (pa tvsh) 6,444,790 lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** 6,395,990 lekë	**7.Diferenca me fondin limit(pa tvsh)** 48,800 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 29.08.2016	**9.Burimi Financimit** Bashkia Tiranë	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tender Numër **4 OE** b)S'kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime **AK**-1------ sha nr. 2560 prot datë 15.08.2016 2------- sha nr. 2562 prot datë 15.08.2016 3.---------nr. 2563 prot datë 15.08.2016 ;**APP**–s'ka;**KPP**-s'ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK 1-------- sha nr. 2560/1 prot datë 17.08.2016 2--------- sha nr. 2562/1 prot datë 17.08.2016 3.---------nr. 2563/1 prot datë 17.08.2016	**13.Përgjigje** Ankesës ngaAPPapo AKKP ska
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 2507/8 Datë 23.09.2016	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 7,675,188 lekë	**16.Likuiduar deri dt. 23.11.2016 Lekë 7,675,188** **Pa likuiduarderi dt.....Lekë.....**
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimidt.06.10.2016	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 10 ditë Zbatuar13 ditë	**19.Zgjatja e kontratësme..... ditë** Shkresa(Amendamenti) nr..... dt.....

-Vlerame tvsh 7,675,188lekë **-Vlera pa tvsh 6,395,990lekë**				
20. Mbikëqyrësi i punimeve EmriMbiemri.....	Licenca Nr.....	Kontrata Nr.....Prot.....datë.....lekë	Likuiduar .....lekë)	Pa likuiduar .....lekë)
21. Kolaudatori i punimeve EmriMbiemri.....	Licenca Nr	Nr.....Prot.....datë.....	Likuiduar(lekë)	Pa likuiduar (lekë)
22.Akt Kolaudimidatë.....	**23.Akt i marrjes në dorëzim** dt. 06.10.2016		**24.** Fletë HyrjaNr. 37-38 datë06.10.2016 lekë	

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga ana e Njësisë së prokurimit nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përsa i përket argumentimit të kritereve të përckatuara për kualifikim.

Referuar nenit 61 pika 2 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në të përcaktohet që:

> *"Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre."*

Nuk janë dhënë shpjegime apo arsyetime në lidhje me kriteret e përzgjedhura për kualifikim, veprim në kundërshtim me nenin 61 pika 2 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Çdo kriter duhet të vendoset bazuar në një logjikë apo arsyetim, dhe të shërbejë për përzgjedhjen e operatorit ekonomik i cili ka kualifikimet e nevojshme për të zbatuar në mënyrën më të mirë kontratën. Në kriteret e vendosura në këtë procedurë prokurimi nuk janë dhënë arsyetime.

Nga ana e Njësisë së prokurimit nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përsa i përket vendosjes të disa kritereve të cilat ndikojnë negativisht në pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomik.

Referuar nenit 46, pika 3, të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në të përcaktohet që:

> *Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.*

Referuar nenit 23, pika 1, të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në të përcaktohet që:

> *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

Disa nga kriteret e vendosura për këtë procedurë prokurimi, duke e lidhur këtë kriter edhe me sa trajtuar më sipër, grupi i auditimit i konsideron të panevojshme për përmbushjen e kontratës, duke shërbyer më së shumti për shmëngien dhe largimin e ofertuesve, dhe jo për qëllimin apo frymën kryesore të prokurimit publik, atë të nxitjes së pjesëmarrjes së gjerë të operatorëve ekonomikë. Saktësisht:
- Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë: a. Kandidati / ofertuesi pjesëmarrës duhet të jetë importues lubrifikantesh.
- Kapaciteti ekonomik dhe financiar: f. Të ketë 12 punonjës të siguruar për vitin 2015 dhe 2016 (edhe pse duhet theksuar se ky kriter pas ankesës së 3 operatorëve ekonomik, ka ndryshuar, duke kërkuar 6 punonjës në vënd të 12). Duke qënë se kjo është një kontratë furnizimi, ky kriter vlerësohet si i panevojshëm nga grupi i auditimit.
Nga ana e Komisioni të Vlerësimit të Ofertave nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përsa i përket kulifikimit të gabuar operatorit ekonomik, i cili është shpallur edhe fitues i kësaj procedure.
Referuar nenit 66, pika 3, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në të përcaktohet që:

Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Operatori i shpallur fitues ---------sh.a, nuk i ka përmbushur kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Saktësisht:
- Mungon kriteri i kërkuar në pikën 2.3.a Kapaciteti teknik/kontrata të ngjashme. Operatori ekonomik ka paraqitur fatura të ndryshme kundrejt tregëtarëve të ndryshëm, dokumenta të cilat nuk shërbejnë për vërtetimin e pikës 2.3.a të doumentave standarde të tenderit. Normalisht duhet të ishte paraqitur kontratë me subjektet shtetërore ose një faturë tatmore kundrejt një tregëtari privat.
- Për sa i përket specifikimeve teknike në tabelën e mëposhtme paraqiten zërat të cilat nuk janë në përputhje me ato të kërkuara:

Objeki	**Treguesit**	**Kërkesat e AK**	**Rezultati i sjellë nga OE**
Vaj Motori 15Ë-40	Densiteti në 15°C	0.888	0.876
	Viskoziteti në 40°C	109	86.32
	Indeksi i viskozitetit	139	177
	Pika e flakërimit	230	232
	Pika e ngrirjes	-36	Nuk ka të dhënë
	TBN	10	10.72
	Acide dhe baza të tretshme	0	Nuk ka të dhënë

	Mbeturina Mekanike	0	Nuk ka të dhënë
Vaj Motori 20Ë-50	Densiteti në 15°C	0.893	0.8613
	Viskoziteti në 40°C	162	112,34
	Viskoziteti në 100°C	16.3-21.9	16.2
	Indeksi i viskozitetit	132	162
	Pika e flakërimit	228	248
	Pika e ngrirjes	-27	Nuk ka të dhënë
	TBN	8.2	10.95
	Acide dhe baza të tretshme	0	Nuk ka të dhënë
	Mbeturina Mekanike	0	Nuk ka të dhënë
Vaj Hidraulik 68	Densiteti në 15°C	0.87	0.8822
	Viskoziteti në 40°C	68	57.61
	Viskoziteti në 100°C	8.9	8.4
	Indeksi i viskozitetit	105	117
	Pika e flakërimit	235	242
	Pika e ngrirjes	-33	Nuk ka të dhënë
	Acide dhe baza të tretshme	0	Nuk ka të dhënë
	Mbeturina Mekanike	0	Nuk ka të dhënë
Vaj Hidraulik 46	Densiteti në 15°C	0.865	0.8774
	Viskoziteti në 40°C	46	38.36
	Viskoziteti në 100°C	6.8	5.72
	Indeksi i viskozitetit	105	83
	Pika e flakërimit	220	252
	Pika e ngrirjes	-33	Nuk ka të dhënë
	Acide dhe baza të tretshme	0	Nuk ka të dhënë
	Mbeturina Mekanike	0	Nuk ka të dhënë

Nga tabela e mësipërme konstatohet se operatori i shpallur fitues nuk i ka përmushur kriteret e vendosura dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Për pasojë procedura duhet të ishte anulluar. Ndërkohë nga ana tjetër operatori ekonomik ---------sh.p.k është skualifikuar për të njëjtat arsye.
Nga ana e Njësisë së prokurimit nuk janë zbatuar përcaktimet e bëra në nenin 24 të shtojcës 15 të DST dhe nenin 27 të kontratës së lidhur në datën 23.09.2016 me nr. 2507/8 prot, përsa i përket mbajtjes së penalitetit ndaj operatorit të shpallur fitues i cili ka dorëzuar mallin me vonesë.
Referuar nenin 24 të shtojcës 15 të DST dhe nenin 27 të kontratës së lidhur në datën 23.09.2016 me nr. 2507/8 prot, në të përcaktohet që:

"Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore: a)Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo shumë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës".

Kontrata për procedurën në fjalë ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe ---------sh.a në cilësinë e operatorit ekonomik të shpallur fitues, është lidhur në datën 23.09.2016 me nr. 2507/8 prot, ndërsa në datën 06.10.2016 janë marrë në dorëzim pajisjet e prokuruara sipas faturës 97/99 datë 06.10.2016. Pra mallrat janë dorëzuar 13 ditë pas lidhjes së kontratës, veprim në kundërshtim me nenin 5 pika 2 të kontratës së furnizimit ku citohet "Afati i realizimit të kontratës do të jetë nga data e lidhjes me afat lëvrimi 10 ditë", dhe me pikën 2.3 të njoftimit të kontratës në DST. Për pasojë Autoriteti Kontraktor në këtë rast duhet të kishte zbatuar nenin 24 të shtojcës 15 të DST dhe nenin 27 të kontratës së lidhur "Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar", ku citohet: "Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore: a)Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo shumë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës". Për pasojë (0.4% e 7,675,188 lekë) x 3 ditë konsiston me vlerën 92,102 lekë, e cila përbën penalitet të pambajtur nga autoriteti kontraktor kundrejt operatorit ekonomik dhë përbën dëm ekonomik për buxhetin e DPN1.

Nga ana e Njësisë së prokurimit nuk janë zbatuar përcaktimet e bëra në nenet 3 e 29 të"Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", përsa i përket inventarizimit të dosjes së prokurimit.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se nga ana e njësisë së prokurimit nuk janë dhënë argumenta për përcaktimin e kritereve të kualifikimit. Nga ana e njësisë së prokurimit janë caktuar kritere kualifikimi të vlerësuara të panevojshme nga grupi i auditimit, veprim i cili ndikon negativisht në pjesëmarrjen masive të operatorëve ekonomikë. Operatori i shpallur fitues nga komisioni i vlrësimit të ofertave nuk i ka plotësuar të gjithë kriteret e vondosura për kualifikim, për pasojë duhet të ishte skualifikuar dhe procedura duhet të ishte anulluar. Operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka zbatuar afatin e përcaktuar në kontratë për dorëzimin e mallrave, dhe për pasojë nga autoriteti kontraktor duhet të mbahej penalitet në zbatim të kushteve të kontratës. Ky penalitet nuk rezulton të jetë mbajtur. Dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar sipas legjislacionit në fuqi.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Kontrata e lidhur në datën 23.09.2016 me nr. 2507/8 prot. Dokumentat Standarde të Tenderit. Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat". Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Vlera prej 92,102 Lekë, e cila përfaqëson penalitetin e pambajtur ndaj operatorit fitues si pasojë e vonesës në dorëzimin e malli, do të konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë dhe Buxhetit të Shtetit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Znj. [redacted],me detyrë ish-specialiste (nuk ndodhet më në punë) në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, Znj. [redacted],me detyrë specialiste në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, Z. [redacted],me detyrë

përgjegës në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, Znj. [redacted],me detyrë zv/Drejtore në cilësinë e anëtares së komisionit të vlerësimit të ofertave, Z. [redacted],me detyrë shef sektori në cilësinë e anëtares së komisionit të vlerësimit të ofertave, Z. [redacted],me detyrë ish-shefe sektori (nuk ndodhet më në punë) në cilësinë e anëtares së komisionit të vlerësimit të ofertave.

Për përmirësimin e gjëndjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së grupit të menaxhimit strategjik në Drejtorinë e Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit, u konstatua se krahas urdhrit të titullarit për ngritjen e këtij grupi, nuk është mbajtur asnjë procesverbal për mbledhjet, diskutimet apo problematikat e ngritura nga ky grup, në kundërshtim me nenin 27, pika 1 të ligjit nr. 10296 për "Menaxhimi Financiar dhe Kontrollin". Gjithashtu nuk është hartuar Deklarata Vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe për pasojë nuk është dorëzuar në Ministrinë e Financave, sipas afateve ligjore të caktuara në nenin 18 të ligjit Nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe pikat nr. 4 e 6 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011 *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 28-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: - Nga ana e grupit të menaxhimit strategjik të dokumentohen mbledhjet dhe minutat e takimit, diskutimet e kryera, problematikat e ngritura si dhe procedurat e propozuara për zgjidhjet e këtyre problematikave, në mënyrë të tillë që puna e këtij grupi të jetë e argumentuar dhe e matshme.
- Në vazhdimësi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1, të Punëtorëve të Qytetit të hartohet Deklarata Vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe të dorëzohet sipas afateve ligjore, veprim i cili krahas detyrimit ligjor, shërben për çertifikimin e veprimtarisë së menaxhimit financiar dhe kontrollit të kësaj njësie.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e punëtorëve të qytetit Tiranë, për periudhën objekt auditimi nuk ka hartuar çdo 4-mujor raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 65 "Monitorimi". Për të dy vitet e periudhës së auditimit ky institucion nuk ka hartuar raporte monitorimi për shpenzimet buxhetore, dhe për rrjedhojë nuk ka bërë analizën e kostove për produktet e programuara dhe të realizuara.
- Nga analiza e realizimit të shpenzimeve operative (602), u konstatua se, në disa zëra ka ndryshime të konsiderueshme nga viti në vit, duke evidentuar kështu që planifikimi dhe programimi i tyre nuk është bërë i detajuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve, në mënyrë që ndryshimet e shpenzimeve buxhetore gjatë viteve, të jenë sa më të vogla dhe për ndryshime të domosdoshme *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 35-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës, të marrë masat që formularët e raporteve të monitorimit të shoqërohen me analizën e treguesve financiarë, me qëllim përmirësimin e planifikimit të kërkesave të programit në periudhat e ardhshme.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë, nuk ka përcaktuar rregullat e brendshme të miratuara për gjurmët e auditimit në procedurat standarde të përdorimit të fondeve buxhetore për blerjet me vlera të vogla, me synim që të sigurohet se të gjitha operacionet e njësisë publike, dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm e të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 65-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 <u>Rekomandimi</u>: Nëpunësi Autorizues dhe Titullari i institucionit, në zbatim të nenit 9, pika 2 dhe nenit 16, pika 2, të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të hartojnë dhe miratojnë rregullat për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të shpenzimeve, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave në zbatim të ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Titullari i autoritetit kontraktor, megjithëse ka përcaktuar komisione për marrjen në dorëzim të mallrave të furnizuara, apo shërbimeve për çdo rast të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, këto komisione nuk kanë funksionuar, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe pika 35, 36 dhe 54 të udhëzimit MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ". *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 35-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 <u>Rekomandimi</u>: Të merren masa nga Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe dega e financës, për ngritjen dhe funksionimin e komisioneve të marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara për çdo rast të blerjes apo shërbimit të kryer me procedurë prokurimi me vlerë të vogël, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë e Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, nuk ka asnjë procedurë të shkruar për sa i përket mënyrës së rekrutimit të stafit (*përsa i takon stafit administrative dhe teknik),* apo shpalljen e vendeve vakante. Gjithashtu nuk ka kritere të mirë caktuara për vendet e punës, të cilat do të shërbenin si bazë për vlerësimin e rekrutimit të stafit aktual dhe rekrutimeve në të ardhmen. Nga auditimi i praktikave të dokumentimit dhe miratimit të orëve jashtë kohës zyrtare të punës për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, janë konstatuar raste për të cilat shënimi dhe miratimi janë kryer nga vetë punonjësi, veprim në kundërshtim me nenin 22 pika 3.b të ligjit nr.10296 për "Menaxhimi Financiar dhe Kontrollin".

- Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1, të Punëtorëve të Qytetit, u konstatua se ato ishin të plota nga ana e dokumentacionit, por nuk ishin të inventarizuara në përputhje me VKM Nr. 117 datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjes se personelit"
- Nga auditimi i listëpagesave të punonjësve u konstatuan raste të tejkalimit të numrit të orëve shtesë të lejuara në kundërshtim me pikën 2 neni 90 të Kodit të Punës, sipas të cilës numri maksimal i orëve shtesë duhet të jetë 10 orë në javë (ose 40 në muaj)

(*Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 61-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit të hartohet dhe të ndiqet një procedurë standarde përsa i përket mënyrës së rekrutimit të stafit *(të administratës)* dhe shpalljen e vendeve vakante. Gjithashtu të caktohen kriteret për të gjitha vendet e punës në administratë, të cilat do të shërbejnë si për rekrutimet e stafit ashtu edhe për ndarjen aktuale të detyrave të tij.
5.2 Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në DPN Nr. 1, të marrë masa për inventarizimin e dosjeve të personelit sipas legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të menaxhohet më saktë informacioni me të dhënat e punonjësve duke respektuar dhe ruajtur edhe konfidencialitetin e tyre.
5.3 Rekomandimi: Në vazhdimësi për praktikat e ndjekura për caktimin e orëve jashtë orarit zyrtar në Drejtorinë e Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit, të sigurohet që miratimi i këtyre orëve të kryhet në mënyrë të tillë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin dhe miratimin e tyre, duke u përpjekur gjithashtu që në të ardhmen të mos tejkalohen normat ligjore të kohës së punës së tyre.

Në vijimësi dhe menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Për ambientet e dhëna me qira, subjekteve [redacted],me sipërfaqe prej 3510 m², referuar kontratës së datës 12.04.2001 dhe "Ish këndi i lodrave për fëmijë në rrugën e Elbasanit" me sipërfaqe prej 3140 m², referuar kontratës së datës 05.04.2001, Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve Nr. 1 e Qytetit, nuk ka kryer monitorimin e kontratave të qirasë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" kreu VI "Monitorimi i kontratave", pikat 1 dhe 2. *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 57-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Menaxhimit dhe Shërbimeve, të ngrejë grupin e punës për monitorimin e ambienteve të dhëna me qira, me qëllim ruajtjen e tyre dhe respektimin e kushteve kontraktuale si edhe në rastet e përfundimit të kontratave, apo tjetërsimit të ambienteve të kryejë procedurat sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Hartimi i pasqyrave finaciare është hartuar në bazë të inventareve fizike i krahasuar me atë kontabile nga ku nuk kanë rezultuar diferenca, por Drejtoria e Menaxhimit dhe Planifikimit /Sektori i Financës nuk ka azhornuar, nuk ka regjistruar dokumentacionin e veprimeve kontabël në ditarët analitik, librin e madh, ditar banke dhe ditar magazine, nëpërmjet të cilit kryhen kontabilizimet e veprimeve, në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" dhe me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël" *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 41-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
7.1 Rekomandim: Drejtoria e menaxhimit dhe planifikimit /Sektori i Financës të marrë masa për hapjen në ditarë dhe në llogari të veprimeve dhe fakteve ekonomike që i përkasin njësisë ekonomike mbi dokumente bazë, dokumente plotësues dhe regjistrat (libra) kontabël.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer për plotësimin e pasqyrave financiare për vitin 2016 nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit rezulton se janë përpiluar sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës, bilanci është përfunduar dhe dërguar në degën e thesarit në afat. Por, nga auditimi i gjendjes së debi-kredive rezultoi se ky institucion ka debitorë pa shpresa arkëtimi të krijuar para 10 vjetësh, të cilët kërkojnë një ndjekje dhe një analizë të mëtejshme për të qartësuar pozicionet e këtyre llogarive. Duke mos patur politika të qarta për arkëtimin e detyrimeve dhe menaxhimin e tyre (debitorëve), DPN 1 nuk ka mundur të arkëtojë debitin e krijuar ndër vite nga 16 subjekte në vlerën 20,496,402 lekë, të cilat vinë kryesisht nga dëmtime. Institucioni nuk ka kryer asnjë veprim, për të bërë të mundur të arkëtojë debitin e krijuar në mospërputhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit" *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 55-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1 <u>Rekomandimi</u>: Drejtoria e Menaxhimit dhe Planifikimit, Sektori i Financës dhe Drejtoria Juridike të marrin masa për pjesën e llogarive debitore që kalojnë kohën e parashkrimit, të hartojë një raport analitik për strukturat drejtuese të institucionit, për t'ju drejtuar Bashkisë Tiranë, për mënyrën e sistemimit të këtyre shumave të cilat rrinë në llogaritë e saj për periudha mbi 10 vjeçare, për pjesën e llogarive debitore, të cilat nuk janë futur në strategjinë e detyrimet e prapambetura, të jenë pjesë e kësaj analize dhe raporti, për t'u sistemuar. Gjithashtu, nga drejtoritë e sipërcituara të hartohet një procedurë standarde për arkëtimin e detyrimeve të debitorëve deri në adresimin në organet gjyqësore nëse do të jetë e nevojshme.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer mbi konsumin e karburantit për dy gjeneratorët për përpunimin e plehrave në landfillin e sharrës, mungojnë të dhënat për vitin e prodhimit dhe patenta shoqëruese si dhe u konstatua se nuk ka një procesverbal të llogaritjes së normës së harxhimit në 1/ore pune te veçantë, por kjo normë llogaritet me urdhër të përgjithshëm. Mungon regjistri i matjes së kohës së punës dhe sasisë së karburantit që është harxhuar për kohën që është vënë në punë. Këto veprime janë në kundërshtim me Kreun III, pika 30 e Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

- Nga auditimi i dokumentacionit të mjeteve të transportit si dhe mjeteve të tjera që kryejnë shërbime në këtë ndërmarrje si motogjeneratorë, autofshirëse etj. nuk ka regjistër (kartela) për të saktësuar hyrjen në magazinë për çdo rast. Gjithashtu, nuk ka asnjë dokument justifikues për të saktësuar lëvizjet që kryen çdo mjet mbi bazën e të cilëve të kryhen dhe shërbimet, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011"Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 51-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues, të marrë masa për ngritjen e komisioneve për matjen dhe përcaktimin e konsumit të karburantit, për përpunimin e plehrave, duke nxjerrë dhe dokumentuar saktë shpenzimet për këto gjeneratorë.
9.2 Rekomandimi: Të merren masa dhe të hapen kartela nga Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve, për çdo automjet si dhe për çdo mjet pune të cituara më lartë, në mënyrë që të saktësohen kur janë berë hyrje në institucion që në bazë të këtyre të dhënave të kryhen shërbimet gjithashtu bëhet dhe amortizimi vit pas viti. Të ngrihet urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm i Institucionit për të përcaktuar konsumin e sasisë së karburantit në 1/ore pune me urdhër të veçantë, për gjeneratorët që kanë në përdorim, duke nxjerrë saktë shpenzimet dhe duke i dokumentuar sipas formulareve tip.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e pasqyrave financiare u konstatua se në Llogarinë 231 "shpenzime në proces", për rritje të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara vlera e trashëguar ndër vite dhe përshkruar si shpenzime është 9,823,259 lekë, (Universiteti i Tiranës para vitit 2006). Nga ana e subjektit nuk është kryer asnjë veprim, për të plotësuar me dokumentacion justifikues të vlerës së mësipërme, në mënyrë që të mos paraqitet vit pas viti në pasqyrat financiare.
-në pasqyrat e inventarit për (magazinat rikupero) konstatohet mbartja e vlerës 5,964,669 lekë, me zëra të ndryshem, gjendja fizike dhe kontabile e të cilave trashëgohet ndër vite e cila nuk është rivlerësuar duke dhënë impakt financiar në bilancin e DPN1.
-në lidhje me ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale për periudhën objekt auditimi (vitet 2016 - 6/mujori 2017) u konstatua se, sektori i financës, nuk ka përfunduar zyrtarizmin e regjistrit analitik të aktiveve sipas formatit zyrtar, në formë analitike, në përputhje me Kreun III, pikën 26 të Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011"Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 52-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve Nr. 1 të marrë masat për të siguruar informacionin e duhur në lidhje me vlerën 9,823,259 lekë, që mos të kaloje si vlerë vit pas viti në pasqyra finaciare, të ngrejë grupet e punës dhe të vlersojë këto materiale (rikupero) nëse kanë vlerë, ose të procedohet e të nxirren në ankand sipas zerave dhe listave që janë në inventarin fizik, duke vepruar sipas proceduarve ligjore në fuqi. Titullari i DPN1 të marrë masat për autorizimin e nëpunësit zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të aktiveve. Ky regjistër duhet të krijohet dhe përditësohet në përputhje me Udhëzimin në fuqi.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Punëtorëve Nr. 1 e Qytetit Tiranë, ka në inventarin e vitit 2016 katër automjete Tip traktorë me zinxhirë (viti i prodhimit 1998) me vlerë 62,082,698 lekë, nga ku u konstatua se këto mjete nuk janë në përdorim dhe janë mjaft të konsumuara. Kjo vlerë e trashëguar ndër vite, mban të regjistruar në pasqyrat financiare vlerat e këtyre mjeteve të cilat nuk janë në gjëndje pune.

- Në gjendjen e inventarëve të institucionit për vitet 2016, u konstatua se një pjesë e materialeve janë shumë të konsumuara / dëmtuara, për të cilat kosto e mbajtjes rezulton më e lartë se përfitimi nga përdorimi *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 41-46 dhe nr. 59-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i DPN 1 të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një komisioni për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, të cilat kanë humbur cilësinë dhe vlerën e përdorimit, si dhe të marrë masat e nevojshme për të vlerësuar materialet e konsumuara apo dëmtuara të cilat nuk shërbejnë më për aktivitetin e drejtorisë dhe kosto e mbajtjes së tyre rezulton më e lartë nga përfitimi prej përdorimit të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Veprimet ekonomike, janë regjistruar në bazë të dokumenteve autorizuese dhe vërtetuese, veprimet janë regjistruar në kompjuter, por nuk është mbajtur ditari i bankës sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2012, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", "Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve" dhe "Dokumentimi i vlerave monetare" *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 51-59 dhe nr. 66-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e menaxhimit dhe planifikimit, Dega e financës të marrin masa për hapjen e ditarëve të bankës dhe të magazinave, për kryerjen e kontabilizimit te veprimeve sipas udhëzimeve të sipërcituara.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, saktësisht për: "Blerje vaj dhe filtra", "Blerje plehra kimik, farëra etj", "Blerje karburant Diesel D1 dhe benzinë", "Blerje stola dekorativ dhe kosha", "Blerje kosha për diferencim" dhe "Blerje drurë dhe shkurre dekorativ", me vlerë totale të fondit limit 105,825,822 lekë (pa TVSH), u konstatua se disa nga kriteret për kualifikim të vendosura në dokumentet standarde të tenderit, janë të panevojshme për përmbushjen e kontratave, duke ndikuar negativisht në qëllimin dhe frymën kryesore të prokurimit publik, atë të nxitjes së pjesëmarrjes së gjerë të operatorëve ekonomikë, veprim në kundërshtim me nenin 23, pika 1 dhe nenin 46, pika 3, të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 67-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1 Rekomandim: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit në të ardhmen të merren masa për vendosjen e kritereve të cilat realisht i shërbejnë realizimit të objektit të prokuruar, duke krijuar kushte të përshtatshme për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Me anë të shkresës Nr. 24/05/1 Prot datë 29.07.2016 të Drejtorit të Zhvillimit Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit, është kërkuar blerje shtesë për artikullin lule sezonale me qëllim vendosjen në ambjente të qytetit, të ndryshme nga ato për të cilat është kryer

procedura e parë e prokurimit me objekt: "*Blerje Plehra Kimike, Farëra, Bari, Fidane,etj"* në vlerën 10,833,350 lekë pa tvsh. Më pas me shkresën Nr. 2765 Prot datë 07.09.2016 të personit të autorizuar nga titullari, ---------, pa paraqitur asnjë argumentim, është miratuar aplikimi i shtesës prej 20 % të vlerës së procedurës së trajtuar më sipër. Kjo procedurë duhet të ishte trajtuar më vete dhe jo si shtesë kontrate. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 33 pika 5/a të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Gjithashtu konstatohet se në preventiv janë shënuar thjesht "Lule sezonale", pa u përcaktuar saktësisht lloji i luleve duke e lënë evaziv përzgjedhjen e tyre *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 87-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1 <u>Rekomandimi:</u> Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit në të ardhmen të merren masa për argumentimin e shtesave prej 20% të kontratave, duke u siguruar që kjo alternativë të përdoret vetëm në rastet e përcaktuara në ligj, dhe jo për shmangien e procedurave normale të prokurimit publik.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2016 janë kryer 6 procedura prokurimi me objekt "Blerje karburanti Diezel D1 dhe Benzinë për mjete e DPN1" me vlerë totale 86,194,615 lekë (pa TVSH), nga të cilat 3 procedura për shtesë kontrate 20% në vlerën totale 20,018,661 lekë. Nga auditimi i këtyre procedurave konstatohet se nga Autoriteti Kontraktor për vitin 2016:

- Është copëzuar fondi limit, në kundërshtim me nenin 28.2 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e efiçencës në përdorimin e këtyre fondeve.
- Fakti se ka qenë e nevojshme të kryhen 6 procedura prokurimi për të njëjtin objekt, nga të cilat 3 procedura janë shtesë kontrate, tregon për një parashikim mjaft të dobët nga ana e DPN1 për përdorimin vjetor të karburantit. Shtesat për këtë mall të prokuruar janë në kundërshtim me nenin 33 pika 5/a të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 87-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1 <u>Rekomandim</u>: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit në të ardhmen të merren masa për parashikimin e saktë të nevojave vjetore për karburant, duke zhvilluar një procedurë të vetme në mënyrë që përdorimi i fondeve publike për këtë zë të shpenzimeve të jetë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efiçiences dhe efektivitetit.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "Blerje Çakulli" për vitin 2016, me fond limit 2,455,340 lekë (pa tvsh), u konstatua se njësia e hartimit të specifikimeve teknike nuk ka përcaktuar qartë llojin e çakullit e cila ndikon drejtpërdrejtë në vlerën totale të produktit të prokuruar. Nga auditimi u konstatua se ky fond është përllogaritur duke marrë tre oferta dhe jo referuar manualit të ndërtimit nr. 1 "Prodhimi i materialeve të ndërtimit" të VKM nr. 568, datë 27.06.2013 (i cili ka qenë në fuqi në periudhën e zhvillimit të tenderit) "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të

tyre" ku është përcaktuar qartë çmimi i çakullit sipas llojeve të tij. *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 87-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1 <u>Rekomandim</u>: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit në të ardhmen, në rastet kur manualet e ndërtimit të miratuara nga institucionet shtetërore i kanë të përcaktuar qartë vlerat e objekteve të prokuruara, të përcaktohet fondi limit nëpërmjet këtyre manualeve, duke mënjanuar kështu mundësinë e rritjes artificiale të fondit limit.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "Blerje Kosha Për Diferencim" për vitin 2016, me fond limit 19,993,666 lekë (pa tvsh), u konstatua se nga njësia e përllogaritjes së vlerës së fondit limit gjatë testimit të tregut, janë pranuar oferta financiare edhe nga operatorë të cilët nuk e kanë në objekt të aktivitetit të tyre objektin e procedurës së prokurimit, për pasojë nga përllogaritja e fondit limit me oferta të tilla nuk mund të kemi një vlerë të saktë të përllogaritur *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 87-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1 <u>Rekomandim</u>: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit në të ardhmen të merren masa që gjatë procesit të testimit të tregut për përllogaritjen e fondit limit, të pranohen vetëm ato oferta të cilat u përkasin operatorëve ekonomikë të cilët kanë si fushë të punës së tyre objektin e prokurimit, si një garanci për marrjen e një vlere sa më objektive dhe reale të fondit limit.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të procedurave të prokurimit, u konstatua se nuk janë të inventarizuara dhe arkivuara, veprim në kundërshtim me nenet 3 e 29 të "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat" *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 87-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1 <u>Rekomandim:</u> Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit të merren masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve dhe dokumenteve të procedurave të prokurimit publik, në zbatim të Normave Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Autoriteti kontraktor, për prokurimet me vlera të vogla për vitin 2016, nuk ka planifikuar drejt nevojat për prokurime, pasi ato në vlerë janë realizuar në masën 59%. Janë kryer 18 procedura me vlere 9,503 mijë lekë, nga vlera prej 16,102 mijë lekë e parashikuar. Fondi limit i llogaritur për këtë qëllim, nuk është i saktë, i argumentuar si dhe i pa bazuar në çmimet e periudhave të mëparshme, çmimet e publikuara nga INSTAT, etj, me qëllim arritjen e prokurimeve me efektivitet, ekonomicitet dhe efiçencë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, germa b, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 40 "Procedura e prokurimit

me vlerë të vogël" pika 1 dhe Udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015 "Për prokurimet me vlera të vogla" pika 4. *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 65-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1 Rekomandimi: Autoriteti kontraktor, njësia e prokurimit dhe dega e planifikim shërbimeve, të hartojnë nevojat për punë, mallra dhe shërbime, bazuar në nevojat reale, duke llogaritur fondin për të detajuar për çdo blerje me vlera të vogla, dhe jo referuar limitit prej 800 mijë lekë, me qëllim arritjen e prioriteteve të caktuara dhe prokurimeve me efektivitet, ekonomicitet dhe eficencë.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: - Nga auditimi i procedurave të kryera për blerjet me vlera të vogla, u konstatuan mjaft mangësi të letrave të punës apo parregullsi të procedurave, të cilat sipas grupit të auditimit janë si pasojë e mosnjohjes së mirë të ligjit dhe rregullave të prokurimeve publike nga ana e stafit të Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit

- Për nevojën e kryerjes së prokurimit/shërbimit, mungojnë kërkesat nga degët, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera te vogla" pika 4, si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57, datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 mijë, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël. Procedurat për blerjet me vlera të vogla, në shumicën e rasteve janë kryer në formë shkresore, nëpërmjet formularit të emergjencës ose si pasojë e anulimit të procedurës në sistemin elektronik.

- Mungojnë specifikimet teknike në të gjitha procedurat e kryera për blerjet me vlera të vogla, për materialet e listuara nuk ka asnjë specifikim teknik në lidhje me llojin, përmasat, ngjyrën, materialin etj, të dhëna të nevojshme për artikujt që do të prokurohen, sepse bazuar në specifikimet teknike përcaktohet/diferencohet cilësia dhe çmimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 23 "Specifikimet teknike" dhe VKM nr. 914, datë 20.12.2014, neni 27 (*Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 65-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1 Rekomandimi: Njësia e Prokurimit, të marrë të gjitha masat, që specifikimet teknike, të hartohen në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, të përcaktohen kritere të sakta dhe të kuptueshme, pa lënë shteg për interpretime, si dhe të detajohen sipas rregullave të prokurimit publik, me qëllim arritjen e mallrave dhe shërbimeve me cilësinë e kërkuar.

20.2 Rekomandimi: Autoriteti kontraktor, të marrë masa për njohjen e vazhdueshme të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit me bazën ligjore dhe rregullat e prokurimeve publike, nëpërmjet trajnimeve në Agjencinë e Prokurimit Publik, në përmbushje të kërkesës së VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me qëllim përmirësimin e punës së Njësisë së Prokurimit për hartimin e nevojave, kërkesave, hartimin e specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit të nevojshëm për kryerjen e blerjeve me vlera të vogla, etj.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të veprimeve me bankën u konstatua se likuidimet janë kryer në 35 raste me 3-10 muaj vonesë, në kundërshtim me ligjin nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7.
-Në 7 raste pagesat e kryera për prokurime mallra dhe shërbime, kanë mangësi në plotësimin me dokumente justifikues, procesverbale, etj, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", "Dokumentimi i lëvizjes së tyre" *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 65-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
21.1 <u>Rekomandimi:</u> Dega e financës të marrë masa për kryerjen në kohë të detyrimeve kontraktuale, duke respektuar afatet ligjore, me qëllim eliminimin e detyrimeve të prapambetura.
21.2 <u>Rekomandimi</u>: Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit, Shërbimeve si dhe Dega e Financës, të marrin masa për implementimin e një programi financiar për kryerjen e veprimeve ekonomike, me lehtësimin e punës, shmangien e gabimeve të mundshme dhe marrjen e të dhënave të sakta financiare, sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

C.1 <u>MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:</u>

Në mbështetje të shkronjës (a) neni 15 - *Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së* të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, në zbatim të neneve 98-102 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 *"Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë"*, dhe pikën 93 të udhëzimit Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*, **nga ana e titullarit të njësisë audituar**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për kompensimin dhe shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 194,102 lekë**, *si më poshtë:*

1. Gjetje nga auditimi: Në objektin *"Sistem ujitës me impiante (pusi)"* Tiranë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **102,000 lekë pa tvsh** si pasojë e likuidimit tvsh – së pajisjeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 8.5.2003 *"Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit"*, Kreu I/I dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2013/8 prot datë 28.07.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor të Drejtorisë së Përgjithshme nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit Tiranë dhe OE [redacted],*"* sh.p.k, *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
1.1. <u>Rekomandimi</u>: Nga Drejtoria e Përgjithshme nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **102,000 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik [redacted],sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2013/8 prot datë 28.07.2016 me objekt *"Sistem ujitës me*

impiante (pusi)" Tiranë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të t.v.sh – së pajisjeve.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje Vaj dhe Filtra", u konstatua se kontrata ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe [redacted],sh.a në cilësinë e operatorit ekonomik të shpallur fitues, është lidhur në datën 23.09.2016 me nr. 2507/8 prot, ndërsa në datën 06.10.2016 janë marrë në dorëzim pajisjet e prokuruara sipas faturës 97/99 datë 06.10.2016. Pra, mallrat janë dorëzuar 13 ditë pas lidhjes së kontratës, veprim në kundërshtim me nenin 5 pika 2 të kontratës së furnizimit *ku citohet se "Afati i realizimit të kontratës do të jetë nga data e lidhjes me afat lëvrimi 10 ditë", dhe me pikën 2.3 të njoftimit të kontratës në DST.* Për pasojë Autoriteti Kontraktor në këtë rast duhet të kishte zbatuar nenin 24 të shtojcës 15 të DST dhe nenin 27 të kontratës së lidhur "Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar", ku citohet: "Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore: a)Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por, kjo shumë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës". Për pasojë (0.4% e 7,675,188 lekë) x 3 ditë konsiston me vlerën **92,102 lekë**, e cila përbën penalitet të pambajtur nga autoriteti kontraktor kundrejt operatorit ekonomik dhë përbën dëm ekonomik për buxhetin e DPN1. *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr.107-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 <u>Rekomandimi:</u> Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **92,102 lekë** nga "[redacted]," sh.a në cilësinë e operatorit ekonomik të shpallur fitues. Kjo vlerë ka të bëjë me penalitetin i cili duhet të ishte mbajtur në përputhje me kushtet e kontratës për dorëzimin me vonesë të mallrave të prokuruar.

Menjëherë

C.2. <u>MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.</u>

1. Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa për punonjësit e larguar nga puna që kanë paraqitur vendime gjyqësore si pasojë e largimeve të padrejta, në shumën 6,276,971 lekë, e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit. Largimet nga puna i përkasin viteve 2011-2013. *(Trajtuar më hollësisht në Kreun III, faqet nr. 66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.<u>2 Rekomandimi</u>: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve Nr. 1, të merren masa për të ndjekur me përgjegjësi procedurat gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme.

Në vijimësi

V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Në bazë të punës audituese të kryer, të përshkruar në Kreun III të Raportit Përfundimtarë të Auditimit, Grupit të Auditimit i rezulton se veprimtaria e Drejtorisë Nr.1 të Punëtorëve të Qyetit Tiranë, për periudhën objekt auditimi, është në përputhje në çdo aspekt material me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, Kreu I, germa g) të raportit për sa i përket: (i) Mbylljes së llogarive vjetore në 31 dhjetor 2016, respektimit të afatit të nxjerrjes së bilancit kontabël, plotësimit të pasqyrave financiare, (ii) Ndarjes së aktivitetit të DPN 1 me Agjencinë e Parqe Rekreacionit si përsa i përket transferimit të të drejtave dhe detyrimeve ashtu dhe për personelin dhe aktivet, (iii) Saktësisë së paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare, (iiii) Pasqyrimit të të ardhurave në tërësi dhe ato dytësore në veçanti në kontabilitet (iiiii) Menaxhimit të burimeve njerëzore dhe administrimit të marrëdhënieve të punës, (iiiiii) Llogaritjes, likuidimit dhe administrimit financiar të pagave, shpërblimeve dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, Veprimtaria e DPN 1 nuk përputhet me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi përsa i përket: (i) Funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, vlerësimit dhe menaxhimit të riskut sipas kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, (ii) Procesit të programimit të buxhetit të njësisë, të propozimit të nevojave sipas analizës dhe gjendjes reale të drejtorisë, (iii) Prokurimit të fondeve për mallra dhe shërbime për të siguruar dobishmëri maksimale të përdorimit të fondeve, trajtuar më hollësishtnë Kreun. III,

Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4100[1] dhe 4200[2]) e shpenzimeve:

Nga auditimi mbi përputhshmërinë[3], sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1, e Punëtorëve të Qytetit Tiranë, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, të cilat kryesisht, konsistojnë si më poshtë:

Përdorimi i buxhetit të institucionit është orientuar në angazhime të cilat nuk kanë qenë të planifikuara më parë ose angazhime të ekzekutuara më shumë sesa janë planifikuar. Gjithashtu mungesa e përputhshmërisë ka rezultuar edhe në mosekzekutimin në kohë të detyrimeve ku për shërbimet nga të tretët janë ekzekutuar fondet buxhetore të vitit për shlyerjen e detyrimeve të viteve të kaluara.

Në drejtim të menaxhimit më me efektivitet të fondeve buxhetore, rritjes në një nivel më të lartë të përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit menaxherial nuk janë hartuar rregulla të brendshme për gjurmët e auditimit në funksion të zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për përdorimin me efektivitet të fondeve buxhetore.

---

[1] *ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.*

[2] *ISSAI 4200 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare.*

[3] *Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së".*

Konkluzion/Opinion:
Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në Drejtorinë e Përgjithshme Nr. 1, e Punëtorëve të Qytetit Tiranë u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale për të cilën japim ***opinion të pa kualifikuar***[4].

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

[4] *Deviacioni nga kuadri rregullator i evidentuar gjatë misionit auditues për të cilin në gjykimin profesional nuk mund të jepte siguri e arsyeshme.*

V. ANEKSE

Aneksi 1 / Komente dhe shpjegime nga subjekti i audituar

Përgjigje observacionesh:

Sqarim ë përgjigje të observacioneve dërguar me shkresën përcjellëse N. 2129/5 Prot datë 24.11.2017, protokolluar në KLSH me nr. 878/5 prot datë 01.12.2017, përsa I takon problemeve të trajtuara në lidhje me projektraportin e auditimit, sqarojmë se:
- Sa i takon trajtimit për riparimin e kondicionerëve merret në konsideratë pretendimi juaj se puna është kryer dhe nuk është shkaktuar dëm ekonomik. Sqarojmë se procedura është zhvilluar me mangësi të dokumentacionit.

- Sa i takon trajtimit të sjellë nga subjekti, mbi kostatimet e trajtuara në projekt raportin e auditimit për përdorimin e karburantit për gjeneratorët si dhe sqarimeve të mëtejshme të diskutuara në ballafaqimin e zhvilluar me subjektin, dokumentat plotësuese të sjella lidhur me cështjen, pasi u shqyrtuan nga grupi i auditimit u morën në konsideratë..

- Sqarimi observacionit të paraqitur nga znj. [redacted], në lidhje me pretendimin se specifikimet teknike janë hartuar referuar ligjit dhe VKM, sqarojmë se në procedurat e blerjeve të vogla, ky pretendim nuk qëndron dhe nuk ka mbështetje ligjore. Sa i takon specifikimeve teknike nuk jemi shprehur në asnjë rresht të projektraportit përse nuk janë caktuar markat. Observacioni nuk ka bazë ligjore dhe nuk janë paraqitur dokumente, prova/fakte të tjera që provojnë të kundërtën.

Gjithashtu, sqarojmë se përvec sa trajtohet më lartë pjesa tjetër e observacioneve të dërguara janë të njëjtat me ato mbi aktkonstatimet, të cilat janë të trajtuara gjerësisht në projektraportin e auditimit. Gjithashtu ritheksojmë se këto observacione nuk kanë fakte, dokumenta apo bazë ligjore shtesë nga ato të mëparshmet për pasojë nuk do të merren në konsideratë.